

RELACION

mbi

PROJEKTLIGJIN

“PËR BUXHETIN E VITIT 2023”

HYRJE

Projektbuxheti 2023 vijon të mbështesë rritjen ekonomike të vendit pavarësisht efekteve negative të 2 fatkeqësive të njëpasnjëshme që goditën Shqipërinë (tërmeti i 26 Nëntorit 2019 dhe pandemia COVID-19) si dhe të konfliktit Rusi – Ukrainë në fillimin e vitit 2022. Njëkohësisht, nëpërmjet politikës së konsolidimit fiskal synohet të sigurohet një ulje e qëndrueshme e stokut të borxhit publik në periudhën afatmesme 2023-2025.

Pas recesionit të fortë në vitin 2020, në normën prej -3.5%, ekonomia është rikuperuar fuqishëm në vitin 2021, në normën 8.5% dhe parashikohet të vijojë trendin pozitiv në periudhën afatmesme. Rritja ekonomike parashikohet në 3.7% për vitin 2022 dhe parashikohet të vijojë të qëndrojë afër nivelit prej **3.7%** përgjatë periudhës afatmesme. Për vitin 2023 parashikohet që rritja ekonomike të ngadalësohet në **2.6%**, e ndikuar nga zhvillimet dhe pritshmëritë për ekonominë globale dhe veçanërisht atë të Bashkimit Evropian.

Defiçiti buxhetor për vitin 2023 parashikohet të ulet në nivelin **2.6% të PBB** nga **3.3% të PBB** që pritet deri në fund të vitit 2022, dukshëm i orientuar drejt financimit të investimeve publike të parashikuara për vitin 2023. Në fund të vitit 2025, niveli i deficitit buxhetor parashikohet të ulet në **2.2% të PBB** duke përmbushur kështu objektivin madhor të Qeverisë për uljen graduale të stokut të borxhit publik.

Në projektbuxhetin e vitit 2023, programimi i të ardhurave buxhetore mbështet synimet e Qeverisë për rritje ekonomike të qëndrueshme, si dhe uljen e vazhdueshme të deficitit buxhetor dhe stokut të borxhit publik. Ky programim bazohet në përmirësimin e administrimit fiskal dhe minimizimin e informalitetit në ekonomi, duke mbështetur në këtë mënyrë rritjen ekonomike, si dhe duke nxitur prodhimin dhe eksportet.

Të ardhurat buxhetore në raport me PBB parashikohen të qëndrojnë konstante në terma realë në periudhën 2023-2025 në vlerën 28.4% të PBB, në rritje krahasuar me mesataren prej 27.1% të PBB të rezultuar përgjatë periudhës 2019-2022. Kjo rritje i dedikohet kryesisht zbatimit të objektivave të Strategjisë Afatmesme e Mbledhjes së të Ardhurave (MTRS) të cilat synojnë përmirësimin e politikave tatimore për forcimin e mbledhjes së tatimeve si dhe përsosjes së sistemeve të monitorimit.

Shpenzimet Buxhetore për periudhën 2023-2025 do të mbështesin një nivel të lartë investimesh publike prej mesatarisht 5.2% të PBB duke u përqendruar në financimin e projekteve me rëndësi strategjike. Shpenzimet e planifikuara synojnë mbështetjen për dixhitalizimin dhe sigurinë kibernetike, finalizimin e projekteve të rrugëve nacionale, sigurinë kombëtare, mbështetjen e sektorit të ujit, shëndetësisë, arsimit dhe sektorit të bujqësisë dhe zhvillimit rural. Në kuadër të buxhetimit të përgjigjshëm gjinor, në vitin 2023 do të vijojë adresimi i çështjeve të lidhura me barazinë gjinore kryesisht në fushat e arsimit, shëndetësisë, mbrojtjes sociale, drejtësisë dhe rendit publik. Në këtë projektbuxhet parashikohet që rreth 9% e shpenzimeve të përgjithshme publike ti dedikohen politikave publike me bazë gjinore të përfshira në 47 programe buxhetore.

Procesi i menaxhimit të financave publike vendore është shoqëruar me sfida për shkak të pasojave të pandemisë COVID-19, rindërtimit nga tërmetet e vitit 2019, krizës ekonomike dhe energjitike, si rrjedhojë e luftës në Ukrainë. Përballimi i këtyre sfidave të mëdha ekonomike dhe buxhetore nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, është një tregues pozitiv i punës së zhvilluar në këto vite në drejtim të stabilitetit makroekonomik, parashikueshmërisë së fondeve dhe transparencës së përdorimit me disiplinë të fondeve buxhetore. Ministria e Financave dhe Ekonomisë në vitin 2023 do të vijojë me reformimin e financave publike vendore, duke u fokusuar në rritjen e investimeve, digjitalizimin e operacioneve të menaxhimit

financiar në nivel vendor, rritjen e të ardhurave nga taksat vendore si dhe në reformimin e skemave të financimit të qeverisjes vendore. Mbështetja që ka dhënë qeveria për njësitë e vetëqeverisjes vendore nëpërmjet reformave të ndërmarra pasqyrohet në rritjen e transfertës së pakushtëzuar, e cila në krahasim me vitin 2022 është rritur në vlerën **3 miliard lekë, ose 16.1% më e lartë** dhe krahasuar me vitin 2015 (para reformës administrativo-territoriale) është **9.4 miliardë lekë** më shumë **ose rreth 76.4 përqind** më shumë financim nga pushteti qendror. Rritja e konsiderueshme e transfertës së pakushtëzuar, tregon rëndësinë që kjo qeveri gjatë këtyre viteve i ka kushtuar procesit të decentralizimit dhe efikasitetit të qeverisjes vendore.

1. SITUATA EKONOMIKE

1.1 ZHVILLIMET E FUNDIT DHE PERSPEKTIVA MAKROEKONOMIKE

Ritmi i rritjes ekonomike gjatë viteve të fundit, deri përpara goditjeve të tërmetit në nëntor 2019 dhe nga pandemia e Covid-19, ka treguar një trend pozitiv zhvillimi që është pasqyruar në një sërë parametresh makroekonomikë në vend. Performanca e vitit 2020 ka qenë, në aspektin ekonomik dhe të financave publike, një ndër vitet më të vështirë në tre dekada. Ekonomia e vendit përjetoi dy goditje të forta brenda një harku kohor të shkurtër që përfshin tremujorin e katërt të vitit 2019 dhe vitin 2020, veçanërisht në tremujorin e dytë dhe të tretë të tij. Sidoqoftë, megjithë ndikimin e rëndë që të dy goditjet kanë pasur për ekonominë e vendit, në sajë të përgjigjeve relativisht të mira të politikave ekonomike dhe masave të duhura rregullatore të ndërmarra, të dhënat statistikore dëshmojnë se situata e përgjithshme në mbyllje të vitit 2020 ishte konsiderueshëm më pak e rëndë nga sa pritej në fillim të pandemisë, si dhe përgjatë vitit 2021 rimarrja e ritmit të ekonomisë ishte konsiderueshëm më e shpejtë sesa pritshmëritë fillestare. Deri më tani, fundamentet kryesore ekonomike dhe financiare dhe stabiliteti i përgjithshëm makroekonomik i vendit ka rezistuar relativisht mjaft mirë ndaj këtyre goditjeve.

Edhe përgjatë goditjes më të fundit të jashtme si pasojë e luftës në Ukrainë, duket se deri më tani ekonomia jonë është përshtatur dhe ka performuar relativisht mirë. Gjatë gjysmës së parë të vitit 2022, ekonomia shqiptare shfaq shenja inkurajuese duke treguar një stabilizim të aktivitetit ekonomik. Produkti i Brendshëm Bruto (PBB) për gjashtëmujorin e parë të vitit 2022 ka shënuar rritje prej rreth 4.17 përqind krahasuar me gjashtëmujorin e parë të vitit 2021 sipas vlerësimit më të fundit të disponueshëm nga INSTAT. Ky rikuperim mbështetet në një gamë të gjerë faktorësh dhe është prezent në thuajse të gjithë sektorët e ekonomisë. Rritja e besimit të biznesit e konsumatorit, përmirësimi i ekonomive partnere, si dhe politikat mbështetëse fiskale e monetare, kanë sjellë rritje të konsumit të familjeve, të investimeve publike e private, si dhe të eksporteve. Nga këto zhvillime kanë përfituar si sektori prodhues dhe ai i shërbimeve, duke ofruar rimëkëmbje për biznesin dhe punësimin dhe duke krijuar premisa të mira për perspektivën afat-mesme.

Sipas optikës së kërkesës agregate, në gjysmën e parë të vitit 2022 vlerësohet se thuajse të gjithë komponentët e kërkesës agregate kanë shënuar rritje duke reflektuar kështu stabilizimin e aktivitetit ekonomik. Rritja përgjatë gjysmës së parë të vitit 2022 u gjenerua kryesisht nga kërkesa e brendshme, si nga konsumi privat ashtu edhe nga investimet. Nërkojë kërkesa e huaj neto vlerësohet të ketë pasur një kontribut më të pakët, pasi kontributi i lartë pozitiv prej rritjes së eksporteve të mallrave dhe shërbimeve u kundërpoze nga kontributi negativ i rritjes së importeve.

Në këtë kontekst, konsumi final total, i cili përbën peshën më të madhe në ekonomi, për gjysmën e parë të vitit 2022 pësoi rritje të konsiderueshme prej 6.75 përqind, ndërsa konsumi privat shënoi rritje prej 9.07 përqind krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Formimi i Kapitalit Fiks Bruto (investimet totale), pas një rritje të fortë me rreth 19.9 përqind në terma real vjetor përgjatë vitit 2021, për gjashtëmuorin e parë të vitit 2022 shënoi rritje më të moderuar prej 2.52 përqind.

Zhvillimet në tregtinë e jashtme të mallrave treguan një rritje të ndjeshme në terma vjetorë, si në eksporte ashtu edhe në importe. Vijimi i trendit rritës që nga tremujorët e mëparshëm dhe fakti që vlerat kanë pësuar rritje të konsiderueshme, janë tregues për rikuperimin e tregtisë së jashtme të mallrave në nivel të përgjithshëm. Eksportet e mallrave dhe shërbimeve për periudhën tetë mujore 2022 shënuan rritje prej +40.9% krahasuar me një vit më parë. Ndërsa importet e mallrave dhe shërbimeve për periudhën tetë mujore 2022 shënuan rritje prej +24.8% krahasuar me një vit më parë. Deficiti tregtar për periudhën Janar-Gusht 2022 është rritur me 10.0% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Norma e mbulimit të eksporteve ndaj importeve për këtë periudhë është 54.0%.

Në anën e ofertës agregate, kontribut pozitiv në gjashtëmuorin e parë të vitit 2022 dhanë disa degë, konkretisht: “Tregtia, Transporti, Akomodimi dhe shërbimi ushqimor” regjistroi rritje prej 11.08% dhe kontribut pozitiv prej 1.51 pikë përqindje në rritjen totale të PBB prej 4.17 përqind; “Aktivitete të pasurive të paluajtshme” regjistroi rritje prej 13.05% dhe kontribut 0.85 pikë përqindje; “Aktivitete financiare dhe të sigurimit” regjistruan rritje prej 12.56% dhe kontribut prej 0.40 pikë përqindje; “Ndërtimi” regjistroi rritje prej 7.42% dhe kontribut prej 0.68 pikë përqindje; “Aktivitete profesionale dhe administrative” regjistruan rritje prej 8.73% dhe kontribut prej 0.46 pikë përqindje. Ndërsa degët që patën rritje dhe kontribut negativ janë: “Arte, argëtim dhe çlodhje”, e cila regjistroi rënie prej -10.07 përqind dhe kontribut negativ prej 0.21 pikë përqindje, “Administrimi publik, Arsimi dhe Shëndetësia” patën rënie prej 2.87% dhe kontribut negativ prej 0.35 pikë përqindje.

Gjithashtu edhe zhvillimet në tregun e punës deri më tani kanë qenë relativisht pozitive. Të dhënat më të fundit nga INSTAT sipas Anketës Tremujore të Forcave të Punës (LFS) në tremujorin e dytë të 2022, tregojnë se norma zyrtare e papunësisë për grupmoshat 15-64 vjeç është 11.5%, kundrejt 11.6% që ishte për të njëjtin tremujor të një viti më parë. Ndërsa për grup-moshën e punës 15 vjeç e lart, shkalla e papunësisë zyrtare në tremujorin e dytë të 2022 shënoi vlerën prej 11.1%. Numri i personave të papunë në moshë pune (15-64 vjeç) në tremujorin e dytë të vitit 2022 ishte 158,994 persona.

Në tremujorin e dytë të vitit 2022 numri të punësuarve në moshë pune (15-64 vjeç) ishte 1,222,734 persona. Krahasuar me të njëjtin tremujor të një viti më parë (T2-2021), numri i personave të punësuar, u rrit me 50,866 persona ose +4.34%.

Pozicioni i jashtëm i ekonomisë, një tjetër fundament tejet i rëndësishëm dhe tipikisht vulnerabël përballë goditjeve të tilla, mbeti relativisht solid, përtej pritshmërive fillestare për impaktin që mund të kishte ky fundament i ekonomisë prej goditjes së pandemisë dhe implikimeve negative zinxhir që mund të shkaktonte në fundamente të tjerë. Në vitin 2021 bilanci i pagesave u mbyll me një tepicë të konsiderueshme pozitive, duke u rritur edhe më tej në rreth 6.1% të PBB. Ndërkohë, në gjysmën e parë të vitit 2022, deficiti i llogarisë korrente shënon 468 milionë euro, i ngushtuar në terma vjetorë me rreth 51 milionë euro ose 10% kundrejt së njëjtës periudhë të një viti më parë. Gjithashtu, vetëm për tremujorin e dytë të 2022, deficiti i llogarisë korrente shënon 208 milionë euro, i ngushtuar në terma vjetorë me rreth 20 milionë euro (ose 9%) në sfondin e zgjerimit të suficitit tregtar në shërbime. Rritja e kërkesës turistike në vend ka rritur ndjeshëm numrin e vizitorëve të huaj, duke zgjeruar të ardhurat neto hyrëse nga

udhëtimet. Në të njëjtën kohë, shërbimet për përpunim të inputeve fizike të zotëruara nga të tjerët, zgjeruan ndjeshëm balancën e tyre pozitive.

Në gjysmën e parë të vitit 2022, të hyrat nga shërbimet të lidhura përgjithësisht me Turizmin pësuan rritje prej +64.6%, krahasuar me gjashtëmujorin e parë 2021. Gjithashtu për këtë periudhë, Remitancat shënuan rritje prej +10.7%. Kontributi pozitiv i këtyre faktorëve ka kompensuar plotësisht thellimin e deficitit tregtar në mallra si dhe zgjerimin e balancës negative të të ardhurave parësore.

Në gjysmën e parë të vitit 2021, Investimet e huaja direkte shënuan vlerën +634.4 milionë euro ose +35.1%, krahasuar me +469.6 milionë euro në gjashtëmujorin e parë 2021. Gjithashtu, vetëm për tremujorin e dytë të 2022, IHD regjistruan vlerën +337.1 milionë euro ose +43.2%, krahasuar me +235.4 milionë euro në tremujorin e dytë të 2021. Këtë tremujor, flukset valutore hyrëse në formën e investimeve të huaja direkte ishin të përqendruara kryesisht në sektorin e hidrokarbureve (në masën 18%), e energjitikës (në masën 13%), ndërmjetësimit financiar (në masën 5%), si dhe komunikacionit (në masën 2%).

Stoku i rezervës valutore, në fund të Qershorit 2022 shënon 4,910 milionë euro, i mjaftueshëm për mbulimin e 7.6 muaj importe mesatare vjetore në mallra dhe shërbime.

Këto zhvillime në pozicionin e jashtëm të ekonomisë dhe performancës relativisht të mirë të ekonomisë në tërësi janë reflektuar edhe në fondamentin tjetër mjaft të rëndësishëm të kursit të këmbimit. Duke pasur një regjim të lirë të kursit të këmbimit, monedha vendase (Leku) ka qëndruar mjaft stabil ndaj valutave kryesore (Euro, etj) edhe përgjatë vitit 2020 dhe 2021 dhe vijon të jetë mjaft stabil.

Qendrueshmëria e sektorit financiar, në terma të kapitalizimit, likuiditetit dhe përfitueshmërisë, vazhdon të mbetet një fundament tjetër i fortë dhe vijueshmërisht i përmirësuar i ekonomisë. Kreditë me probleme (NPL) kanë vijuar të ulen duke shënuar në fund të muajit korrik nivelin prej rreth 5.27% nga 8% që shënonin rreth dy vite më parë. Stoku total i kredive bankare në muajin Gusht 2022, pati një rritje me 12.6% krahasuar me të njëjtin muaj të vitit 2021. Stoku i kredive në lekë shënoi një rritje prej 8.7%, ndërsa ai në valutë rritje prej 17.0%, krahasuar me një vit më parë. Gjithashtu, kreditimi i sektorit privat të ekonomisë, ka njohur tashmë një zgjerim të qenësishëm deri në fund të muajit Gusht 2022, duke regjistruar një rritje prej mbi 9% kundrejt një viti më parë për kreditë ndaj bizneseve dhe mbi 13% për kreditë drejt konsumatorëve.

Sa i përket Depozitave, referuar të dhënave të deritanishme, gjatë muajit Gusht të vitit 2022 stoku total i depozitave bankare ka shënuar rritje me 7.5% krahasuar me të njëjtin muaj të vitit 2021. Stoku total i depozitave në Lekë pësoi rritje me 2.4%, ndërsa ai në valutë është rritur me 11.6%. Në Gusht 2022 rezulton se rreth 42.7% e totalit të stokut të depozitave përbëhet nga depozitat në Lekë, ndërsa pjesa tjetër prej 57.3% përbëhet nga depozitimet në valutë të huaj. Stoku total i depozitave vetëm për muajin Gusht 2022 shënoi rritje me 24 miliardë Lekë kundrejt muajit paraardhës (korrik 2022). Stoku total i depozitave të bizneseve në muajin Gusht të vitit 2022 shënoi rritje prej 15.2% krahasuar me Gushtin e vitit 2021, ndërsa stoku total i depozitave të individëve ka shënuar rritje prej 5.9% krahasuar me të njëjtin muaj të një viti më parë.

Inflacioni ka reflektuar goditjen e fundit të ofertës së jashtme, për shkak të luftës në Ukrainë, duke u kthyer në një nga çështjet kryesore makroekonomike për ekonominë tonë, ashtu si në shumë vende të tjera të botës. Në muajin Gusht 2022 ndryshimi vjetor i indeksit të çmimeve të konsumit është +8.0%, ndërsa një vit më parë ky ndryshim ishte +2.4%. Inflacioni mesatar për periudhën Janar – Gusht 2022 është +6.1%. Ndryshimi mujor i indeksit të çmimeve të konsumit në muajin Gusht 2022, krahasuar me Korrik 2022, është +0.8%. Megjithatë, është me rëndësi dhe në favor të zhvillimeve dhe perspektivës së

ekonomisë fakti që inflacioni në vendin tonë ka qenë ndjeshëm më i ulët se sa në vendit e rajonit, apo se sa mesatarja e vendeve të Bashkimit Evropian.

1.2 KRAHASIMI ME VENDET E RAJONIT

Bazuar në raportet dhe analizat e institucioneve ndërkombëtare, perspektiva afatmesme për vendet e Europës Juglindore dhe Ballkanit, parashikohet të jetë pozitive. Rritja mesatare e rajonit pritet të shkojë nga 7.4% në vitin 2021, në 3.1% për vitet në vijim. Ky rikthim në norma pozitive i rritjes ekonomike u shoqërua me një rritje të ndjeshme të vendeve të reja të punës, ku kërkesa për punësim solli ulje të varfërisë në të gjashtë ekonomitë e Ballkanit Perëndimor.

Për tremujorin e parë të vitit 2022, rajoni pati rritje vjetore me 4.7%, nga 6.3% që ishte në tremujorin e mëparshëm. Ky ngadalësim u shkaktua kryesisht nga një tkurrje e aktivitetit ekonomik në Serbi dhe në Bosnje-Hercegovinë. Krijimi i vendeve të punës vazhdoi edhe për tremujorin e parë të vitit 2022, megjithëse me një ritëm më të ngadaltë se në tremujorin e mëparshëm, me norma të papunësisë në rënie dhe rritje të pjesëmarrjes së fuqisë punëtore. Për tremujorin e parë të vitit 2022, deficitin i llogarisë korente për rajonin qëndroi në 6.5% e PBB-së, niveli më i lartë që nga tremujori i tretë i vitit 2020, ku rritja e deficitit të tregtisë së mallrave tejkaloi rikthimin e fortë të eksporteve të shërbimeve dhe flukseve më të larta të remitancave. Rimëkëmbja e vazhdueshme ekonomike dhe inflacioni i lartë sollën rritjen e të ardhurave buxhetore dhe ngushtimin e deficiteve fiskale për të gjithë rajonin e Ballkanit Perëndimor, ndërkohë që raporti i borxhit publik ndaj PBB-së u ul në shumicën e vendeve, krahasuar me fundin e vitit 2021.

Pavarësisht rikuperimit të fortë pas pandemisë, Ballkani Perëndimor po përballet aktualisht me një sërë sfidash të reja, të shtuara dhe nga lufta në Ukrainë, si rritja e çmimeve të energjisë dhe ushqimeve, inflacioni i lartë dhe ngadalësimi i tregtisë dhe investimeve. Rreziqet e kahut të poshtëm lidhur me perspektivën ekonomike të rajonit janë shqetësuese. Zgjerimi i konfliktit ose zgjatja e luftës në Ukrainë mund të shkaktojë ndërprerje të tjera në zinxhirët e tregtisë globale dhe rritje të mëtejshme të çmimeve të energjisë dhe ushqimeve. Në rast se kushtet e financimit në tregjet ndërkombëtare do të jenë edhe më të shtrënguara, mund të shfaqen rreziqe që lidhen me rifinancimin e borxhit. Qëndrueshmëria e borxhit mund të kthehet në një shqetësim nëse hapësira e kufizuar fiskale do të ezaurohet nga politika të ndërmarra si kundërpërgjigje ndaj çmimeve më të larta të energjisë dhe ushqimeve dhe në kushtet e rritjes së kostove të rifinancimit.

Aktualisht, rajoni i Ballkanit Perëndimor nuk mund të ketë rritje të qëndrueshme ekonomike pa reforma strukturore që nxisin rritjen e produktivitetit, konkurrencës, investimeve në kapitalin njerëzor dhe forcimin e qeverisjes. Ulja e kostove rregullatore për bizneset, rritja e konkurrencës në treg, mbështetja e pjesëmarrjes në tregun e punës dhe forcimi i pavarësisë së institucioneve publike janë të gjitha masa që do të mbështesnin rritjen ekonomike në një mjedis të pasigurt.

Tabela 1: Produkti i Brendshëm Bruto (rritja vjetore në %, në terma realë)

| | 2017 | 2018 | 2019 | 2020 | 2021 | 2022* |
|------------------------|-------------------------------------|------------|------------|-------------|------------|------------|
| | <i>Rritja reale ekonomike, në %</i> | | | | | |
| Shqipëria | 3.8 | 4.0 | 2.1 | -3.5 | 8.5 | 3.7 |
| Bosnja dhe Hercegovina | 3.0 | 3.3 | 2.8 | -3.2 | 6.9 | n.a |
| Kosova | 4.8 | 3.4 | 4.8 | -5.3 | 10.5 | n.a |
| Maqedonia | 1.2 | 2.8 | 3.9 | -6.1 | 4.2 | 3.0 |
| Mal i Zi | 4.7 | 5.1 | 4.1 | -15.3 | 12.4 | 3.8 |
| Serbia | 2.1 | 4.5 | 4.3 | -0.9 | 7.4 | 3.4 |

| | | | | | | |
|----------------------------|-----|-----|-----|------|-----|-----|
| Mesatarja e rajonit | 3.9 | 3.7 | 3.3 | -5.7 | 7.4 | 3.1 |
|----------------------------|-----|-----|-----|------|-----|-----|

Burimi: Komisionit Evropian (DG-ECFIN), MFE

Për tremujorin e parë 2022, deficitet e llogarisë korente për rajonin ishte 6.5% e PBB-së, niveli më i lartë që nga tremujori i tretë i vitit 2020. Deficitet vazhduan të financohen kryesisht nga flukset hyrëse neto të IHD-ve.

Tabela 1: Balanca Korrente (% të PBB)

| | 2017 | 2018 | 2019 | 2020 | 2021 | 2022* |
|---|-------------|-------------|-------------|-------------|-------------|-------------|
| <i>Balanca e llogarisë korente, (në % ndaj PBB)</i> | | | | | | |
| Shqipëria | -7.5 | -6.8 | -7.9 | -8.7 | -7.7 | -8.3 |
| Bosnja dhe Hercegovina | -4.8 | -3.3 | -2.8 | -3.8 | -2.1 | n.a |
| Kosova | -5.5 | -7.6 | -5.7 | -7.0 | -8.6 | n.a |
| Maqedonia | -1.0 | -0.1 | -3.3 | -3.4 | -3.5 | -4.1 |
| Mal i Zi | -16.1 | -17.0 | -14.3 | -26.1 | -9.3 | -12.1 |
| Serbia | -5.2 | -4.8 | -6.9 | -4.1 | -4.4 | -6.5 |
| Mesatarja e rajonit | -6.4 | -6.0 | -5.7 | -8.9 | -6.0 | n.a |

Burimi: Komisionit Evropian (DG-ECFIN), MFE

Zhvillimet e jashtme në Ballkanin Perëndimor gjatë tremujorit të parë të vitit 2022 u nxitën kryesisht nga rimëkëmbja e fortë e eksporteve të shërbimeve (përkatësisht e turizmit), rritja e remitancave si dhe rritja e vazhdueshme e eksporteve të mallrave në shumicën e vendeve të rajonit.

Tabela 2: Bilanci tregtar i mallrave (% të PBB)

| | 2017 | 2018 | 2019 | 2020 | 2021 | 2022* |
|---|--------------|--------------|--------------|--------------|--------------|--------------|
| <i>Balanca tregtare (në % ndaj PBB)</i> | | | | | | |
| Shqipëria | -24.4 | -22.4 | -22.9 | -22.5 | -24.8 | -24.0 |
| Bosnja dhe Hercegovina | -23.6 | -22.5 | -22.6 | -18.4 | -19.3 | n.a |
| Kosova | -42.0 | -44.6 | -44.1 | -41.7 | -49.9 | n.a |
| Maqedonia | -17.8 | -16.2 | -17.3 | -17.0 | -20.2 | -21.4 |
| Mal i Zi | -43.3 | -43.9 | -41.7 | -39.2 | -39.0 | -36.5 |
| Serbia | -10.2 | -11.9 | -12.2 | -11.1 | -11.1 | -12.9 |
| Mesatarja e rajonit | -24.0 | -23.8 | -23.3 | -25.0 | -27.4 | n.a |

Burimi: Komisionit Evropian (DG-ECFIN), MFE

Krijimi i vendeve të punës vazhdoi edhe për tremujorin e parë të vitit 2022, megjithëse me një ritëm më të ngadaltë se në tremujorin e mëparshëm, me normat e papunësisë në rënie dhe me rritjen e pjesëmarrjes së fuqinë punëtore në shumicën e vendeve të rajonit të Ballkanit Perëndimor.

Tabela 3: Norma e papunësisë (në %)

| | 2017 | 2018 | 2019 | 2020 | 2021 | 2022* |
|----------------------------|-------------|-------------|-------------|-------------|-------------|-------------|
| Shqipëria | 14.1 | 12.8 | 12.0 | 12.2 | 12.0 | 11.3 |
| Bosnia dhe Hercegovina | 20.5 | 18.4 | 15.7 | 15.9 | 17.4 | n.a |
| Kosova | 30.5 | 29.6 | 25.7 | 25.9 | | n.a |
| Maqedonia e Veriut | 22.6 | 21.0 | 17.5 | 16.6 | 15.8 | 15.3 |
| Mal i Zi | 16.4 | 15.5 | 15.4 | 18.4 | 16.9 | 15.2 |
| Serbia | 14.5 | 13.7 | 11.2 | 9.7 | 11.0 | 10.0 |
| Mesatarja e rajonit | 18.5 | 17.5 | 15.9 | 16.5 | n.a | n.a |

Burimi: Komisionit Evropian (DG-ECFIN), MFE

Rimëkëmbja e vazhdueshme ekonomike dhe inflacioni i lartë mbështetën rritjen e të ardhurave buxhetore dhe ngushtimin e deficiteve fiskale në të gjithë Ballkanin Perëndimor për tremujorin e parë të vitit 2022, ndërkohë që raporti i borxhit publik ndaj PBB-së u ul në shumicën e vendeve të rajonit, në krahasim me fundin e vitit 2021.

Tabela 4: Balanca e përgjithshme e qeverisë (Deficiti fiskal në % të PBB)

| | 2017 | 2018 | 2019 | 2020 | 2021 | 2022* |
|------------------------|---|-------------|-------------|-------------|-------------|-------------|
| | <i>Balanca fiskale, (në % ndaj PBB)</i> | | | | | |
| Shqipëria | -2.0 | -1.6 | -1.9 | -6.7 | -4.5 | -3.4 |
| Bosnja dhe Hercegovina | 2.6 | 2.2 | 1.9 | -5.3 | 3.5 | n.a |
| Kosova | -1.3 | -2.9 | -2.9 | -7.6 | -1.3 | n.a |
| Maqedonia | -2.7 | -1.8 | -2.0 | -8.2 | -5.4 | -6.1 |
| Mal i Zi | -5.3 | -3.9 | -2.0 | -11.1 | -1.9 | -4.4 |
| Serbia | 1.1 | 0.6 | -0.2 | -8.0 | -4.1 | -3.1 |
| Mesatarja e rajonit | -1.3 | -1.2 | -1.2 | -7.8 | -2.3 | n.a |

Burimi: Komisionit Evropian (DG-ECFIN), MFE

Tabela 5: Borxhi publik total (% të PBB)

| | 2017 | 2018 | 2019 | 2020 | 2021 | 2022* |
|------------------------|--|-------------|-------------|-------------|-------------|-------------|
| | <i>Borxhi publik dhe i garantuar (në % ndaj PBB)</i> | | | | | |
| Shqipëria | 70.2 | 67.7 | 65.8 | 74.5 | 73.2 | 68.9 |
| Bosnja dhe Hercegovina | 36.1 | 34.1 | 32.8 | 36.6 | 35.4 | n.a |
| Kosova | 16.4 | 17.0 | 17.6 | 22.4 | 21.9 | n.a |
| Maqedonia | 39.4 | 40.4 | 40.5 | 51.9 | 51.8 | 54.6 |
| Mal i Zi | 63.3 | 70.1 | 76.5 | 105.3 | 83.3 | 76.7 |
| Serbia | 59.2 | 53.7 | 52.0 | 57.0 | 56.5 | 54.5 |
| Mesatarja e rajonit | 44.7 | 44.8 | 45.5 | 58.0 | 54.0 | n.a |

Burimi: Komisionit Evropian (DG-ECFIN), MFE

1.3 PARASHIKIMET AFATMESME 2023-2025

Pas recesionit të fortë në vitin 2020, në normën prej -3.5 përqind, ekonomia është rikuperuar fuqishëm në vitin 2021, në normën 8.5 përqind dhe parashikohet të vijojë trendin pozitiv në periudhën afatmesme. Rritja ekonomike parashikohet në 3.7 përqind për vitin 2022 dhe parashikohet të vijojë të qëndrojë afër nivelit prej 3.7 përqind përgjatë periudhës afatmesme. Për vitin 2023 parashikohet që rritja ekonomike të ngadalësohet në 2.6 përqind, e ndikuar nga zhvillimet dhe pritshmëritë për ekonominë globale dhe veçanërisht atë të Bashkimit Evropian.

Gjatë periudhës afatmesme rritja pritet të gjenerohet kryesisht nga kërkesa e brendshme, si nga konsumi privat ashtu edhe nga investimet. Gjithashtu edhe kërkesa e jashtme neto pritet të ketë efekt neto pozitiv. Eksportet si të mallrave ashtu edhe të shërbimeve (veçanërisht turizmi) pritet të kenë një ecuri të mirë, por njëkohësisht pritet që edhe importet të kenë po ashtu një rritje (në reflektim të rritjes së kërkesës agregate, veçanërisht investimeve), e për rrjedhojë kontributi neto i kërkesës së huaj në afat-mesëm pritet të jetë sërish pozitiv, por më i moderuar se ai i kërkesës së brendshme.

Specifikisht, konsumi final total për periudhën afatmesme (2023 – 2025) parashikohet të rritet në terma real me mesatarisht rreth 2 përqind në vit, duke kontribuar me mesatarisht rreth 1.8 pikë përqindje në vit në rritjen e PBB. Ndërsa investimet totale në ekonomi parashikohen të rriten në terma real me rreth 3.9 përqind në vitet 2023-2025, me një kontribut mesatar në rritjen totale prej rreth 0.9 pikë përqindje në vit.

Sa i takon më specifiku të komponentëve të kërkesës së huaj neto, eksportet e mallrave dhe shërbimeve për periudhën 2023-2025, parashikohen të rriten me mesatarisht rreth 3.4 përqind në vit në terma real, me një kontribut mesatar pozitiv prej rreth 1.4 pikë përqindje në vit në rritjen e PBB. Ndërsa importet e mallrave dhe shërbimeve për këtë periudhë afatmesme parashikohen të zgjerohen me mesatarisht rreth 1.1 përqind në vit me një kontribut mesatar negativ në rritjen e PBB me rreth 0.6 pikë përqindje në vit. Rrjedhimisht, në terma neto kërkesa e huaj parashikohet të ketë një kontribut pozitiv në rritjen totale të PBB me mesatarisht rreth 0.8 pikë përqindje në vit.

Treguesit kryesorë makroekonomikë

| Treguesit | Njësia | 2018 | 2019 | 2020 | 2021 | 2022 | 2023 | 2024 | 2025 |
|---|--------------|----------|----------|----------|----------|----------|----------|----------|----------|
| | | | | | Vler. | Para. | Para. | Para. | Para. |
| Popullsia | Milion | 29 | 29 | 28 | 28 | 28 | 28 | 28 | 28 |
| Inflacioni (mesatar) | % | 2.0 | 1.4 | 1.6 | 2.0 | 6.5 | 3.6 | 3.0 | 3.0 |
| Deflatori i PBB | % | 1.5 | 1.3 | 0.7 | 5.9 | 5.1 | 3.0 | 1.2 | 1.1 |
| Kursi i këmbimit (mesatar) | Lek / USD | 108.0 | 109.9 | 108.6 | 103.5 | 113.1 | 113.1 | 113.1 | 113.1 |
| Kursi i këmbimit (mesatar) | Lek / Euro | 127.6 | 123.0 | 123.8 | 122.5 | 119.6 | 119.6 | 119.6 | 119.6 |
| Faktori i Konvertimit sipas Paritetit të Fuqisë Blerese (PPP) | Lek / USD | 41.3 | 40.6 | 40.6 | 40.6 | 40.6 | 40.6 | 40.6 | 40.6 |
| Faktori i Konvertimit sipas Paritetit të Fuqisë Blerese (PPP) | Lek / Euro | 55.7 | 55.7 | 55.7 | 55.7 | 55.7 | 55.7 | 55.7 | 55.7 |
| Rritja reale e PBB | % | 4.0 | 2.1 | -3.5 | 8.5 | 3.7 | 2.6 | 3.8 | 3.9 |
| PBB | Lek miliardë | 1,636.7 | 1,691.9 | 1,644.1 | 1,889.8 | 2,058.2 | 2,176.1 | 2,285.9 | 2,401.8 |
| PBB | USD miliardë | 15.2 | 15.4 | 15.1 | 18.3 | 18.2 | 19.2 | 20.2 | 21.2 |
| PBB | Euro miliard | 12.8 | 13.8 | 13.3 | 15.4 | 17.2 | 18.2 | 19.1 | 20.1 |
| PBB për banor | Lek mijë | 571.0 | 592.8 | 579.3 | 667.4 | 728.6 | 772.5 | 814.1 | 858.4 |
| PBB për banor | USD | 5,287.7 | 5,396.2 | 5,332.2 | 6,447.1 | 6,440.8 | 6,828.8 | 7,195.9 | 7,587.7 |
| PBB për banor | Euro | 4,475.4 | 4,818.8 | 4,680.9 | 5,449.9 | 6,093.7 | 6,460.8 | 6,808.1 | 7,178.9 |
| PBB për banor | USD-PPP | 13,842.6 | 14,612.5 | 14,281.2 | 16,452.0 | 17,961.4 | 19,043.6 | 20,067.2 | 21,160.0 |
| PBB për banor | Euro-PPP | 10,246.7 | 10,648.9 | 10,407.5 | 11,989.5 | 13,089.5 | 13,878.1 | 14,624.1 | 15,420.5 |
| Norma e papunësisë | % | 13.0 | 12.9 | 12.2 | 12.6 | 11.3 | 10.2 | 9.3 | 8.5 |
| Të ardhurat totale | % të PBB | 27.5 | 27.2 | 25.9 | 27.0 | 28.2 | 29.0 | 28.3 | 28.3 |
| Shpenzimet totale | % të PBB | 29.1 | 29.1 | 32.6 | 31.6 | 31.5 | 31.6 | 30.5 | 30.4 |
| Bilanci i përgjithshëm | % të PBB | -1.6 | -1.9 | -6.7 | -4.5 | -3.3 | -2.6 | -2.2 | -2.2 |
| Bilanci primar fiskal | % të PBB | 0.6 | 0.2 | -4.6 | -2.6 | -1.3 | 0.3 | 0.9 | 1.1 |
| Bilanci korrent fiskal | % të PBB | 3.2 | 2.6 | -0.5 | 2.3 | 2.2 | 2.9 | 2.9 | 3.0 |
| Borxhi publik NETO nga gjendja e likuiditetit në TSA (Neto) | % të PBB | 64.6 | 64.8 | 74.0 | 69.3 | 67.7 | 66.5 | 65.3 | 64.3 |
| Borxhi Publik (Bruto) | % të PBB | 67.7 | 65.8 | 74.5 | 73.2 | 68.8 | 67.5 | 66.4 | 65.4 |
| <i>Borxhi publik i qeverisë së përgjithshme</i> | % të PBB | 64.9 | 63.3 | 71.5 | 70.3 | 65.4 | 64.2 | 63.4 | 62.5 |
| <i>Borxhi publik jashtë treguesve fiskale</i> | % të PBB | 2.8 | 2.5 | 3.0 | 2.9 | 3.4 | 3.4 | 3.0 | 2.9 |
| Bilanci i llogarisë korrente | % të PBB | -6.8 | -7.9 | -8.7 | -7.6 | -7.9 | -8.1 | -6.4 | -5.4 |
| Bilanci tregtar (Mallra & Shërbime) | % të PBB | -13.7 | -13.7 | -14.5 | -13.2 | -12.6 | -11.8 | -10.5 | -9.2 |
| Mallra | % të PBB | -22.4 | -22.9 | -22.5 | -24.8 | -25.9 | -24.9 | -23.9 | -22.9 |
| Eksperte | % të PBB | 7.7 | 6.6 | 6.0 | 8.2 | 11.4 | 11.3 | 11.4 | 11.5 |
| Importe | % të PBB | -30.1 | -29.4 | -28.4 | -33.0 | -37.2 | -36.2 | -35.3 | -34.4 |
| Bilanci i pagesave | % të PBB | 2.9 | -0.6 | 4.9 | 6.1 | 2.4 | 2.1 | 3.8 | 4.7 |
| Rezervat valutore | Euro milion | 3,399.0 | 3,359.6 | 3,942.4 | 4,972.2 | 5,382.3 | 5,768.6 | 6,503.9 | 7,438.6 |
| Në muaj importi mallrash e shërbimesh | Muaj | 7.0 | 6.5 | 9.6 | 8.8 | 7.2 | 7.5 | 8.2 | 9.1 |

Burimi: INSTAT, Banka e Shqipërisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Banka Botërore

2. TREGUESIT KRYESORË TË BUXHETIT PËR VITIN 2023

2.1 PARASHIKIMI I TË ARDHURAVE PËR VITIN 2023

Në programimin e të ardhurave nga Tatimet dhe Doganat për vitin 2023, janë marrë në konsideratë faktorët kryesorë me ndikim në buxhet vjen si rrjedhojë e një analize të mirëfilltë nga ana e strukturave përgjegjëse në MFE, sipas së cilës rezultojnë të kemi rritje të të ardhurave si rezultat i mireadministrimit, luftës ndaj informalitetit dhe kontrollit të zinxhirit të transaksioneve ndërmjet operatorëve duke u

fokusuar ne ato segmente dhe tatimpagues që kontribuojnë më shumë tek të ardhurat. Projektionet tona janë optimiste edhe duke marrë në konsideratë rritjen e çmimeve të të gjithë produkteve dhe kryesisht të karburantit, energjisë të cilët kanë një peshë të konsiderueshme në arkëtimin e të ardhurave.

Programimi i të ardhurave për vitin 2023, mbështet synimet e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për rritjen e të ardhurave, si dhe mbajtjen nën kontroll të defiçitit buxhetor dhe borxhit publik. Ky program bazohet në faktorët që do impaktojnë këtë periudhë dhe risqet e mundshme që mund të shfaqen (inflacioni, importet, çmimet, investimet, energjia elektrike etj.).

Metodologjia e programimit të të ardhurave është bazuar në modelet bashkëkohore të programimit, dhe në analizën e detajuar të faktorëve që ndikojnë në secilën taksë dhe tatim. Modeli i përdorur bazohet në parashikimet makroekonomike për periudhën 2022-2025 si rritja nominale, deflatori, analiza e importeve të grup produkteve kryesore, analiza e serive kohore si dhe modelet e bazuar në koeficientin e elasticitetit “Buoyancy” dhe “Effective Tax Rate” për çdo taksë.

Në planifikim janë harmonizuar faktorët makroekonomikë, me treguesit kryesorë që ndikojnë në taksa specifike. Në mënyrë të detajuar treguesit kryesorë për vlerësimin e të ardhurave janë:

- Rritja nominale të PBB-së, duke analizuar këtë efekt në mënyrë të integruar me faktorë të tjerë për çdo taksë në veçanti, të ndërlidhur me të dhënat historike dhe projektionet e çmimeve në tregjeve ndërkombëtare tek taksat ad-valorem si Tatimi mbi Vlerën e Shtuar, Renta Minerare dhe Taksa Doganore.
- Kursi i pritshëm i këmbimit të dy monedhave kryesore: USD dhe EURO me Lekun;
- Çmimet në bursë të karburantit, energjisë, që ndikojnë në të ardhurat nga TVSH-ja dhe Renta minerare;
- Sasitë e pritshme të importit të mallrave.

Në vitin 2023, të ardhurat totale të buxhetit të shtetit parashikohen të arrijnë 625.7 miliardë lekë, nga këto, të ardhurat tatimore 587.8 miliardë lekë dhe brenda zërit të të ardhurave tatimore, të ardhurat që mbliidhen nga tatimet dhe doganat 431.2 miliardë lekë. Ndërkohë, të ardhurat nga kontributet planifikohen 126.5 miliardë lekë.

Krahasuar me të pritshmin e vitit 2023, të ardhurat gjithsej të buxhetit të shtetit rriten 7.7 %, ndërkohë që të ardhurat tatimore nga tatimet dhe doganat programohen të rriten 8% ose +42.2 miliardë lekë.

Të ardhurat tatimore dhe doganore, përfshirë edhe kontributete e mbledhura nga administrata tatimore janë parashikuar bazuar në analizën e trendit historik të 60 grup-produkteve kryesore, për një periudhë shumëvjeçare. Ky parashikim është korriguar me efektet e faktorëve të tjerë të jashtëm në secilën taksë.

Faktorët që janë marrë në konsideratë të cilët ndikojnë në rritjen e të ardhurave për vitin 2023 janë:

- Kuadri makroekonomik me rritja reale të Prodhimit të Brendshëm Bruto 3.2%, inflacioni i parashikuar 3%, duke analizuar të këtë efekt në mënyrë të integruar me faktorë të tjerë për çdo taksë në veçanti, të ndërlidhur me të dhënat historike dhe projektionet e çmimeve në tregjeve ndërkombëtare tek taksat ad-valorem si Tatimi mbi Vlerën e Shtuar, Renta Minerare dhe Taksa Doganore. Në projektion janë përfshirë, faktorë që lidhen me rritjen nominale e PBB-së, kursin mesatar të këmbimit EURO-Lek dhe USD-Lek, si dhe çmimet brent të naftës bruto dhe mineraleve të tjera.

- Paketa e Fiskale 2023, me propozimet në lidhje me ndryshimet e bëra në kuadrin e hartimit të paketës fiskale 2023, të cilat prekin sjellin efekte në Akcizë, Tatimin mbi Fitimin, Tatimin mbi të Ardhurat nga Punësimi dhe Kontributet e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore, të cilat janë listuar më poshtë.
- Të ardhura të shuara nga mirëadministrimi në kuadër të hartimit të Strategjisë Afatmesme të të Ardhurave, në të cilën për një periudhë 4 vjeçare parashikohet një rritje e të ardhurave me 1.5% PBB, e cila e për çdo vit llogaritet një rritje prej 0.37% të PBB.

Tab 7

| | Përshkrimi | Taksa |
|----|---|----------------|
| 1 | Te ardhurat e pritshme nga tatimet dhe dogana për vitin 2022 (përfshire kontributet) | 515,500 |
| 2 | Të ardhura one-off | -3,000 |
| 3 | Projeksion 2023 | 512,500 |
| 4 | Të ardhurat nga rritja reale 2023 | 16,400 |
| 5 | Efekti i inflacionit | 5,700 |
| 6 | Projeksion 2023 nga rritja dhe inflacioni | 534,600 |
| 7 | Masat fiskale | 14,800 |
| a | Paketa fiskale 2023 | 4,500 |
| b | Lojrat e fatit | 2,000 |
| c | Taksim Special | 8,300 |
| 11 | Projeksion 2023 | 549,400 |
| 12 | Përmirësime nga administrimi | 8,300 |
| 13 | Projeksioni Final 2023 | 557,700 |

Parashikimi i të ardhurave sipas zërave për vitin 2023

Të ardhurat nga “T.V.SH-ja” parashikohet të jetë rreth 211 miliardë lekë, 15 miliardë lek ose 7.6% më shumë se pritshmëria për vitin 2022. Burimet e rritjes së TVSH-së në vitin 2023 do të jenë:

- TVSH-së që do të gjenerohet si rezultat i rimëkëmbjes ekonomike;
- TVSH nga rritja e volumit të importeve dhe konjuktura e çmimeve ndërkombëtare;
- TVSH nga përmirësimi i administrimit, lufta ndaj informalitetit dhe kontrolli i zinxhirit të transaksioneve ndërmjet operatorëve;
- TVSH si rezultat i miradminstrit tatimor.

Të ardhurat nga “Tatimi mbi Fitimin” vlerësohen me rritje 4.2% ose 2 miliardë lekë më shumë se viti 2022, pra parashikohet të arkëtohen 49.5 miliardë lekë. Rritja e parashikuar në tatimin mbi fitimin bazohet:

- Në rikuperimin e ekonomisë dhe rritjen e saj, çka do reflektohet edhe në deklaratat e tatimpaguesve;
- Në forcimin e kontrollit të deklaratave, bazuar në kriteret e riskut;
- Efektet e paketës fiskale 2023.

Të ardhurat nga “Akciza” vlerësohen të jenë 59 miliardë lekë, me një rritje prej 4 miliardë lekë ose 7.3% më shumë se pritshmëritë për vitin 2022. Faktorët kryesorë që do ndikojnë në rritjen e parashikuar

të të ardhurave nga akciza lidhen me: rritjen e importit të mallrave të fortë si karburante dhe cigare, si dhe forcimin e luftës kundër informalitetit, nëpërmjet kontrollit rigoroz të subjekteve të akcizës si dhe disiplinimit të mëtejshëm të procedurave të përfitimit të përjashtimeve dhe rimbursimeve nga kjo taksë si dhe efektet e paketës fiskale.

Të ardhurat nga “Tatimi mbi të Ardhurat Personale” parashikohen 49 miliardë lekë, me një rritje prej 2.5 miliardë lekë ose 5.4% më shumë se pritshmëritë për vitin 2022. Në parashikimin e të ardhurave nga tatimi mbi të ardhurat personale janë marrë në konsideratë rimëkëmbja ekonomike dhe impakti i saj në nivelin e pagës mesatare si dhe rritja e numrit të të punësuarve në sektorin privat, si dhe incentivat për nxitjen e punësimit si dhe efektet e paketës fiskale 2023.

Të ardhurat nga “Taksa Nacionale dhe të tjera” vlerësohen të jenë 54.3 miliardë lekë. Parashikimet për këtë taksë për vitin 2023 janë 31% ose 12.8 miliardë lekë më shumë se i pritshmi 2022 dhe bazohen në rritjen e mbledhjes së taksës së qarkullimit të automjeteve si dhe rezultat i sasive të karburantit që do të hidhen në treg. Në këtë takse janë të përfshira:

a) *Të ardhurat nga “Takse mbi Lojrat e Fatit”* në vitin 2023 vlerësohet të jenë 2 miliardë lekë. Nga miratimi në ligj i lojrave të fatit ‘baste sportive’, me efekt nga 1 janari 2023, vlerësohet të arkëtohen në buxhetin e shtetit 2 miliardë lekë.

b) *Taksa speciale për “prodhuesit e energjisë elektrike që e eksportojnë”*
Fitimet e realizuara nga prodhuesit e energjisë elektrike, të cilët, për shkak të çmimeve shumëfish të rritura gjatë vitit 2022, kanë realizuar fitime pa rritje kostosh, do taten për këto fitime shtesë me tarifën 33%. Të ardhurat e pritshme vlerësohen të jenë 8.3 miliardë lekë.

Të ardhurat nga “Taksa Doganore” në vitin 2023 vlerësohet të jenë 8.5 miliardë lekë, parashikimi për vitin 2023 sipas projeksioneve, parashikohet e njëjta vlerë arkëtimeve. Në programimin e të ardhurave janë marrë në konsideratë efektet e rritjes së importeve të tatueshme, si dhe disa efekte minimale nga lëvizja e tarifave doganore.

Të ardhurat nga “Kontributet për Sigurime Shoqërore e Shëndetësore” në vitin 2023 parashikohet të rriten me 5%, ose 6 miliardë lekë krahasuar me të pritshmin e vitit 2022. Të ardhurat gjithsej nga kontributet priten të jenë në total, së bashku me të ardhurat që mbledhin ISSH dhe ISKSH 126.5 miliardë lekë, nga 120.5 miliardë lekë që parashikohet se do arkëtohen në vitin 2022. Të ardhurat totale 126.5 miliardë lekë parashikohet të mblidhen :

→ 126.5 miliardë lekë Kontribute Shoqërore dhe Shëndetësore e ndarë në:

- 109.4 miliardë lekë Kontribute Shoqërore
- 17.1 miliardë lekë Kontribute Shëndetësore

Rritja e programuar e të ardhurave mbështetet në këta faktorë:

- rritjen ekonomike çka do reflektohet në rritjen e numrit të punëmarrësve;
- forcimin e administrimit nëpërmjet kontrollit të nivelit të pagës të deklaruar dhe deviacionit të saj nga paga reale që përfitohet;
- rritja e pagës minimale nga 32.000 lekë në 34.000 lekë.

Tabela 8

(në milionë lekë)

| Lloji i taksave | Fakt 2021 | I Pritshmi 2022 | Projeksioni 2023 |
|-----------------|-----------|-----------------|------------------|
| | | | |

| TVSH Neto TOTAL | 161,536 | 196,000 | 210,900 |
|---|----------------|----------------|----------------|
| Tatimi mbi fitimin | 35,610 | 47,500 | 49,500 |
| Akciza | 51,637 | 55,000 | 59,000 |
| Tatimi mbi të ardhurat personale | 39,312 | 46,500 | 49,000 |
| Taksat Nacionale Total | 42,521 | 41,500 | 54,300 |
| Taksë doganore | 7,457 | 8,500 | 8,500 |
| TOTAL TATIME + DOGANA | 338,073 | 395,000 | 431,200 |
| Kontributet total | 106,266 | 120,500 | 126,500 |
| TOTAL DPD + DPT (Kontributet) | 444,339 | 515,500 | 557,700 |

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022)

2.2 SHPENZIMET PUBLIKE

Totali i shpenzimeve publike për vitin 2023 është planifikuar **687.2 miliardë lekë** ose **31.6% e PBB**.

Shpenzimet e personelit për vitin 2023, reflektojnë koston aktuale të Administratës Publike, si dhe politikën e re të rritjes së pagave për sektorët e shëndetësisë, arsimit dhe mbrojtjes (nisur në 1 korrik 2022) si dhe rritjen e pagave për administratën publike (nisur në 1 shtator 2022) me mesatarisht 7%. Fondi vjetor për rritjen e pagave është planifikuar në shumën 2.3 miliardë lekë dhe parashikon rritjen e pagës për funksion me 6% për punonjësit e sistemit shëndetësor dhe ata arsimorë. Shpenzimet totale për pagat në Administratën Publike janë planifikuar në masën **96.8 miliardë lekë** ose **4.5% e PBB**.

Shpenzimet për interesa parashikohen në nivelin **60.9 miliardë lekë** ose **2.8% të PBB**, duke përfshirë në të dhe një rezervë prej 4.9 miliardë lekë për të mitiguar risqet e mundshme nga luhajtjet e normave të interesit, kursit të këmbimit etj.

Shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes për qeverisjen qendrore për vitin 2023 (pa përfshirë shpenzimet që realizohen nga institucione publike, që kanë si burim financimi të ardhurat jashtë limitit), janë parashikuar në masën **61.4 miliardë lekë** ose rreth **2.8% e PBB-së**. Në këtë zë është programuar mbështetja me prioritet e politikave ekzistuese të qeverisjes qendrore si: skema e fermerëve, mirëmbajtja e rrugëve nacionale, programet e nxitjes së punësimin, skemat për mbështetjen e zhvillimit ekonomik dhe mbështetje për arsimin dhe sportin.

Shpenzimet e buxhetit vendor për vitin 2023, janë parashikuar në masën **65.5 miliardë lekë**, me një rritje prej 8.8% më shumë se buxheti i vitit 2022. Këto shpenzime për vitin 2023, zënë 3% të PBB-së nga 2.3% që zinin në vitin 2013. Reformat në qeverisjen vendore ndër vite janë fokusuar si në thellimin e decentralizimit fiskal, ashtu edhe menaxhimin e financave publike në nivel vendor. Gjatë viteve të fundit, procesi i menaxhimit të financave publike vendore është shoqëruar me sfida për shkak të pasojave të pandemisë COVID-19, rindërtimit nga tërmetet e vitit 2019 dhe krizës ekonomike si rrjedhojë e luftës në Ukrainë. Përballimi i këtyre sfidave të mëdha ekonomike dhe buxhetore nga njësitë e vetëqeverisjes vendore gjatë kësaj periudhe, është një tregues pozitiv i punës së zhvilluar në këto vite në drejtim të stabilitetit makroekonomik, parashikueshmërisë së fondeve dhe transparencës së përdorimit me disiplinë

të fondeve buxhetore. Transferta e pakushtëzuar për vitin 2023, krahasuar me vitin 2022 është **3 miliardë lekë** më shumë osë rreth **16.1 përqind** më e lartë dhe krahasuar me vitin 2015 (viti para reformës administrativo-territoriale), është **9.4 miliardë lekë** më shumë ose rreth **76.4 përqind më e lartë**. Në transfertën e pakushtëzuar të parashikuar për vitin 2023, **21.7 miliardë lekë**, do të shtohen edhe fondet prej **9.8 miliardë lekë** transfertë e pakushtëzuar sektoriale për funksionet e reja. Në total, në vitin 2023, granti nga buxheti i shtetit për pushtetin vendor do të jetë në shumën **31.5 miliardë lekë**. Të ardhurat e veta të pushtetit vendor nga viti 2015 në vitin 2023 kanë pësuar një rritje të ndjeshme me rreth **17.4 miliardë lekë**, ndërkohë krahasuar me vitin 2022 janë rritur me rreth **1.5 miliardë lekë**.

Shpenzimet e fondeve speciale që përfshin shpenzimet totale për Fondet e Sigurimeve Shoqërore, Shëndetësore dhe kompensimin në vlerë të ish-pronarëve, janë planifikuar në vlerën prej **226.35 miliardë lekë**. Niveli i shpenzimeve për *Skemën e Sigurimeve Shoqërore* për vitin 2023, parashikohet në masën **162.6 miliardë lekë** ose **7.5% e PBB**. Nga ky fond, për indeksimin e pensioneve është parashikuar niveli prej **1.2 miliardë lekë** dhe **3.5 miliardë lekë** për bonusin e fundvitit për pensionistët. Ndërsa, shpenzimet e *Skemës së Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor* për vitin 2023 janë parashikuar në masën **54.5 miliardë lekë** ose **2.5% e PBB**.

Së fundi, shpenzimet për *Fondin e Kompensimit në vlerë të Pronarëve*, parashikohen në total në masën **4.5 miliardë lekë** ose **0.2% e PBB**.

Shpenzime të tjera sociale, përfshin fondet për pagesën e papunësisë, aftësisë së kufizuar, ndihmës ekonomike, dëmshpërblimin e ish-të përndjekurve politikë dhe bonusin e lindjeve.

- Shpenzimet për pagesën e papunësisë parashikohen në nivelin **900 milionë lekë**.
- Shpenzimet për pagesën e ndihmës ekonomike dhe aftësisë së kufizuar parashikohen në nivelin **25.95 miliardë lekë** ose **1.2% e PBB**.
- Për ish-të përndjekurit është parashikuar një fond prej **1 miliardë lekë** ose **0.05% e PBB**.
- Për bonusin e lindjeve është parashikuar një fond prej **2.2 miliardë lekë** ose **0.1% e PBB**.

Shpenzimet për subvencione janë parashikuar në masën **1.6 miliardë lekë** duke u rritur krahasuar me një vit më parë. Këto shpenzime shkojnë për mbështetjen e sektorit të ujësjellës-kanalizimeve bazuar në performancën e tij, si dhe për të mbuluar një pjesë të shpenzimeve të veprimtarisë hekurudhore dhe veprimtarisë së shërbimeve qeveritare.

Niveli i Fondit Rezervë për vitin 2023, planifikohet në masën **6.6 miliardë lekë**, përkatësisht **1.8 miliardë lekë** Fond Rezervë i Këshillit të Ministrave dhe **1.8 miliardë lekë** kosto e zgjedhjeve dhe **3 miliardë lekë** Kontigjencë për raste të paparashikuara.

Investimet Publike për vitin 2023 janë planifikuar në masën **5.6% e PBB** ose **122.24 miliardë lekë** (duke përfshirë këtu dhe fondin e rindërtimit në shumën 5 miliardë lekë). Në planifikimin e investimeve për vitin 2023 janë mbajtur në konsideratë të gjitha detyrimet kontraktuale për projektet e investimeve me financim të huaj dhe të brendshëm. Ashtu, si edhe në vitin 2022, dhe në vitin 2023 do të ketë përparësi financimi i projekteve në vazhdim. Për planifikimin e investimeve janë ndjekur kriteret e mëposhtme:

- *Prioritetet e Programit të Qeverisë për periudhën 2021 – 2025;*
- *Prioritetet e integrimit europian;*
- *Projektet në vazhdim.*

- *Mbështetja me kosto lokale dhe TVSH për projektet me financim të huaj;*

2.3 PARAMETRAT KRYESORË TË POLITIKËS FISKALE

Në vitet e fundit, deri përpara goditjes nga pandemia, financat publike kishin hyrë në një trajektore të sigurtë dhe optimale të konsolidimit fiskal, e materializuar në parametrat më kyç të qendrueshmërisë. Së pari, kjo u materializua në uljen e deficitit të përgjithshëm buxhetor nga 5% të PBB në 2013 në poshtë nivelit prej 2% deri në vitin 2019.

Ndërsa në vitin 2020, si kundër-përgjigje kryesore për amortizimin prej pandemisë, u ndërmor një politikë fiskale majft ekspansioniste. Rrjedhimisht, deficitin e përgjithshëm buxhetor arriti në vlerën rreth 6.7% të PBB-së dhe borxhi publik u rrit në rreth 74.5% të PBB-së, pra me rreth 9 pikë përqindje krahasuar me fundin e vitit 2019.

Për të kryer një politikë të tillë fiskale ekspansioniste në kundër-përgjigje të goditjes, qeverisë iu desh që të aktivizonte gjatë vitit 2020 “klauzolat e devijimit” nga rregullat fiskale, si klauzola të parashikuara që më parë në Ligjin Organik të Buxhetit (LOB), duke mos cënuar kështu kredibilitetin e financave publike në perceptimin e tregjeve dhe agjentëve ekonomikë. Gjithashtu, me synimin për të ruajtur sa më shumë të ishte e mundur të pacënuar kredibilitetin e financave publike në perceptimin e tregjeve, element kyç ky i financave publike si një fundament makroekonomik, sidomos për vende të vogla dhe me nevoja ri-financimi buxhetor relativisht të larta siç është Shqipëria, u ndërmor një tjetër iniciativë ligjore në Korrik të 2020 (në kulmin e pandemisë) duke përfshirë një rregull tjetër të ri fiskal në LOB, i cili sanksiononte ligjërisht që balanca primare e buxhetit të rikthehej në së paku në një nivel të balancuar (pra, jo më e vogël se sa zero) duke filluar nga viti 2024 e në vijim.¹

Ky rregull u mirëprit mjaft pozitivisht nga të gjitha institucionet ndërkombëtare (përfshirë patjetër edhe agjencitë e rating-ug) dhe rrjedhimisht nga aktorët ekonomik në tërësi, si një iniciativë mjaft e duhur dhe efektive për të ruajtur kredibilitetin dhe qendrueshmërinë e financave publike, jo vetëm në periudhën afatmesme dhe afatgjatë post-pandemisë, por madje vlerësohet se ishte mjaft ndihmuese për të siguruar një financim (huamarrje) relativisht mjaft normal edhe në afatin e shkurtër përgjatë goditjes, pra përgjatë vitit 2020 dhe në vijim, pavarësisht magnitudës mjaft më të lartë të huamarrjes se sa tipikisht.

Konsolidimi fiskal vijon të jetë objektivi themelor i politikës fiskale, në funksion të drejtpërdrejtë të sigurimit të stabilitetit makroekonomik të vendit, si një premisë thelbësore për sigurimin e një rritje ekonomike të qëndrueshme e gjithëpërfshirëse.

Politika fiskale do targetojë një trajektore rënëse të borxhit publik, pra një trajektore rënëse graduale por e përvitshme, ndërsa balanca primare do të rikthehet në nivel pozitiv që prej vitit të ardhshëm 2023 dhe do të vijojë e tillë në vijim, në përputhje edhe me rregullat fiskalë në LOB.

Në të njëjtën kohë, krahas konsolidimit fiskal, ne do synojmë që të ruajmë një raport të shëndetshëm të shpenzimeve buxhetore korrente dhe kapitale, ku shpenzimet kapitale (pra, investimet publike) do targetohen të jenë rreth 5 përqind e PBB në çdo vit buxhetor.

Defiçiti buxhetor për vitin 2023 planifikohet të jetë në nivelin 2.6 përqind të PBB nga rreth 3.3 përqind i pritshëm për vitin 2022. Balanca primare për këtë vit pritet të jetë pozitive në rreth 0.3 përqind, në një përmirësim të qenësishëm nga niveli negativ prej rreth -1.3 përqind që pritet për vitin 2022.

Balanca korrente fiskale (diferenca midis investime publike dhe deficit fiskal) do të jetë pozitive në vitin e ardhshëm 2023, në nivelin prej 2.7 përqind të PBB nga një nivel i pritshëm përsëri pozitiv prej 2.2 përqind këtë vit, në përputhje kjo me rregullin respektiv fiskal (“rregullin e artë” të buxhetit). Gjithashtu edhe borxhi publik bruto do vijojë trajektoren rënëse të nisur që në vitin 2021 pas pandemisë në përputhje me rregullin respektiv fiskal. Në vitin 2022 pritet që borxhi publik të bjerë në rreth 68.8 përqind të PBB

¹ Rregulli original sanksiononte “që prej 2023”, por më pas kjo u ndryshua sërish në Korrik të 2021 dhe u bë “që prej 2024”

nga rreth 73.2 përqind që ishte në vitin 2021 dhe pritet të vijojë të bjerë më tej në rreth 67.5% në vitin 2023. Balanca primare do të rikthehet në nivel pozitiv (suficit primar) që prej vitit 2023 e në vijim. Ndërkohë që, duke filluar prej vitit buxhetor 2024 e në vijim ky target do të jetë edhe ligjërisht i detyrueshëm, ku në LOB përcaktohet që duke filluar nga viti buxhetor 2024 e për çdo vit në vijim balanca primare të rezultojë jo më e vogël se sa zero (pra së paku e balancuar ose pozitive). Sipas skenarit bazë, borxhi publik pritet të bjerë në rreth 64.4 përqind në vitin 2026 dhe më tej në rreth 55 përqind në vitin 2031.

PARIMET DHE RREGULLAT FISKALE

Në përputhje të plotë me obligimet që rrjedhin prej ligjit organik të buxhetit (LOB) nr. 9936 datë 26.06.2008, i ndryshuar, në ligjin e buxhetit 2023, ku projeksionet shtrihen deri në vitin 2025, materializojnë parimet dhe rregullat fiskale të mëposhtme:

1. Në çdo ligj vjetor të buxhetit, fillestar apo të rishikuar, si dhe në planifikimet e buxhetit afatmesëm, raporti i borxhit publik ndaj Produktit të Brendshëm Bruto do të planifikohet më i ulët se niveli i vlerësuar për vitin pararendës, deri atëherë kur niveli i borxhit të arrijë dhe qëndrojë poshtë nivelit 45 përqind të Produktit të Brendshëm Bruto;

Në përputhje me këtë dispozitë (rregull fiskal) të LOB, ligji i buxhetit 2023 (-2025) **targeton çdo vit një nivel të borxhit publik total (bruto) në përqindje të PBB më të ulët se sa niveli i vitit pararendës.**

2. Vlera e Produktit të Brendshëm Bruto, nominale në lekë, e cila do të përdoret për llogaritjen e raportit të borxhit publik ndaj Produktit të Brendshëm Bruto për vitet buxhetore që planifikohen dhe për vitin pararendës, nuk mund të jetë më e lartë se vlera respektive e parashikuar ose vlerësuar në raportin “Perspektiva Ekonomike Botërore” (Eorld Economic Outlook), të Fondit Monetar Ndërkombëtar, më i fundit i publikuar në kohën kur ligji vjetor i buxhetit dorëzohet për miratim në Kuvend. Kjo dokumentohet qartësisht në relacionin shoqëruar të ligjit vjetor të buxhetit;

Në përputhje me këtë dispozitë (rregull fiskal) të LOB, ligji i buxhetit 2023 - (2025) **bazohet në projeksionet e mëposhtme të PBB nominale, të cilat paraqiten në mënyrë krahasimore kundrejt projeksioneve të FMN të raportit “Perspektiva Ekonomike Botërore” (Eorld Economic Outlook), të Tetorit 2022.**

Parashikimet e PBB nominale të MFE dhe FMN

(në miliardë lekë)

| | 2020 | 2021 | 2022 Para. | 2023 Para. | 2024 Para. | 2025 Para. |
|---|---------|---------|---------------|---------------|---------------|---------------|
| MFE | 1 644,1 | 1 889,8 | 2 058,2 | 2 176,1 | 2 285,9 | 2 401,9 |
| FMN | 1 644,1 | 1 889,8 | 2 059,0 | 2 177,0 | 2 287,0 | 2 403,0 |
| Diferenca MFE - FMN (Diferenca e vlerave të prashikuara duhet të jete jo më e madhe se zero) | 0,0 | 0,0 | -0,8 | -0,9 | -1,1 | -1,2 |

3. Në çdo vit buxhetor të planifikuar duhet të përfshihet një kontingjencë e veçantë, prej jo më pak se 0.7 për qind e shpenzimeve totale të buxhetit, për të kompensuar rreziqe potenciale nga luhatjet në kurset e këmbimit ose normat e interesit, me ndikim në nivelin e borxhit.

Në përputhje me këtë dispozitë (rregull fiskal) të LOB, ligji i buxhetit 2023 - (2025) përfshin për çdo vit në një zë të veçantë të tij, emërtuar “Kontingjencë për luhatjet e normave të interesit, etj.” një kontingjencë prej mbi 0.7 përqind e shpenzimeve totale.

4. Të ardhurat nga privatizimi nuk janë pjesë e procesit të programimit buxhetor. Në rastet e arkëtimit ato përdoren, jo më pak se 50 përqind, për uljen e borxhit publik dhe pjesa tjetër për investime publike. Pas arritjes së nivelit të borxhit publik, sipas përcaktimeve të shkronjës “a”, të pikës 1, të nenit 4/1 të Ligjit Organik të Buxhetit nr 57/2016, përdorimi i të ardhurave të arkëtuara nga privatizimet përcaktohet në ligjin vjetor të buxhetit.

Në përputhje me këtë dispozitë (rregull fiskal) të LOB, ligji i buxhetit 2023 - (2025) **nuk përfshin të hyra nga privatizimet e mundshme.**

5. Masa e deficitit buxhetor nuk mund të tejkalojë masën e shpenzimeve kapitale të parashikuara çdo vit në ligjin e buxhetit.

Në përputhje me këtë dispozitë (rregull fiskal – “rregulli i artë”) të LOB, deficitin i targetuar në ligjin e buxhetit 2023- (2025) **është çdo vit më i ulët se sa shpenzimet kapitale të planifikuara.** Rrjedhimisht, balanca korrente e targetuar është pozitive në çdo vit.

6. Duke filluar që prej vitit buxhetor 2024 e në vijim, balanca primare buxhetore nuk duhet të rezultojë më e vogël sesa zero, përveçse në rastet e rrethanave të jashtëzakonshme që parashikohen në nenin 4/4, të këtij ligji.

Në përputhje me këtë dispozitë (rregull të ri fiskal) të LOB, balanca primare duke filluar që prej vitit buxhetor 2024 e në vijim balanca primare e buxhetit është targetuar (dhe do duhet të rezultojë) së paku neutrale ose pozitive (suficit primar).

3. MENAXHIMI I BORXHIT PUBLIK

Borxhi i Qeverisjes Qendrore gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2022 përgjithësisht është menaxhuar në përputhje me objektivat strategjikë afatmesëm për ruajtjen e qëndrueshmërisë së raporteve ndërmjet kostos dhe risqeve.

Për sa i përket huamarrjes, gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit vitit 2022, huamarrja total në terma bruto u realizua në vlerën 218.0 miliardë lekë, nga të cilat 90.7% (*ose 197.7 miliardë lekë*) u financuan nëpërmjet burimeve të brendshme dhe 9.3% (*ose 20.3 miliardë lekë*) nëpërmjet burimeve të huaja. Në tregun e brendshëm financimi neto rezultoi në vlerën -2.8 miliardë lekë. Rënia e huamarrjes së brendshme neto ka reflektuar hezitimin e bankave për të investuar në obligacione shtetërore, kryesisht në ato afatgjata, për shkak të pasigurisë së ardhshme dhe pritshmërive për rritje të normave të interesit, bazuar në zhvillimet e fundit në tregjet financiare, ndikuar nga pasojat e konfliktit Rusi-Ukrainë. Gjithashtu dhe huamarrja e huaj, krahasuar me vitin e kaluar, u ul me 7.7 miliardë lekë, kryesisht për shkak se këtë vit niveli i mbështetjes buxhetore ishte më i ulët se vitin e kaluar dhe gjithashtu vlera e kredive të disbursuara për financimin e projekteve ishte më e ulët se në të njëjtën periudhë të vitit 2021.

Për sa i përket raporteve të kostos dhe riskut në portofolin e borxhit, strategjia afatmesme e menaxhimit të borxhit synon të përmirësojë më tej strukturën e borxhit (kryesisht strukturën e portofolit të borxhit të brendshëm), në drejtim të uljes së ekspozimit ndaj risqeve, si dhe mbajtjes nën kontroll të kostove. Pavarësisht se gjashtëmujori i parë i vitit 2022 ka qenë sfidues për sa i përket plotësimin të huamarrjes për shkak të pasigurive në treg dhe rritjes së normave të interesit, nga pikpamja e kompozimit, portofoli i borxhit të brendshëm ka vijuar të shfaqë përmirësim të treguesve kryesorë të riskut, ndërkohë që nga pikpamja e kostos, deri në fund të gjashtëmujorit të parë nuk ka patur ende një impakt të ndjeshëm në treguesit e kostos. Krahasuar me gjashtëmujorin e parë të vitit 2021, shpenzimet për interesa vlerësohen rreth 0.8 miliardë lekë më të larta, kryesisht si rezultat i rritjes së stokut të borxhit në vlerë nominale si edhe efektit të rritjes së normave të interesit të instrumenteve qeveritare, po ku impakt më i dukshëm i këtyre të fundit priten në vijim.

Në vazhdim të angazhimit të ndërmarrë në lidhje me përmirësimin e mëtejshëm të tregut primar dhe zhvillimin e tregut sekondar të titujve shtetërorë, përgjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2022 është vijuar me praktikat që kontribuojnë në krijimin e madhësive referencë dhe konsolidimin e kurbës së *yield-it* në segmentin e titujve shtetërorë afatmesëm dhe afatgjatë.

Yield-et e letrave me vlerë të qeverisë kanë ndjekur një tendencë rritëse duke filluar nga muaji Mars 2022, rritje kjo e ndikuar nga rritja e normës bazë të interesit në tregun vendas si edhe nga pritshmëritë për rritje të mëtejshme të normave të interesit në përgjigje të inflacionit të rritur. Banka e Shqipërisë ka rritur 4 herë normën bazë të interesit gjatë vitit 2022 duke prekur nivelin prej 2.25%, krahasuar me 0.5% në fund të vitit 2021.

Gjatë pjesës së mbetur të vitit 2022 dhe gjatë vitit 2023, menaxhimi i borxhit do të ketë në fokus plotësimin e nevojave për huamarrje, duke mbajtur në konsideratë përmirësimin e mëtejshëm të strukturës së borxhit (*kryesisht strukturën e portofolit të borxhit të brendshëm*) në drejtim të uljes së ekspozimit ndaj risqeve. Gjithashtu, në tregun e brendshëm do të merren masa për të inkurajuar pjesëmarrjen e

investitorëve në letrat me vlerë qeveritare. Në tregun e brendshëm, nëpërmjet titujve afatshkurtër kryesisht do të synohet refinancimi i titujve ekzistues, si dhe menaxhimi i nevojave për likuiditet. Ndërkohë, nëpërmjet titujve afatgjatë do të synohet të realizohet huamarrja e re e planifikuar.

Në tregun e huaj, burimet kryesore të huamarrjes do të jenë huatë me terma të buta ose pjesërisht të buta, cilat do të financojnë projektet ekzistuese dhe projektet e reja të konsideruara si prioritare nga qeveria, si edhe huatë në formën e mbështetjes buxhetore të akorduara nga institucionet financiare ndërkombëtare për të mbështetur qeverinë për pandeminë COVID-19 dhe për reformat e politikave zhvillimore të vendit. Gjithashtu Ministria e Financave dhe Ekonomisë, synon daljen gjatë vitit 2023 në tregjet ndërkombëtare financiare nëpërmjet emetimit të instrumentit të Eurobondit, në rast se kushtet e tregut do të jenë të favorshme.

4. POLITIKAT SEKTORIALE DHE PËRFITIMET PËR QYTETARIN

BUJQËSIA DHE ZHVILLIMIT RURAL

• Prioritetet 2023-2025

Prioritetet e sektorit të bujqësisë, për periudhën afatmesme 2023-2025, janë si më poshtë:

- Garantimi i sigurisë ushqimore, shëndetit dhe mirëqenies së kafshëve, dhe shëndetit të bimëve përmes adoptimit të standardeve përkatëse të BE-së në kuadrin normativ vendas;
- Konsolidimi i pronësisë mbi tokën bujqësore, administrimi i qëndrueshëm, ruajtja e saj nga dëmtimi, gërryerja, shpërdorimi dhe faktorë të tjerë;
- Nxitja e tregut të tokës dhe konsolidimi i fermës bujqësore duke rritur sipërfaqen dhe nxitur kooperimin;
- Mbështetje për agroindustrinë;
- Mbështetje për tregjet dhe marketingun e produkteve bujqësore dhe blegtorale;
- Administrimi i sistemit të ujitjes nëpërmjet kujdesit, sigurimit dhe administrimit të qëndrueshëm të sistemit të ujitjes dhe shmangia e përmytjeve;
- Mbështetje financiare dhe asistencë teknike për fermerët.
- Zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit të peshkimit dhe akuakulturës, shfrytëzimin e përgjegjshëm të burimeve peshkore dhe kapaciteteve të flotës së peshkimit si dhe ngritjen e një sistemi kontrolli dhe inspektimi për peshkimin në det, në tokë dhe në të gjithë zinxhirin e tregut.

• Rezultatet që synohet të arrihen për periudhën afatmesme 2023-2025

Në fushën e “Infrastrukturës së Ujitjes dhe Kullimit”, synohet të realizohet:

- Rritja e % së fermerëve që përfitojnë nga përmirësimi i infrastrukturës ujitëse dhe kulluese ndaj totalit të fermerëve në sipërfaqen potencialisht të ujitshme nga 72.2% në vitin 2022, në 75% në vitin 2025;
- Përqindja e sipërfaqes ujitëse ku fermerët kanë akses për ujë për ujitje, kundrejt sipërfaqes potencialisht të ujitshme (360 000 ha) nga 72.2% në vitin 2022, në 75% në vitin 2025;

- Përqindja e hidrovoreve të rehabilituara/ndërtuara/rikonstruktura, kundrejt totalit të nevojshëm (14 hidrovorë) nga 57% në vitin 2022, në 64% në vitin 2023, në 68% në vitin 2024 dhe në 72% në vitin 2025;
- 35 000 hektarë sipërfaqe ujtitëse me infrastrukturë kryesore të përmirësuar/mirëmbajtur (si proces ciklik vjetor ne ha);
- Vepra të mbrojtjes nga përmbytja të rehabilituara/ndërtuara (argjinatura gjatësore dhe penele tërthorë), kundrejt totalit të nevojshëm (300 km) nga 35% në 39% në vitin 2025.

Në fushën e *Zhvillimi Rural duke mbështetur Prodhimin Bujqësor, Blegtoral, Agroindustrial dhe Marketingun* ””, synohet të realizohet:

- Zhvillimi i sektorit të bujqësisë dhe atij rural në Shqipëri, për të përmirësuar performancën e tyre ekonomike dhe kushtet e jetesës në zonat rurale, për t'i përgatitur këta sektorë për anëtarësimin e ardhshëm në BE, duke rritur:
 - ✓ Numrin e të punësuarëve në bujqësi dhe agropërpunim (nga 549.470 të punësuar të parashikuar në vitin 2023 në 565.954 të punësuar në vitin 2043).
 - ✓ Aktivitetet promovuese të produkteve shqiptare në bujqësi, blegtori dhe agropërpunim.
 - ✓ Rritja e volumit të eksportit të produkteve bujqësore dhe të agropërpunimit nga 47.4 miliardë lekë në vitin 2023 në 50.7 miliardë lekë në vitin 2024.
- Përmirësimi i konkurrueshmërisë së bujqësisë dhe industrisë agro-ushqimore si dhe përmirësimi i cilësisë së jetës përmes nxitjes së shumëllojshmërisë së veprimtarive ekonomike në zonat rurale, nëpërmjet:
 - ✓ Shtimit të numrit të përfituesëve nga Skemat Kombëtare në bujqësi nga 4800 përfitues në vitin 2022, 5000 përfitues në vitin 2023, 5500 përfitues në vitin 2024 dhe 6000 përfitues në vitin 2025, dhe mbështetjes së 260 përfituesëve nga Programi IPARD II për 2023. Si dhe rritja e numrit të përfituesëve nga Skema e Subvencionit të naftës për bujqësinë nga 17.500 përfitues në vitin 2022 në 18.500 përfitues në vitin 2025.
 - ✓ Rritjes së numrit të çertifikimeve dhe testeve të farave dhe fidanëve që hidhen në treg, për të siguruar inpute cilësore për bujqësinë në tregun shqiptar.

Në fushën e *“Siguria Ushqimore dhe Mbrojtja e Konsumatorit”* synohet fuqizimi i sistemit të kontrollit dhe inspektimit, duke përfshirë të gjithë zinxhirin ushqimor nga ferma në tavolinë nëpërmjet:

- ✓ Kontrolleve dhe monitorimeve të sëmundjeve infektive dhe zoonotike në kafshët e gjalla duke ulur në këtë mënyrë numrin e kafshëve të prekura nga Brucelozja, nga plasja dhe nga tuberkulozi.
- ✓ Do të vijojë zbatimi i politikave të shëndetit dhe mirëqenies së kafshëve të gjalla, si dhe programet e parandalimit, kontrollit, eliminimit deri në çrrënjosjen e sëmundjeve infektive në kafshë, sipas përcaktimeve të legjislacionit veterinar, nëpërmjet:
 - ✓ Vaksinimit të rreth 930 mijë kafshëve në vitin 2022 dhe 927 mijë në vitin 2024.
 - ✓ Kryerjes së rreth 310 mijë gjurmimeve dhe kontrolleve tek kafshët përgjatë viteve 2022-2023, dhe kryerjes përkatësisht 315 mijë dhe 317 mijë testeve në vitet 2024-2025.
- Rritja e numrit të çertifikatave të unifikuara për eksport nga 40 në vitin 2022 në 65 në vitin 2025.
- Rritjes së numrit të operatorëve që aplikojnë standardet HACCP në sigurinë ushqimore nga 1200 në vitin 2022 në 1400 në vitin 2025.

- Uljes së numrit të sëmundshmërisë së njerëzve nga kafshët si pasojë e realizimit në kohë e vaksinimit të kafshëve nga 60 në vitin 2022 në 50 në vitin 2025.
- Uljes së numrit të jokonformiteteve të konstatuara nga 6600 në vitin 2022 në 6400 në vitin 2025.
- Uljes së numrit të kafshëve të prekura nga Bruceloza, plasja, turbekulozi dhe LSD.
- Rritjes së numrit dhe cilësisë së inspektimeve; uljes së numrit të gjobave të vendosura nga inspektimet në terren (nga 550 në vitet 2022-2023 dhe në 400 në vitet 2024-2025), uljes së numrit të bizneseve të mbyllura për mosplotësimin e kushteve të sigurisë ushqimore (nga 280 në vitin 2022, në 200 në vitin 2025), uljes së numrit të rasteve të produkteve ushqimore të të asgjësuar (nga 60 në vitin 2022, në 50 në vitin 2025) si pasojë e politikave të ndërmarra nga MBZHR.

ZHVILLIMI EKONOMIK

Gjatë periudhës 2023-2025 prioritetet në fushën e mbështetjes së zhvillimit ekonomik do të jenë:

- Promovimi i Shqipërisë si destinacion investimesh nëpërmjet organizimit dhe pjesëmarrjeve në panairë ndërkombëtare dhe road shoë promovuese, vizita në kompani (after care), në kuadër të zbatimit të aktiviteteve për krijimin e zonës ekonomike rajonale / MAP REA si dhe monitorim efektiv investimesh strategjike;
- Ndërmarrja me sukses e aktiviteteve promovuese për nxitjen e investimeve të huaja dhe të produkteve “*Made in Albania*”;
- Rritja e përpjekjeve për të reduktuar informalitetin e mikrondërmarrjeve, ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, si pengesë kyçe në aksesin e financimeve të SME-ve, nëpërmjet:
- ✓ Rritjes së konkurrueshmërisë së bizneseve shqiptare në tregun ndërkombëtar nëpërmjet granteve nga Fondi i Konkurrueshmërisë (60 biznese të mbështetura financiarisht në 2022-2025);
- ✓ Avancimit të mëtejshëm në fushën e teknologjisë dhe inovacionit nëpërmjet granteve që i akordohen bizneseve të specializuara në këtë fushë nga Fondi i Inovacionit (75 biznese të mbështetura financiarisht në 2022-2025);
- ✓ Nxitjes së krijimit të bizneseve të reja në sektorë me potencial zhvillimi nëpërmjet Fondit Start-Up (60 biznese të mbështetura financiarisht në 2022-2025);
- ✓ Mbështetjes së sipërmarrjeve të sektorit të artizanatit dhe zejtarisë me qëllim konsolidimin e tyre në treg dhe rritjen e numrit të të punësuarëve nëpërmjet “Fondit në mbështetje të biznesit kreativ”, ku në total parashikohet të përfitojnë 85 SME vendase me qëllim rritjen e konkurrueshmërisë për periudhën 2022-2025.
- ✓ Sigurimi i implementimit efektiv të masave të “gjelbëra” të planifikuara për SME-të nëpërmjet ridizenjimit të skemave mbështetëse.
- ✓ Nxitja e bashkëpunimit midis institucioneve arsimore dhe bizneseve, përmes aksesit të lehtë të informacionit
- ✓ Zhvillimi i një qasje holistike në mbështetje të SME-ve në integrimin e zinxhirit të vlerave globale përmes pjesëmarrjes së Shqipërisë në rrjetin e Enterprise Europe Netëork, Shtylla e Programit COSME.
- ✓ Mbështetje për sipërmarrjet në sektorin e turizmit me 50 milionë euro në formën e instrumentit të garancisë sovrane.

INFRASTRUKTURA DHE ENERGJIA

- **Prioritetet 2023-2025**

- ✓ Zgjerimi i rrjetit të rrugëve kombëtare nëpërmjet, ndërtimit, rehabilitimit dhe sistemimit të rrugëve kombëtare dhe përveç kësaj kalimin në praktikat e mirëmbajtjes së rrugëve bazuar në performancë;
- ✓ Bazuar në objektivin e përgjithshëm të Strategjive Sektoriale, ky institucion synon: (i) të zhvillojë më tej sistemin kombëtar të transportit, (ii) të përmirësojë ndjeshëm qëndrueshmërinë, ndërlidhjen, ndërveprimin dhe integrimin e tij më gjerë, me sistemin ndërkombëtar dhe evropian të transportit dhe rajonin;
- ✓ Zgjerimi i aksesit dhe cilësisë së shërbimit të ujit të pijshëm dhe kanalizimeve përmes: (i) një portofoli të investimeve publike; dhe (ii) përmirësimit rrënjësor të menaxhimit të shoqërive aksionere të ujësjellës kanalizimeve, duke standartizuar parimet e qeverisjes së sektorit;
- ✓ Rritja e efikasitetit të energjisë kundrejt konsumit të përgjithshëm final të energjisë nëpërmjet shqyrtimit të programeve për promovimin e tregut, për penetrimin e teknologjive të përparuara si dhe rritjen e përdorimit të energjive të rinovueshme;
- ✓ Trajtimi i mbetjeve në mënyrë të kontrolluar sanitare, nëpërmjet vazhdimin të ndërtimit të impianteve të reja të trajtimit të mbetjeve të ngurta dhe rehabilitimit të venddepozitimeve ekzistuese.

❖ **Rezultatet që synohet të arrihen për periudhën afatmesme 2023-2025**

Programi “Transporti Rrugor”

- Për tre vitet e ardhshme, kontratat koncesionare që do të mbështeten me fonde nga buxheti i shtetit janë:
 - Kontrata e Koncesionit për “Ndërtimin e Rrugës së Arbrit”;
 - Kontrata e Koncesionit për “Ndërtimin e Rrugës Milot – Morinë”;
 - Kontrata e Koncesionit për “Ndërtimin e Rrugës Orikum – Dukat, By Pass – Porti i Jahteve”;
 - Kontrata e Koncesionit për “Ndërtimin e Rrugës Milot – Balldren”;
- Projektet kryesore për periudhën afatmesme janë sa vijon:
 - Ndërtim Tuneli i Llogarasë;
 - Bypass i Elbasanit;
 - Segmenti i Unazës së Jashtme të Tiranës;
 - Ndërtim By Pass perëndimor Shkodër;
 - Zgjerim i segmentit dalje Elbasan – Përrenjas – Qafë Thanë;
- Rritja e sigurisë rrugore në të gjitha akset kombëtare ku synohet ulja e numrit të aksidenteve me pasojë humbje jetë njerëzish dhe numri i pikave të zeza me 25%, sipas Strategjisë Kombëtare të Transportit.
- 3483 km rrugë të mirëmbajtura sipas standardeve në vitin 2025 në të gjithë territorin;

Programi “Ujësjellës Kanalizime”

- Reduktimi i humbjeve në nivel kombëtar në masën 50% në vitin 2025;
- Furnizimi me ujë dhe shërbime i zonës bregdetare 24 orë në vitin 2025.
- Mesatarja e orëve të furnizimit me ujë të pijshëm në rang kombëtar rritet në 14 orë në ditë në 2025, nga 12.5 orë në ditë në vitin 2022;

- Mbulimi me shërbim furnizimi me ujë të pijshëm zonë Urbane 95% në vitin 2025 nga 94% në vitin 2022;
- Mbulimi me shërbim furnizimi me ujë të pijshëm zonë Rurale 62% në vitin 2025 nga 59% në vitin 2022;
- Mbulimi me kanalizime zonë Urbane 81% në vitin 2025 nga 80% në vitin 2022;
- Mbulimi me kanalizime zonë Rurale 22% në vitin 2025 nga 16% në vitin 2022;
- Orët mesatare të furnizimit me ujë të pijshëm synohet në 16 orë/ditë në vitin 2025 nga 13 orë/ditë në vitin 2022;
- Sasia e ujit të faturuar synohet të arrihet në 122 litër/ frymë/ditë në vitin 2025 nga 115 litër/ frymë/ditë në vitin 2022;
- Orët e furnizimit me ujë në zonat bregdetare synohet të arrihet në 24 orë/ditë në vitin 2025 nga 13 orë/ditë në vitin 2022;
- Reduktimi i humbjeve në rrjet në nivel kombëtar synohet të arrihet në 50% në vitin 2025 nga 62% në vitin 2022;
- Mbulimi me shërbimin e ITUN (kanalizime+gropa septike) synohet të arrihet në nivelin 17% në vitin 2025 nga 12% në vitin 2022;
- Përqindja e mbulimit të kostove të Ujësjellës-Kanalizimeve me të ardhurat synohet të arrihet në vlerën 90% në vitin 2025 nga 75% në vitin 2022;

Programi “Mbështetje për Energjinë”

- Zhvillim i qëndrueshëm i ekonomisë nëpërmjet garantimit dhe furnizimit me burime të sigurta energjetike me kosto minimale;
- Diversifikimi i furnizimit me burime energjetike dhe integrimi në rrjetet energjetike rajonale dhe Europiane, duke nxitur investimet dhe përmirësuar arkëtimet dhe likuiditetet;
- Në vitin 2023 do të rritet përdorimi i energjisë së rinovueshme me 38% kundrejt vitit 2022;
- Në vitin 2023 do të rritet efienca e energjisë me 6.5% referuar vitit 2021.

Programi “Menaxhimi i Mbetjeve Urbane”

- Në vitin 2025, synohet që të trajtohen rreth 53% të mbetjeve me landfill-e sipas standardeve, nga 35% që parashikohet në fund të vitit 2022;
- Norma e ndotjes së ajrit synohet të arrihet në 39 µg/m³ në 2025 nga 41 µg/m³ që pritet të arrihet në fund të 2022;
- Norma e mbetjeve të rikuperuara kundrejt sasisë totale të mbetjeve të prodhuara synohet të arrihet në 30% në 2025 nga 3% që synohet në fund të 2021;

Programi “Planifikimi Urban”

- Do të mbështeten projektet me fokus lokal, rajonal dhe në rang vendi, si dhe hartimin e rregullave teknike në projektim duke i harmonizuar këto plane me PPK, PINS Durana dhe PINS Tiranë Durrës, për një zhvillimit të barabartë të territorit.
- Projektet e Përmirësimit të Infrastrukturës Publike “100 Fshatrat”;

Programi “Transporti Ajror”

- Rritja e standarteve dhe performancës së Organit Kombëtar të incidenteve/Aksidenteve ajrore nëpërmjet investimeve për forcimin e kapaciteteve, në kuadër edhe të ndërtimit të infrastrukturave të reja aeroportuale;

- Numri i investigimeve të kryera në vitin 2025 të arrijë në 6 nga 5 investigime që pritet të kryhen në 2022;
- Zbatimi i standarteve të njehësura të sigurisë dhe parrezikshmërisë në transportin ajror.

Programi “Transporti Detar”

- Kryerja e investimeve prioritare për funksionimin me kapacitet të plotë të porteve dhe përmirësimin e infrastrukturës portuale në vend, me qëllim shndërrimin e Shqipërisë në një vend të zhvilluar detar që mbështet rritjen ekonomike dhe shpejton procesin e integritimit në BE;
- Rritja e volumit të përpunimit të mallrave në porte në masën 40% në vitin 2025 nga 20% që është aktualisht në 2022.
- Ndërtimi i Portit të ri të Durrësit;
- Ndërtimi dhe mirëmbajtja e Portit të Integruar të Triportit Vlorë (kontratë PPP)

Programi “Transporti Hekurudhor”

- Rikonstruksioni i segmentit hekurudhor Tiranë – Durrës si dhe ndërtimi i linjës së re hekurudhore Tiranë-Rinas;
- Mirëmbajtja e infrastrukturës hekurudhore ekzistuese si dhe mirëmbajtja e mjeteve-hekurudhore; Studime fizibiliteti dhe projekte zbatimi për segmente të reja dhe ekzistuese hekurudhore;
- Rinovim i trungut hekurudhor Gjormë – Hani Hotit 120.2 km;

Programi “Mbështetje për Burimet Natyrore”

- Nxitja dhe inkurajimi i ndërtimit të objekteve të përpunimit të mineraleve;
- Zhvillimi i qëndrueshëm i sektorit minerar dhe rritja e transparencës në shfrytëzimin racional të burimeve natyrore;
- Rritja e lejeve minerare aktive në të cilat zhvillohet aktivitet minerar konform standarteve;
- Realizimi në vazhdimësi i funksioneve të mbikëqyrjes së shfrytëzimit racional e efektiv të pasurive minerale, monitorimit minerar dhe të fenomeneve të postshfrytëzimit, rritja e kontrollit për rehabilitimin minerar;
- Përmirësimi i transparencës së biznesit në industrinë nxjerrëse, në mënyrë që të ardhurat nga ky biznes të kontribuojnë më shumë në zhvillimin e vendit.

Programi “Mbështetje për Industrinë”

- Zhvillimi i strukturave dhe burimeve njerëzore dhe forcimi i kapaciteteve institucionale për inspekimin dhe mbikëqyrjen, sigurinë në punë për monitorimin e inspektimit dhe mbikëqyrjes së sigurisë teknike të produkteve / pajisjeve / instalimeve në fushat e veprimtarisë së MIE;
- Rritja e standardeve të produkteve dhe sigurisë së pajisjeve / instalimeve me 7% deri në vitin 2025;
- Nxitja e interesit të biznesit vendas dhe të huaj për mundësi zhvillimi veprimtarish industrial;
- Reduktimi i rrezikut nga kimikatet e rrezikshme me 13% deri në vitin 2025;
- Zhvillimi i strukturave dhe burimeve njerëzore dhe forcimi i kapaciteteve institucionale për sigurimin e kushteve të domosdoshme për inspektimin dhe mbikëqyrjen e shëndetit, sigurisë në punë, emergjencat dhe shpëtimin në veprimtarinë minerare dhe në punimet nëntokësore të veprave hidroenergjetike;

- Rritja dhe përmirësimi i standarteve, kushteve të punës dhe të sigurisë së depozitimit dhe ruajtjes së kimikateve të rrezikshme nën përgjegjësinë e MIE-s, në Qendrën e Grumbullimit dhe Trajtimin të Kimikateve të Rrezikshme;
- Përfundimi i procesit të likuidimit dhe mbylljes së ish ndërmarrjeve industriale në varësi të MIE-s. Rehabilitimi i territoreve të ish ndërmarrjeve për nxitjen e investitorëve dhe promovimin e tyre për përdorim si parqe industriale;
- Rritja e numrit të mostrave të analizuara të naftës dhe nënprodukteve të saj, të prodhuara në vend dhe të importuara në masën deri në 9200 në vitin 2025;
- Promovimi tek biznesi i studimeve tekniko-ekonomike për industrinë e Lëkurë-Këpucës, industrisë së bakrit, nikel-silikateve dhe kuarciteve, zhvillimit të QGTK dhe hartimi i raporteve mjedisore si dhe zhvillimi i disa ish territoreve industriale për ushtrimin e veprimtarive ekonomike.

SHËNDETËSI

- **Prioritetet 2023-2025**

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në sektorin e shëndetësisë do të prioritetizojë:

- ✓ Financimi i shërbimeve shëndetësore (parësore e spitalore);
 - ✓ Qëndrueshmëria dhe përmirësimi i situatës financiare institucioneve shëndetësore e të mbrojtjes sociale, nëpërmjet përdorimit me efektivitet të burimeve të financimit, forcimit të kontrollit të shpenzimeve;
 - ✓ Rritja e kosto-efektivitetit të listës së barnave e pajisjeve të rimbursueshme;
 - ✓ Financimi i paketave të miratuara të shërbimit spitalor në spitalet publike e jopublike;
 - ✓ Pagesat për kujdes shëndetësor, sipas marrëveshjeve ndërkombëtare të nënshkruara;
 - ✓ Intensifikimi i punës për kostimin e shërbimeve të reja shëndetësore, në kujdesin shëndetësor, me synim ndryshimin e mënyrës së financimit të shërbimeve shëndetësore;
 - ✓ Financimi i shërbimit të kontrollit bazë mjekësor bazë për të paktën 50% të numrit të shtetasve të moshës 35-70 vjeç;
- **Rezultatet që synohet të arrihen për periudhën afatmesme 2023-2025**
 - Mbulimi universal i popullsisë me shërbim shëndetësor duke parashikuar 6.4 milionë numër vizitash në periudhën 2023-2025, mbështetur në treguesit e sëmundshmërisë.
 - Ofrimi i shërbimit të kontrollit bazë (check-up) për mesatarisht 475 mijë pacientë në vit;
 - Trajtimi me recetë rimbursimi mesatarisht 400 mijë pacientëve në vit, përgjatë periudhës 2023-2025;
 - Numri i pacientëve të trajtuar mesatarisht 330 mijë pacientë në vit për periudhën 2023-2025;
 - Rritja e numrit të pacientëve që përfitojnë nga paketat e kardiokirurgjisë dhe kardiologjisë mesatarisht 8 600 pacientë përgjatë periudhës 2023-2025;
 - Numri i pacientëve përfitues nga shërbimi i dializës për vitin 2023 parashikohet rreth 1,570 pacientë, e çdo vit shtohen mesatarisht rreth 150 pacientë. Mesatarisht çdo pacient kryen 13 seanca në muaj. Për periudhën 2023-2025 parashikohet rritje e ndjeshme e numrit seancave për pacientët që përfitojnë nga trajtimi me dializë nga 245 mijë seanca në vitin 2023, në 270 mijë në vitin 2025;

- Trajtimi i mesatarisht 25 fëmijëve në vit më Sindromën Doën përgjatë periudhës 2023-2025;
- Reduktimit të kohës aktuale prej 13 ditësh të pritjes për ekzaminime të rëndësishme (rezonancë magnetike, skaner etj.);
- Depistimi për kancerin e gjirit mesatarisht 5 mijë gra me anë të mamografisë së lëvishme, respektivisht për vitet 2023-2025;
- Depistimi për kancerin e qafës së mitrës mesatarisht 18 mijë gra përgjatë 2023-2025 me synim uljen e vdekshmërisë nga kanceri i qafës së mitrës nga 2.6/100 000 në vitin 2022 në 2.4/100 000 në vitin 2025.
- Rritja e numrit të thirrjeve të adresuara në njësitë e Urgjencës mjekësore nga 550 mijë thirrje në vitin 2022 në 650 mijë thirrje në vitin 2025, me një kohë reagimi mesatarisht prej 16 minutash.

MBROJTA SOCIALE

• **Prioritetet 2023-2025**

Në fushën e mbrojtjes sociale, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale synon zbatimin me sukses të reformës së programit të përkujdesit social në tre shtyllat kryesore të tij: Ndhimja Ekonomike, Aftësia e Kufizuar dhe Shërbimet Sociale. Më konkretisht synohet:

- Numri i familjeve dhe individëve në nevojë që pritet të përfitojnë nga skema e ndihmës ekonomike parashikohet të jetë mesatarisht 63.5 mijë përfitues në vit përgjatë periudhës 2023-2025;
- Numri i përfituesve nga PAK dhe kujdestarëve të tyre parashikohet të shkojë në 158 mijë në vitin 2025, në kuadër të reformimit të sistemit të vlerësimit të aftësisë së kufizuar;
- Mbështetja e personave nga grupet e pafavorizuara përmes punësimit në ndërmarrjet sociale synohet të punësohen mesatarisht 70 persona çdo vit, me qëllim integrimin në tregun e punës.
- Mbështetjen e fondit social për njësitë e vetqeverisjes vendore për ofrimin e shërbimeve të reja sociale territoriale për grupet në nevojë dhe mbështetjen e familjeve të NE me paketa sociale shëndetësore, me një fond nga 200 milion lekë në 300 milion lekë për vitet 2023-2025.
- Për vitet 2023-2025, vijon të financohet politika e rishikimit të masës së përfitimit të ndihmës ekonomike, në të cilën parashikohet një rritje me 10 % (dhjetë për qind) të masës së pagesës ekzistuese, sipas strukturës së familjes.
- Përgjatë viteve 2023-2025, si pjesë e grupeve në nevojë do të trajtohen me ndihmë ekonomike dhe kategoritë si më poshtë:
 - ✓ Gratë kryefamiljare përfitues në programin e ndihmës ekonomike, që kanë në përbërje të familjes deri në dy fëmijë të moshës 0-18 vjeç, përfitojnë dyfishin e masës së pagesës ekzistuese të ndihmës ekonomike, sipas strukturës së familjes.
 - ✓ Përfituesit e programit të ndihmës ekonomike, që kanë mbushur moshën 65 vjeç, të vetmuar dhe nuk trajtohen me pension pleqërie apo pension social, përfitojnë dyfishin e masës së pagesës ekzistuese të ndihmës ekonomike.
 - ✓ Anëtarët e familjeve përfituese të programit të ndihmës ekonomike që kanë mbushur 65 vjeç dhe nuk trajtohen me pension pleqërie apo pension social, përfitojnë dyfishin e masës së pagesës ekzistuese të ndihmës ekonomike, sipas strukturës së familjes.
 - ✓ Masa e ndihmës ekonomike parashikohet të rritet me 10% më shumë krahasur me masën ekzistuese për familjet që trajtohen me ndihmë ekonomike, dhe nuk janë pjesë e ndonjë kategorie tjetër përfituese.

Implementimi i reformës do të sjellë:

- Rritjen mbi 94% të numrit të përfituesve të varfër që marrin NE mbi totalin e aplikuesve.
- Rritjen mbi 70% të numrit të personave me aftësi të kufizuar që janë komisionuar përmes sistemit të menaxhimit të informacionit;
- Rritjen mbi 90% të numrit të përfituesve të grave kryefamiljare që marrin Ndihmë Ekonomike mbi totalin e aplikuesve gra kryefamiljare;
- Rritja me më shumë se 60 e numrit të grave dhe vajzave në nevojë të riintegruara pas trajtimit në institucionet e përkujdesit social.

SIGURIMI SHOQËROR

Në fushën e Sigurimeve Shoqërore, për periudhën 2022-2025 synohet:

- Garantimi i mbulimit sa më të plotë të popullsisë së vendit me elementë të sigurimeve shoqërore të detyrueshme, të mbajtura në nivele të pranueshme.
- Vazhdimi i implementimi i reformës së pensioneve dhe përmirësimi i efikasitetit të ISSH në menaxhimin e fondeve të sigurimeve shoqërore të detyrueshme, suplementare dhe programore.
- Përsosjes së menaxhimit të skemës së sigurimeve shoqërore, sidomos të mbledhjes së të ardhurave kontributive si dhe shpërndarjes së drejtë të tyre në formën e përfitimeve, aty dhe atëherë kur lind e drejta.
- Vendosja e personave të siguruar dhe e përmirësimit të shërbimit ndaj tyre, në qendër të veprimtarisë së tij. Thellimi i procesit të modernizimit dhe lehtësimit të dhenjes së shërbimeve Në këtë kontekst, plotësimi i kërkesave të aplikanteve jo më vonë 30 -35 ditë nga data e aplikimit.
- Mbështetje aktive për shqiptarët që jetojnë dhe studiojnë jashtë vendit, duke i dhënë prioritet vendeve ku ka më shumë prezencë shqiptarësh.

❖ Rezultatet e synuara për t'u arritur në periudhën 2022-2025:

- Rritja e nivelit të përfitimeve të pensionistëve sipas rritjes së indeksit të çmimeve të mallrave të konsumit dhe të shërbimeve, të përcaktuar në shportën e pensionistëve. Fondet kontigjencë sipas viteve janë; Viti 2023-3,580 milionë leke; Viti 2024-3,650 milionë leke; Viti 2025-3,750 milionë leke.
- Mbulimi i efekteve financiare të shtesës natyrale të numrit të përfituesve e cila në harkun e tre viteve parashikohet të jetë rreth 46,000 përfitues, pra një shtesë neto me rreth 15,300 persona në vit, me një efekt financiar rreth 19.8 miliardë lekë.
- Mbulimi i efekteve financiare të skemave të reja të përfitimeve, naftëtarë minatorë të cilat pas rishikimit parashikohet të sjellin një efekt financiar të harmonizuar prej rreth 1.45 miliardë lekë.
- Sistemi do të vazhdojë të mbështesë me të ardhura mesatarisht nga 801-835 mijë persona që kanë përfituar dhe përfitojnë pensione publike, pensione suplementare si dhe një sërë të ardhurave të tjera të parashikuara me ligje si dhe, vendime të veçanta si dhe vendime kompensuese të Këshillit të Ministrave.
- Numri mesatar i kontribuesve në skemën e sigurimeve shoqërore parashikohet mbi 789-866 mijë persona me një rritje në masën 3% në krahasim me vitin parardhës.

- Shkalla e mbulimit të popullsisë në moshë punë (kontribues / popullsi në moshë pune) do të jetë mbi 43%.
- Pjesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore ndaj totalit të fondeve të alokuara për skemat e sigurimeve shoqërore do të arrijë të mbulojë mesatarisht rreth 64 % të totalit;
- Raporti kontribues/përfitues në periudhën afatmesme ndryshon nga **1.039** për vitin 2022 në **1.015** përgjatë periudhës 2023-2025;

Sistemi i Sigurimeve Shoqërore

Sistemi i sigurimeve shoqërore është fokusuar dhe synon:

- ✓ përmirësimin e vazhdueshëm të skemave aktuale, nëpërmjet forcimit të shtyllës publike të pensioneve e forcimit të një lidhje më të drejtpërdrejtë midis kontributeve të paguara dhe përfitimeve të ardhshme,
- ✓ futjen graduale të skemave të përfitimeve suplementare të menaxhuar nga subjekte jo publike,
- ✓ zhvillimin e forcimit të skemave të sigurimeve suplementare profesionale dhe vullnetare,
- ✓ rritjen e efikasitetit dhe përmbushjes së funksioneve të ISSH-së nëpërmjet shtimit të kapaciteteve drejtuese, informatizimit të sistemit në përgjithësi të proceseve të punës dhe të informacionit arkivor,
- ✓ përmirësimin e shërbimit proklient.

Realizimi i objektivave të sipërcituar bëhet përmes menaxhimit me efikasitet dhe efektivitet të tre skemave:

✓ **Skema e Sigurimit të Detyrueshëm:**

Mbulon me fonde transfertat për individët nga pensionet publike, rastet e paaftësisë së përkohshme në punë, rastet e barrë lindjeve, rastet e aksidenteve në punë, në momentin e lindjes së të drejtës dhe nevojës për to. Gjithashtu, mbulon mbledhjen dhe administrimin e të ardhurave nga kontributet e fermerëve dhe të siguruarve vullnetarisht, administrimi i kontributeve dhe i transfertave me destinacion nga Buxheti i Shtetit në buxhetin e ISSH, si dhe administrimin e të gjithë informacionit që lidhet me të drejtat e fituara të kontribuesve në skemën e sigurimit shoqëror të detyrueshëm.

✓ **Skema e Sigurimit Suplementar**

Mbulon transfertat fondeve shtetërore për individët që kanë kryer funksione kushtetuese, ish ushtarakët dhe policisë së rendit, si dhe mbështetje për ata individë që kanë statusin e profesorit, naftëtarit, metalurgut, si dhe punonjësve që kanë punuar në miniera.

✓ **Skema Kompensuese të shtetit dhe trajtimeve të veçanta**

Mbulon transfertat fondeve shtetërore në buxhetet individuale të pensionistëve dhe personave të tjerë rezidentë që përfitojnë nga programe kompensuese shtetërore ose trajtime të veçanta financiare si personat nën statusin "Dëshmor i Atdheut", punonjësit e ndërmarrjeve ushtarake, për pilotët fluturues në pension, etj.

Buxheti i ISSH-metodologjia e përgatitjes

Llogaritjet për përgatitjen e buxhetit të ISSH-së bëhen duke përdorur modelin aktuarial afatmesëm, i cili kalon nëpër të gjitha hapat e kryerjes së një parashikimi. Kjo konsiston në:

- ✓ mbledhjen dhe analizën e të dhënave;
- ✓ hartimin e bashkësisë së supozimeve për periudhën që parashikohet;
- ✓ plotësimin e të dhënave në periudhën bazë dhe supozimet në periudhën e parashikimit;
- ✓ ekzekutimin e modelit dhe kryerjen e parashikimeve;
- ✓ marrjen e rezultateve dhe analizën e tyre.

Për periudhën 2022-2025 buxheti i parashikuar për ISSH në terma të ardhurash dhe shpenzimesh paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Raporti të ardhura nga kontributet me transfertën nga Buxheti i shtetit rezultojnë respektivisht për periudhën 2023: **1.65**, 2024: **1.67** dhe 2025: **1.76**.

Buxheti i ISSH në terma përfituesish për periudhën 2020-2025 rezultojnë sipas tabelës më poshtë:

Në milionë Lekë

ne milione leke

| Emërtimi | njesia | fakt | | Përfshin dhe rritjen nga data 01.10.2022 | Programim | | |
|--|--------------|----------------|----------------|--|----------------|----------------|----------------|
| | | Vjetor | | | Vjetor | | |
| | | 2020 | 2021 | 2022 | 2023 | 2024 | 2025 |
| 1 SHPENZIMET | | | | | | | |
| Sigurimi Shoqëror i Detyrueshem | milione leke | 113,212 | 126,126 | 133,109 | 141,930 | 154,321 | 160,788 |
| 1 për paafësi të përkohshme | " | 461 | 529 | 538 | 590 | 617 | 646 |
| 2 barrëindje | " | 3,899 | 4,137 | 4,180 | 4,563 | 4,796 | 5,021 |
| 3 pensione | " | 108,830 | 121,441 | 128,367 | 136,752 | 148,881 | 155,089 |
| 4 aksidente e sëmundje profesionale | " | 22 | 20 | 24 | 25 | 27 | 31 |
| 2 Sigurime suplementare | " | 5,762 | 6,473 | 7,392 | 7,783 | 8,237 | 8,732 |
| 1 sigurimi shtetëror suplementar | " | 687 | 765 | 955 | 1,229 | 1,328 | 1,436 |
| 2 sigurimi suplementar ushtarake dhe i policisë së shtetit | " | 3,393 | 3,727 | 4,039 | 4,239 | 4,447 | 4,671 |
| 3 statusi i profesorit | " | 158 | 183 | 213 | 229 | 252 | 277 |
| 4 statusi i naftëtarit | " | 411 | 515 | 776 | 654 | 707 | 764 |
| 5 statusi i metalugut | " | 71 | 80 | 134 | 101 | 109 | 118 |
| 6 trajtimi i vecantë i punonjësve të nëntokës | " | 1,042 | 1,202 | 1,275 | 1,331 | 1,396 | 1,465 |
| 3 Programe kompensuese të shtetit dhe trajtime të vecanta | " | 12,945 | 13,016 | 13,548 | 9,115 | 8,941 | 8,798 |
| 1 kompensime çmimesh | " | 4,532 | 4,633 | 5,118 | 4,604 | 4,618 | 4,644 |
| 2 pensione të posaçme shtetërore | " | 87 | 76 | 72 | 91 | 95 | 100 |
| 3 shpërblime për pensione për veteranët | " | 92 | 68 | 79 | 47 | 42 | 35 |
| 4 shpërblime për invalidët e punës | " | 35 | 32 | 93 | 33 | 34 | 35 |
| 5 kompensime për të ardhurat e pensionistëve | " | 4,268 | 4,121 | 4,023 | 3,687 | 3,454 | 3,235 |
| 6 pensioni social | " | 184 | 181 | 199 | 224 | 256 | 293 |
| 7 statusi "Dëshmor i Atdheut" | " | 27 | 29 | 28 | 27 | 27 | 27 |
| 8 trajtimi i vecantë i pilotëve fluturues në pension | " | 70 | 72 | 73 | 97 | 100 | 104 |
| 9 trajtimi i vecantë i punonjësve të industrisë ushtarake | " | 59 | 72 | 65 | 74 | 74 | 74 |
| 10 ushtarakët e nëndetesëve në pension | " | 13 | 12 | 13 | 12 | 13 | 13 |
| 11 shpenzimi varrimi | " | 180 | 221 | 286 | 217 | 227 | 239 |
| 12 bonusi i pensionistit | " | 3,400 | 3,500 | 3,500 | | | |
| TOTALI I SHPENZIMEVE | | 131,920 | 145,616 | 154,049 | 158,828 | 171,499 | 178,318 |
| SHPENZIME ADMINISTRATIVE | | 2,232 | 2,414 | 2,950 | 3,757 | 3,339 | 3,521 |
| TOTALI | | 134,152 | 148,030 | 156,999 | 162,585 | 174,838 | 181,839 |

ARSIMI DHE SPORTI

• **Prioritetet 2023-2025**

Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve do të vijojë masat e saj të integruara për mbështetjen e arsimit bazë, të mesëm, dhe të lartë, orientimin e kurrikulave ndaj nevojave të tregut të punës dhe modernizimin e tyre, si edhe mbështetjen për trajnim dhe punësim të kategorive të veçanta. Për periudhën 2023-2025, Ministria e Arsimit dhe Sportit do të financojë me prioritet:

- ✓ **Rritjen e numrit të fëmijëve që ndjekin arsimin parashkollor**, si dhe përfshirjes së klasës përgatitore në arsimin e detyrueshëm;
- ✓ **Reduktimin e numrit të klasave kolektive**;
- ✓ **Sigurimin e shërbimit të transportit**, si dhe mbulimin e shpenzimeve të transportit të 35 mijë fëmijëve dhe nxënësve që kanë vendbanimin e tyre mbi 2 km nga shkolla, si dhe transportin për rreth se 12 mijë mësuesve që punojnë mbi 5 Km nga vendbanimi/qendra e përhershme e punës në shkollë,
- ✓ **Ofrimi i teksteve shkollore falas** për 280 mijë nxënësi që ndjekin arsimin bazë nga klasa e parë në klasën e nëntë, si dhe tekste shkollore falas nxënës nga shtresa sociale në nevojë në arsimin e mesëm të lartë;
- ✓ **Ofrimin e bursave financiare apo kuotë ushqimore/financiare për 2800-3000 nxënës me nevoja të veçanta** si dhe fëmijëve më me ndikim në uljen e braktisjes shkollore, të nxënësve të arsimit para-universitar nga shtresat sociale në nevojë;
- ✓ Hartimin e programeve specifike për arsimimin e grupeve të pa favorizuara. Deri në vitin 2023, çdo fëmijë rom dhe egjiptian, do të regjistrohet në shkollë, 100% e tyre do të mbarojnë arsimin e detyruar dhe 70% më shumë vajza e djem romë dhe egjiptianë do të përfundojnë të arsimin e mesëm të lartë.
- ✓ **Përmirësimin e infrastrukturës shkollore**, shkolla dhe konvikte të reja sipas standardeve evropiane;
- ✓ Rritjen e numrit të **punonjësve të shërbimit psiko-social** në sistemin e arsimit parauniversitar;
- ✓ Zhvillimin dhe zbatimin e kurrikulave bazuar në standarde të krahasueshme me vendet e BE-së, nëpërmjet: zbatimit të kurikulës së re në të gjithë sistemin e arsimit parauniversitar si dhe përgatitjes së teksteve specifike për nxënësit e pakicave kombëtare;
- ✓ **Fuqizimin e TIK-ut në arsim**, nëpërmjet: hartimit të një platforme dhe plani kombëtar veprimi për zbatimin e TIK-ut në arsim si dhe krijimit të një infrastrukture të qëndrueshme, gjerësisht të përdorshme të burimeve digjitale në shkolla;
- ✓ **Përfshirja e gjuhës së huaj** (gjuhës angleze) që në klasën e parë të arsimit fillor dhe nga klasa e tretë dy gjuhë të huaja, nga të cilat gjuha angleze si dhe një gjuhë tjetër e huaj me zgjedhje;
- ✓ Rritja e fondeve grant për IAL publike “Pakti për Universitetet”, përmes financimit me përparësi për ngritjen e infrastrukturës dhe investimeve në kampuse universitare, rritjes së fondeve për mbështetjen studentore, për të mbuluar shpenzimet për bursat e studentëve nga shtresat sociale në nevojë, si dhe studentëve ekselencë në IAL publike, si dhe rritje a fondeve për përjashtimi apo

reduktimi i tarifave vjetore të shkollimit për studentët e ekselencës apo studentët e kategorive sociale në nevojë;

- ✓ **Edukimi nëpërmjet sportit** si një faktor efikas në përmirësimin e shëndetit e të mirëqenies për qytetarët përmes sigurimit të një shërbimi cilësor nëpërmjet sportit elitare dhe sportit në tërësi në institucionet arsimore duke kontribuar kështu dhe në forcimin e statusit të të rinjve shqiptarë në të gjitha fushat e jetës.
 - ✓ **Klasat e profilizuara sportive** - Do të rritet numri i klasave të profilizuara sportive në mënyrë progresive në të gjithë vendin, duke filluar që nga viti shkollor 2021-2022 nga 223 në 423, duke shtuar edhe disiplina të reja sportive, si gjimnastikë, atletikë dhe tenis.
 - ✓ **Plani për zhvillimin e sistemit arsimor** do të pajisë studentët shqiptarë me dije dhe aftësi të konkurruese me bashkëmoshatarët e tyre në BE. Shkollat profesionale dhe universitetet do të përgatisin qytetarin e mirë dhe punonjësin e suksesshëm të vitit 2030-të.
 - ✓ Me investimet në laboratorë për kërkimin shkencor dhe me sigurimin e integritet akademik dhe shkencor të universiteteve, do të përmirësohet cilësia e produkt universitar, ndërsa diploma e secilit student do të mbartë vlerën që duhet ta ketë.
 - ✓ Me investimet infrastrukturore në kampuset universitare, do të përmirësohet eksperiencia studentore dhe do të inkurajohen të rinjtë të ndjekin ëndrrat e tyre në kampuset universitare shqiptare.
 - ✓ **Ndërkombëtarizimi i Arsimit të Lartë** - fillohet puna për hapjen e filialeve të Universiteteve më të mira ndërkombëtare në Shqipëri, si dhe për programe studimi të përbashkëta dhe të dyfishta me to. MASR do të mbështesë hapjen e programeve në gjuhën angleze në të gjitha universitetet shqiptare.
- **Rezultatet që synohet të arrihen për periudhën afatmesme 2023-2025**

Për arsimin parauniversitar për periudhën 2022-2024 synohet si më poshtë :

1. Të sigurohet rritja e aksesit të fëmijëve 3-6 vjeçarë në masën 86% në arsimin parashkollor.
2. Të realizohet trajnim çdo vit i mesatarisht 51% i mësuesve në AB dhe rreth 120 mësuesve nga diaspora si dhe mesatarisht 500 mësues ndihmës për fëmijët me AK;
3. Të sigurohet standardi 3.5 - 5m² për nxënës dhe sigurimi i të gjitha standardeve;
4. Të përshtaten mjediset ekzistuese shkollore për fëmijët me AK, të pajisen të gjitha ndërtesat shkollore me rampën.
5. Të sigurohet që numri mesatar i fëmijëve në institucionet e arsimit parashkollor në zonat urbane të jetë 18-20 fëmijë për grup ose për klasë;
6. Të rritet përqindja e nxënësve Romë dhe Egjiptian, që ndjekin arsimin 9-vjeçar Publik, (Klasa 1 - Klasa 9) nga 4.8% në vitin 2022 në 5.4% në vitin 2025.
7. Të rritet numri i mësuesve ndihmës për personat me aftësi të Kufizuar apo aftësi ndryshe nga nga 2% në vitin 2022 në 9.5% në vitin 2025;
8. Të rritet numri i psikologëve dhe punonjësve socialë të trajnuar nga 450 në vitin 2022 në 650 deri në vitin 2025.

9. Të sigurohet që brenda vitit 2024, 100% e mësuesve, nxënësve në arsimin e mesëm të ultë, klasa 6-9 të jenë të pajisur me laptop/kompjuter/IPAD si dhe me klasa mësimore dixhitale inteligjente.
10. Krijimi dhe pajisja e laboratorëve smart IT ku parashikohet të përfitojnë 20-25 mijë nxënës;
11. Deri në vitin 2025, 98-99% e nxënësve që mbarojnë arsimin bazë të regjistrohen në një nga format/ llojet e arsimit të mesëm;
12. Në vitin 2025, 100% e shërbimit arsimor realizohet vetëm me një turn (08.00-15.30);
13. Rritja e Nxënësëve të Arsimit të mesëm të lartë që ju sigurohen tekstet shkollore falas (klasa 10 deri në klasën12) me mesatarisht 26% deri në vitin 2025;
14. Norma e braktisjes së shkolles në % në arsimin e mesëm të përgjithshëm të ulet nga 0.46% në vitin 2022, në 0.42% në vitin 2025.
15. Raporti mësues/nxënës në arsimin e mesëm krahasuar me mesataren e rajonit deri në vitin 2025 të shkojë 11.4.
16. Rreth 20% e nxënësve ndjekin arsimin profesional kundrejt totalit në AM.

Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor për periudhën 2023-2025 parashikohet sa më poshtë:

1. 100% të programeve studimore të akredituara brenda vitit 2030;
2. Të sigurohet standardi një vend pune në laborator kërkimorë shkencorë për dy studentë, në përputhje me parimet e barazisë gjinore;
3. Të sigurohet standardi 5-8 m² për student sipas natyrës së programit të studimeve në vitin 2024, në përputhje me parimet e barazisë gjinore.
4. Fonde Grant për IAL të arrijnë në 0.55% ndaj PBB në vitin 2024;
5. 100% e të dhënave të stafit akademik, të studentëve, të karrierës akademike, diplomimit, janë transparente dhe të sigurta, në regjistrin elektronik kombëtar.
6. 100% e studentëve ekselencë, studentë në nevojë të përfitojnë bursa e studentore në 2022-2025;
7. 90% e stafëve me kohë të plotë të departamenteve të jenë me grada/tituj në 2025, në përputhje me parimet e barazisë gjinore.
8. Raporti mesatar student/pedagog të arrijë 15/1, në vitin 2024.
9. Numrit të kërkuesve për 1000 banor në deri në vitin 2025 të arrijë treguesit mesatare për kërkues në OECD;
10. Të arrihet standardi 7 kërkues për çdo 1000 të punësuar në vitin 2021;
11. 30% e kërkuesve shkencorë janë Vajza/Gra me synim që pas vitit 2021 të sigurohet barazi gjinore në projektet fitues;
12. Të rritet me 10-15% në vit numri i Aplikimeve nga programet bilaterale dhe Programin Horizon Europe 2020;
13. Rritja e numrit të projekteve inovative për periudhën 2023-2025.

Për sportin dhe rininë për periudhën 2023-2025 parashikohet sa më poshtë:

1. Mbështetje financiare për rreth 20-25 sportistë elitari në vit,
2. Rritje e numrit të sportistëve të licensuar në federata shqiptare të sportit, në 29161 deri në vitin 2025, në përputhje me parimet e barazisë gjinore;
3. Numri i pjesëmarrjeve në aktivitetet ndërkombëtare, 258 aktivitete ndërkombëtare;
4. Numri i medaljeve në aktivitetet ndërkombëtare, 20-25 medalje përgjatë viteve 2023-2025;

ARSIMI PROFESIONAL DHE PUNËSIMI

Strategjia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive 2019 - 2022 është dokumenti kryesor i politikës që udhëzon zbatimin e veprimeve që lidhen me punësimin dhe zhvillimin e aftësive në vend dhe hartohet bazuar në objektivin strategjik “Ofrimi i arsimit dhe trajnimit profesional cilësor për të rinjtë dhe të rriturit. Arsimi profesional ofrohet në 35 shkolla publike të arsimit profesional. Këto institucione ofrojnë 25 drejtime mësimore, 86 profile profesionale dhe në total numri i nxënësve në arsimin profesional për vitin 2021-2022 është 16.599 nxënës nga të cilët 2,785 janë vajza.

Prioritetet për periudhën afatmesme 2023-2025:

- Realizimin e një procesi mësimor cilësor e me kushte optimale të të nxënësve, teorik e praktik për t'i pajisur nxënësve me kompetencat e duhura.
- Ndërtimin, rikostruksion dhe pajisjen me pajisje dhe makineri të shkollave dhe reparteve të praktikave profesionale si një nga prioritetet dhe në programin e qeverisë Shqipëria 2030 për arsimin profesional;
- Rishikimi i programeve ekzsistuese dhe hartimi i programeve të reja në përputhje me parimet e barazisë gjinore dhe gjithëpërshirjes në zbatim të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve,
- Hartimi dhe miratimi i standarteve të profesioneve dhe kualifikimeve sipas niveleve të KSHK;
- Zhvillimi i vazhdueshëm profesional i mësuesve si një nga shtyllat kryesore të sigurimit të cilësisë në arsimin profesional.
- Implementimi i akreditimit të ofruesve të AFP-së;
- Funksionimi i komitetit të parë sektorial, dhe funksionimi i Këshillit kombëtar të AFP;
- Ngritja dhe funksionimi i strukturës së Inspektimit Arsimit Profesional.

✓ Rezultatet që synohet të arrihen për periudhën afatmesme 2023-2025

- Rritjen e numrit të të punësuarve pas diplomimit në shkollat e mesme profesionale në 46% të totalit që mbarojnë studimet në vitin 2025;
- Rritjen e numrit të të diplomuarve në shkollat e mesme profesionale, nga 3.800 nxënës në 2021, në 4,000 nxënës në vitin 2025;
- Rritjen e numrit të nxënësve që vijnë nga zonat rurale të cilët ndjekin studimet në shkollat e mesme profesionale, nga 43% e totalit në vitin 2021 në 55% e totalit në vitin 2024;

- Rritjen e numrit të nxënësve me aftësi të kufizuar që ndjekin studimet në shkollat e mesme profesionale nga 154 nxënës në vitin 2022 në 160 nxënës në vitin 2025.
- Rritjen e numrit të nxënësve që ndjekin studimet në shkollat e mesme profesionale, në 19.5% të totalit të nxënësve që ndjekin arsimin parauniversitar në vitin 2025, krahasur me 18% në vitin 2022;

TURIZMI DHE MJEDISI

Prioritetet për periudhën 2023-2025:

Në fushën e Turizmit, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka për qëllim kthimin e Shqipërisë në një destinacion tërheqës turistik, cilësor dhe të qëndrueshëm, duke shfrytëzuar potenciale dhe burime lokale, duke u fokusuar në atë çka është unike në vendin tonë. Ndërsa për fushën e Mjedisit, synohet sigurimi dhe përmirësimi i cilësisë së mjedisit, në dobi të brezave të sotëm dhe të ardhshëm, si dhe sigurimin e kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit.

Prioritetet për periudhën 2022-2024:

- ✓ Diversifikimi i produktit turistik për të arritur një turizëm gjithëvjeter;
- ✓ Arritja e përmirësimeve të matshme të cilësisë së ajrit në vitin 2024 sipas përcaktimeve në strategjinë kombëtare të ajrit;
- ✓ Përmirësimi i performancës së menaxhimit të integruar të mbetjeve;
- ✓ Rritja e sipërfaqes se zonave të mbrojtura;

✓ Rezultatet që synohen të arrihen gjatë periudhës 2023-2025:

- Rritja e kontributit direkt që ka Turizmi në Produktin e Brendshëm Bruto;
- Rritja e përpjesës së punësimit në sektorin e Turizmit ndaj totalit të të punësuarve në vend;
- Ofrimi i incentivave për rritjen e numrit të bizneseve në sektorin e agriturizmit.
- Diversifikimi i produktit turistik për të arritur një turizëm gjithëvjeter;
- Arritja e përmirësimeve të matshme të cilësisë së ajrit sipas përcaktimeve në strategjinë kombëtare të ajrit;
- Përmirësimi i performancës së menaxhimit të integruar të mbetjeve;
- Rritja e sipërfaqes se zonave të mbrojtura në 20%;
- Rritja e përqindjes së mbetjeve që shkojnë në landfille sanitare kundrejt mbetjeve të hedhura në venddepozitime të hapura në 60%;
- Rritja në përqindje e mbetjeve të ricikluara në 59%;
- Rritja e të punësuarve në sektorin e turizmit në 29%.

KULTURA

Prioritetet 2023-2025:

Në fushat e kulturës dhe trashëgimisë kulturore do të prioritetizohet:

- Përmirësimi dhe zgjerimi i tregut kulturor nëpërmjet një legjislacioni në dobi të krijuesve, krijimtarisë artistike e kulturore dhe trashëgimisë kulturore, si dhe hartimi i paketës së re të skemës së mbështetjes së projekteve të Ministrisë të Kulturës;

- Ruajtja dhe mbrojtja e trashëgimisë kulturore materiale dhe jomateriale – pasuri kombëtare e popullit shqiptar në breza;
- Mbështetja e krijimtarisë dhe aktivitetit krijues të artistëve shqiptarë përmes rritjes së aktiviteteve kulturore dhe përfshirjes së artistëve;
- Promovimi dhe përfaqësimi i vlerave të artit dhe trashëgimisë kulturore shqiptare, materiale dhe shpirtërore në evenimentet e rëndësishme ndërkombëtare;
- Zbatimi me sukses i Platformës kombëtare “Edukimi përmes artit” nga të gjitha institucionet e Artit dhe Trashëgimisë dhe në sistemin para universitar.
- Forcimi i partneritetit publik dhe privat për realizimin e projekteve rijetëzuese në qendrat e trashëgimisë kulturore kombëtare;
- Mbështetja e krijimtarisë dhe aktivitetit krijues të artistëve shqiptarë përmes rritjes së aktiviteteve kulturore dhe përfshirjes së artistëve, kryesisht të rinj nga Universiteti i Arteve, Tiranë (UART), në zbatim edhe të Paktit për Universitetin/ Studentët.
- Përmirësimi i gjendjes fizike të monumenteve të kulturës përmes ndërhyrjeve të vazhdueshme në të gjithë vendin, përmirësimi i infrastrukturës në Muzetë Kombëtarë, Parqe Arkeologjike si dhe përmirësimin i gjendjes fizike të monumenteve të kulturës përmes ndërhyrjeve të vazhdueshme në të gjithë vendin.
- Edukimi përmes librit dhe veprimtarive bibliotekare, pasurimi i fondit bibliotekar në të gjithë rrjetin e bibliotekave në mbarë vendin, me qëllim rritjen dhe edukimin e lexuesit.
- Rritja e aksesit të publikut në Muze, Monumentet e kulturës, ansambleve arkitektonike, qyteteve muze, qendra historike, zonave dhe parqeve arkeologjike në funksion të turizmit kulturor.

✓ **Rezultatet që synohet të arrihen për periudhën afatmesme 2023-2025**

Për Trashëgiminë kulturore

- Restaurimi dhe mirëmbajtja e trashëgimisë arkitektonike dhe peisazhit, duke përfshirë restaurimin e disa linjave muzeale, si edhe përshtatjen me standarde bashkëkohore. Rritja e numrit të objekteve të trashëgimisë arkitektonike dhe peisazhit të restauruara dhe mirëmbajtura nga 145 në vitin 2021 në 155 në vitin 2024.
- Rritja e aksesit të publikut në Muze, Monumentet e kulturës dhe Parqe Arkeologjike në funksion të turizmit kulturor (nr. Vizitorësh), nga 200 mijë vizitorë në vitin 2021 në 210 mijë turistë në 2022; në 220 mijë turistë në 2023 dhe 230 mijë turistë në vitin 2024.
- Rritja e numrit të objekteve të regjistruara në databazën kombëtare të trashëgimisë, nga 100 mijë objekte në vitin 2021 në 110 mijë objekte në 2022 dhe 130 mijë përkatësisht në vitet 2023 – 2024.
- Rritja e mbështetjes për aktiviteteve të fushës së trashëgimisë kulturore përgjatë viteve 2022-2024 nga 80 aktivitete të mbështetura në vitin 2021 në 122 aktivitete në 2024.
- Vijimi i mbështetjes financiare për projektet në fushën e artizanatit, kulinarisë dhe dukurive të tjera të trashëgimisë jomateriale, veçanërisht për gratë artizane (30% ndaj totalit të përfituesve).

Për Artin dhe Kulturën

- Rritja e aksesit në kulturë, e cila parashikon një rritje të vazhdueshme të numrit dhe cilësisë së aktiviteteve në të gjitha zhanret. Rrjet aktivitetesh që synojnë në konsolidimin e vlerave artistike,

promovimin e Artit Shqiptar në arenën ndërkombëtare, mbështetja e aktiviteteve kulturore në mbarë vendin nëpërmjet thirrjeve për aplikime në fushën e artit dhe kulturës librit dhe përkthimit.

- Prioritet do të jetë integrimi, angazhimi dhe promovimi i të rinjve më të evidentuar të kësaj fushe.
- Nxitja e konkurrencës artistike përmes audicioneve dhe konkurrimit publik krahasuar me një vit më parë.
- Zhvillimi i rreth 600 aktiviteteve nga kalendarët artistik të zhvilluara nga Institucionet qendrore publike të art – kulturës.
- Mbështetja e skenës së pavarur për të mundësuar edukimin përmes kulturës si dhe përfaqësimin e produktit artistik në arenën elitare ndërkombëtare.
- Mbështetja e 60 projekteve me thirrje në mbështetje të industrive krijuese duke respektuar barazinë gjinore, të drejtat e njeriut, grupet e marginalizuara dhe diversitetin kulturor në rang vendi.

Investimet Publike në sektorin e kulturës për vitet 2023-2025:

- Rijetësimi i Piramidës Tiranë, projekt me bashkëfinancim me Bashkinë e Tiranës që do të shtrihet përgjatë viteve 2021-2024.
- Restaurimi, Rikonstruksioni dhe Rehabilitimi i hapësirave në Muzeun e Arteve të bukura (Galeria Kombëtare e Arteve).
- Projektim dhe Implementim i Mozaikut Tiranë, i cili pritet të përfundojë në vitin 2023.
- Ndertimi i Qendrës Kombëtare Kulturore për Femijë dhe Teatri i Kukullave
- Ndërtimi i Godinës së Teatrit Tiranë.
- Projekti Elektrik për ndriçimin e jashtëm - Kalaja e Shkodrës dhe Kalaja e Beratit.
- Restaurimi i "Kishë së Shën Kollit", Krutje e Sipërme, Lushnje.
- Hartim projekti i Cirkut të Ri Kombëtar;
- Shpronësimi i Amfiteatrit të Durrësit;
- Shpronësimi i shtëpisë së Toptanasve;
- Ngritja e platformës dixhitale për të drejtën e autorit dhe dixhitalizimi e përmirësimi i sistemeve AQSHF;
- Projekte me ndërhyrje emergjente restauruese që rrezikojnë të zhduken.

DREJTËSIA

- **Prioritetet 2023-2025:**

Ministria e Drejtësisë, në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet, ushtron funksione dhe ka në kompetencë hartimin dhe ndjekjen e politikave, përgatitjen e akteve ligjore dhe nënligjore, si dhe ushtrimin e shërbimeve të nevojshme lidhur me sistemin gjyqësor, sistemin e ekzekutimit të vendimeve penale dhe civile, sistemin e shërbimeve të lira juridiko-profesionale, bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën civile dhe penale, fushat e tjera të drejtësisë dhe të kompetencës së saj sipas ligjit, si dhe për bashkërendimin, harmonizimin dhe reformimin e legjislacionit shqiptar në tërësi.

Në funksion të përparësive kryesore të Ministrisë së Drejtësisë, janë përcaktuar dhe objektivat për realizimin e tyre për periudhën 2023-2025, të cilat janë:

- ✓ Jetësimi i Reformës në Drejtësi
 - a) Funkcionalizimi i organeve të reja të drejtësisë.

- b) Përmirësimi i kuadrit ligjor dhe miratimi i akteve nënligjore për zbatimin e reformës në drejtësi.
 - c) Zbatimi i reformimit të sistemit të drejtësisë për të miturit në konflikt me ligjin.
 - d) Reformimi i shërbimeve publike, rritja e efikasitetit të tyre.
 - e) Ndërmarrja e masave konkrete për një reformim legjislativ, institucional dhe strukturor për të gjithë ato institucione ligj zbatuese që mundësojnë që shqiptarët të marrin shërbime ligjore në kohë, sa më cilësore, profesionale dhe në mënyrë dinjitoze.
 - f) Përmirësimi i sistemit të ndihmës juridike falas që çdo qytetar në pamundësi financiare dhe grupet në nevojë, të përfitojë nga ky shërbim në mënyrë cilësore.
 - g) Reformimi i sistemit penitenciar në tërësi, menaxhimit efektiv të institucioneve të vuajtjes së dënimit dhe rritja e profesionalizmit dhe integritetit të stafit të burgjeve, si ai policor dhe civil.
 - h) Përmirësimi i shërbimit të provës për monitorimin e zbatimit të dënimeve alternative me një staf profesional dhe me integritet.
- ✓ Forcimi i Luftës kundër Korrupsionit në Administratë;
- a) Përmirësimi i trajtimit të denoncimeve ndaj korrupsionit.

✓ **Rezultatet që synohet të arrihen për periudhën afatmesme 2023-2025**

Ministria e Drejtësisë për periudhën 2023-2025 synon:

- Ofrimin e ndihmës juridike falas për 6,300 individë që plotësojnë kushtet në zbatim të ligjit për ndihmën juridike falas.
- Ofrimin e ndihmës juridike falas për 3700 gra e vajza në nevojë të cilat plotësojnë kushtet.
- Realizimin e rreth 17,500 akte ekspertimi të klasifikuara si; mjeko-ligjore, toksikologjiko-ligjore, biologjiko-ligjore dhe psikiatriko-ligjore, në përputhje me standartet europiane.
- Përmirësimin e kushteve në sistemin penitenciar dhe uljen e mbipopullimit në burgje. Përqindja e IEVP-ve që garantojnë kushtet e sigurisë, trajtimit dhe rehabilitimit të të dënuarve parashikohet të ketë trend rritës, konkretisht nga 46% e parashikuar për 2022, në 50% në fund të vitit 2025.
- Sigurimin e kushteve të përshtatshme të rreth 5500 të dënuarve burra, 86 të dënuara gra dhe 36 të dënuar të mitur, si dhe të trajtohen me shërbim shëndetësor 382 të dënuar të sëmurë.
- Ri-integrimin nëpërmjet zhvillimit të programeve për rehabilitimin në shoqëri të paraburgosurve dhe të dënuarve në përputhje me standartet europiane, ku parashikohen të riintegrohen rreth 360 të dënuar burra, 2 të dënuara gra dhe 6 të dënuar të mitur.
- Të mbikqyrë në mënyrë efektive 6,880 burra, 790 gra dhe 186 të mitur gjatë shërbimit të provës.
- Realizimin e skemës së shpërndarjes së Fondit Special të Kompensimit nga 1,600 e parashikuar për 2023, në 1,936 për 2025.
- Ekzekutimin me efektivitet dhe brenda afateve ligjore të titujve të përmbartimit gjyqësor.
- Garantimin e interesit më të lartë të fëmijëve, nëpërmjet vendosjes në familje të përhershme që përshtaten me nevoja specifike të secilit prej tyre, me synimin që 100% e totalit të biësimeve të rezultojnë të suksesshme.

POLITIKA E JASHTME

• Prioritetet 2023-2025:

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme formulon, përpunon dhe është zbatuesi kryesor i politikës së jashtme të shtetit shqiptar, në zbatim të programit të qeverisë. Ajo drejton dhe bashkërendon procesin e anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian. MEPJ në dialog dhe marrëdhënie me të gjithë partnerët ndërkombëtare, pasqyron të gjitha zhvillimet në Shqipëri, përfaqëson e mbron interesat kombëtare si dhe punon për interesat e shtetasve shqiptarë kudo që ata ndodhen, në të mirë të lirisë, sigurisë dhe mirëqënies së tyre.

Objektivat kryesorë që synohen të arrihen nga aktiviteti i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme për vitin 2023-2025 janë:

- Avancimi i negociatave për anëtarësimin në Bashkimin Evropian;
- Avancimi në zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit BE-Shqipëri, me fokus në dialogun politik dhe çështjet rajonale, iniciativat dhe bashkëpunimin rajonal;
- Angazhimi i shtuar në kuadrin e linjësimit dhe politikën e jashtme dhe të sigurimit të BE-së, përfshirë ecurinë pozitive të kapitullit 31 “Politika e Jashtme e Sigurisë dhe Mbrojtjes”;
- Vijimi i komunikimit intensiv me vendet anëtare të KS për të siguruar bashkëpunimin sa më të afërt dhe efektiv gjatë periudhës së shërbimit si anëtarë jo i përhershëm i Këshillit të Sigurimit të OKB-së;
- Konsolidim i marrëdhënieve me Kosovën, përmes G2G, zbatimit të marrëveshjeve të përbashkëta, angazhimit për njohjen ndërkombëtare të shtetit të Kosovës, për pjesëmarrjen dhe anëtarësimin e saj në organizatat rajonale dhe ndërkombëtare, etj;
- Zbatimi i Strategjisë Kombëtare të Diasporës Shqiptare 2021-2025, mbështetja dhe organizimi i diasporës duke synuar rritjen e besimit të saj tek mekanizmat e zbatimit, regjistrimin e diasporën dhe rrjetëzimin e grupeve të profesionistëve në diasporë;
- Bashkëpunimi me partnerët ndërkombëtarë për të gjetur mundësi dhe zbatuar projekte që i sjellin shqiptarët e diasporës gjithmonë e më afër vendit të tyre. Marrëveshje me vende të ndryshme që synojnë të ndihmojnë dhe lehtësojnë jetën e përditshme të diasporës (marrëveshje për njohjen e lejeve të drejtimit dhe ato për sigurimet shoqërore);
- Modernizimi i shërbimeve konsullore në përmbushje të detyrave që rrjedhin nga Strategjia Kombëtare për Diasporën, duke synuar përafrimin e diasporës me vendin, identifikimin e nevojave dhe problemeve të tyre dhe ndërmjetësimi për zgjidhjen e tyre në vendin pritës.

MBROJTJA

• Prioritetet 2023-2025:

Ministria e Mbrojtjes synon të përmbushë reformat e nisura dhe realizimin e detyrave kushtetuese të Forcave të Armatosura (FA), angazhimeve ndërkombëtare në kuadër të NATO-s, angazhimeve të FA në kuadër rajonal dhe në aftësitë trajnuese të vetë FA. Më konkretisht, Ministria e Mbrojtjes synon:

- Modernizimin e kapaciteteve dhe infrastrukturës së FA duke:

- zhvilluar kapacitetet e FA në përputhje me Planin Afatgjatë të Zhvillimit;
- vijuar pajisjen e Forcave Tokësore me armatim të ri të ndërveprueshëm me aleatët në NATO;
- zgjeruar investimet në infrastrukturë për përmirësimin e mjediseve të punës dhe ushtarake;
- modernizuar pajisjet dhe sistemet kompjuterike.
- Vijimin e pjesëmarrjes në operacionet e NATO-s duke rritur nivelin e angazhimit të FA, në operacionet e Aleancës dhe pjesëmarrjen në misionet e iniciativat e reja që NATO mund të ndërmarrë.
- Zhvillimin dhe mbajtja në gatishmëri të kapaciteteve të FA për operacione të mbrojtjes kombëtare dhe kolektive, operacione në përgjigje të krizave, si dhe kapacitetet për përballimin e Emergjencave Civile, dhënien e ndihmës vendeve të rajonit në rast emergjencash civile në kuadrin e NATO-s, OKB-se dhe BE-së.
- Lartësimin e figurës dhe integritetit të ushtarakut, nëpërmjet zhvillimit të politikave të nevojshme në fushën e personelit, promovimit në karrierë, trajtimit të ushtarakut, rritjes së transparencës, llogaridhënies, si dhe eliminimin e korrupsionit në Forcat e Armatosura.

RENDI DHE SIGURIA PUBLIKE

- **Prioritetet 2023-2025:**

Ministria e Brendshme synon mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, si dhe garantimin e sigurisë së jetës, shëndetit dhe pronës së qytetarit, të cilat janë dhe prioritetet për veprimtarinë e Policisë së Shtetit, e cila do të ketë si togfjalësh kyç në veprimtarinë e saj, ‘kontrollin e territorit’ dhe ‘policimin në komunitet’, të realizuara në praktikë përmes riorganizimit të sistemit të prezencës së policisë në territor, në funksion të një kontrolli më efektiv të tij dhe transformimin rrënjësor të marrëdhënieve dhe shërbimit ndaj komunitetit. Gjithashtu, synon sigurimin e rendit publik, pronës publike e private, rritjen e parametrave të sigurisë rrugore, krijimin e një mjedisi të sigurt për komunitetin, nëpërmjet shërbimeve profesionale, në kohë dhe me cilësi dhe policimit me standardet me të larta të performancës.

Ministria e Brendshme synon të kontribuojë në përmirësimin e vazhdueshëm të Sigurisë së Personaliteteve Vendas dhe të Huaj, të Objekteve të Rëndësishme të Veçantë nëpërmjet rritjes së kapaciteteve menaxhuese dhe përputhjes me standartet europiane në fushën e sigurisë. Gjithashtu, Ministria e Brendshme synon konsolidimin e mëtejshëm të një sistemi bashkëkohor të dixhitalizuar të regjistrimit kombëtar të gjendjes civile (RKGJC), të sistemit të regjistrimit kombëtar të adresave (RKA) dhe sistemit të personalizimit dhe shpërndarjes së letërnjoftimit elektronik dhe pasaportës biometrike.

- ✓ **Rezultatet që synohet të arrihen për periudhën afatmesme 2023-2025**

Përgjatë 3 viteve të PBA 2023-2025, Ministria e Brendshme do të përmbushë objektivat e saj përmes:

- Rritjes së numrit të hetimeve proaktive në luftën kundër krimit të organizuar, trafikeve, korrupsionit dhe terrorizmit; Koncretisht synon rritjen e Hetimeve të kurorzuara me ndëshkim nga organet e drejtësisë mesatarisht me 3 % më shumë krahasuar me vitin 2022;
- Përmirësimin rrënjësor të sistemit të kontrollit rrugor, duke synuar krijimin e një kulture të re në qarkullimin e mjeteve dhe të qytetarëve dhe sidomos në menaxhimin e sigurisë rrugore. Synohet ulja e numrit të aksidenteve në rrugë në masën 1% çdo vit;

- Rritjes së nivelit të sigurisë publike duke forcuar kontrollin e territorit dhe policimin në komunitet përmes rritjes së numrit të shërbimeve të patrullimit si dhe reduktimit të kohës së reagimit të shërbimeve policore në 13 minuta në vitin 2025;
- Reduktimit të trafikeve, krimin ndërkufitar dhe rasteve të imigrimit të paligjshëm kryesisht nëpërmjet reduktimit të kohës së procedimit në 15 minuta në vitin 2025;
- Reduktimit të kohës së reagimit ndaj krimeve të dhunës në familje 13 minuta në vitin 2025;
- Rritja e hetimeve proaktive në fushën kundër korrupsionit dhe pastrimit të parave ndaj totalit të hetimeve nga 392 hetime në vitin 2022;
- Rritja e operacione policore mbi hetimet proaktive të realizuara nga strukturat policore, në 38 656 hetime në vitin 2025;
- Të kontribuojë në përmirësimin e vazhdueshëm të Sigurisë së Personaliteteve Vendas dhe të Huaj në përputhje me standardet europiane, konkretisht në zbatimin e standartin Gjerman.
- Përdorimit në mënyrë efektive të përditësimit të ngjarjeve në regjistrin civil, në autorizimin dhe certifikimin e aplikimeve për lëshimin e dokumenteve të identitetit. Synohet reduktimi i kohës për trajtimin e kërkesës nga sistemi i RKGJ-së (nga 1 orë në vitin 2022 në jo më shumë se 0.4 orë në vitin 2025).

BUXHETIMI I PËRGGJIGJSHËM GJINOR

Edhe për vitin 2023 Qeveria shqiptare do të vijojë të buxhetojë adresimin e çështjeve të barazive gjinore në sektorë të ndryshëm. Trendi i parashikimeve buxhetore lidhur me sektorët që adresojnë çështje të barazive gjinore vijon të jetë i njëjtë me vitet paraardhëse, ku rreth 9% e shpenzimeve të përgjithshme për të gjithë sektorët në nivel qendror parashikohet të shkojë për realizimin e objektivave gjinorë në: arsim, shëndetësi, mbrojtje sociale, rend publik, bujqësi, drejtësi, etj. Më konkretisht, më poshtë disa të dhëna për sektorët:

Politikat e zhvillimit rural për vitin 2023 do të financohen me rreth 12.7 miliardë lekë, ku prioritet do të kenë edhe:

- Rritja me 7% e pagave të administratës shtetërore të sektorit ku rreth 65% janë gra
- Rritja e numrit të grave që përfitojnë shërbimet e këshillimit dhe informacionit bujqësor
- Rritja e numrit të grave fermere që përfitojnë nga skemat kombëtare të subvencioneve si dhe nga programi IPARD II

Për sektorin e kulturës do të vijohet ti jepet përparësi:

- Grave dhe vajzave artiste që promovojnë skenën e pavarur
- Gratë artizane që ruajnë dhe trashëgojnë më tej vlerat dhe traditat e kulturës shqiptare

Parandalimi i rasteve të dhunës në familje, mbrojtja e viktimave të dhunës me bazë gjinore dhe asaj në familje si dhe rritja e rolit të grave në strukturat e rendit publik do të vijojnë të jenë prioritetet e sektorit edhe për vitin 2023.

Në sektorin e shëndetësisë do të vijojnë të mbështeten nënat e reja me shërbime të shëndetit parësor. Do të shtohet numri i grave dhe vajzave që përfitojnë nga shërbimet e depistimit të kancerit të gjirit dhe qafës së mitrës, do të punohet për të shtuar numrin e burrave të moshës 35-66 vjeç që përdorin shërbimet e check-up për identifikimin në kohë të sëmundjeve, etj.

Në fushën e mbrojtjes sociale do të rritet financimi i politikës së rishikimit të masës së përfitimit për Ndhimën Ekonomike si dhe politika e mbështetjes së çmimit të energjisë për përfituesit e kategorisë PAK, ku rreth 44% të përfituesve janë gra. Gjithashtu do të mbështetet edhe financimi i skemës së mbështetjes së nënave me 3 (tre) apo më shumë fëmijë të mitur me kosto rreth 600 mln lekë;

Me anë të fondit të akorduar për ministrinë e Drejtësisë synohet që:

- ✓ Të mbahen në kushte të përshtatshme rreth 5,500 të dënuar burra, 86 të dënuara gra dhe 36 të dënuar të mitur, si dhe të trajtohen me shërbim shëndetësor 382 të dënuar të sëmurë;
- ✓ Të ofrojnë ndihmë juridike falas për rreth 6,300 individë në total që plotësojnë kushtet në zbatim të ligjit për ndihmën juridike falas, prej të cilëve 3700 janë gra dhe vajza.
- ✓ Të realizojë rreth 17,500 akte ekspertimi të klasifikuara si; mjeko-ligjore, prej të cilave rreth 135 raste të dhunës seksuale
- ✓ Të ri-integrohen nëpërmjet zhvillimit të programeve për rehabilitimin në shoqëri të paraburgosurve dhe të dënuarve në përputhje me standartet europiane, rreth 360 të dënuar burra, 2 të dënuara gra dhe 6 të dënuar të mitur;
- ✓ Të mbikqyrë në mënyrë efektive 6,880 burra, 790 gra dhe 186 të mitur gjatë shërbimit të provës.

Fondet për “Sektorin e Arsimit” në vitin 2023, parashikohet të arrijnë në 65.3 miliard lekë, ose 10.42% krahasuar me shpenzimet publike dhe 3.33% ndaj produktit të brendshëm bruto.

- ✓ Politikat kryesore për zhvillimin e arsimit gjatë këtij viti synojnë të targetojnë edhe:
- ✓ Vajzat që vijnë nga familje në nevojë dhe/apo viktime të trafikimit duke mundësuar dhënien e teksteve shkollore falas për arsimin e mesëm
- ✓ Vajzat që ndjekin arsimin e parashkollor dhe bazë në zonat rurale që përbëjnë rreth 46.8% të 35-38 mijë nxënësve dhe fëmijë, që ndjekin arsimin parashkollor dhe arsimin bazë që mësojnë në një distancë prej më shumë se 2 km nga vendbanimi i përhershëm i tyre
- ✓ Vajzat që mbarojnë studimin e mesëm dhe vijojnë ciklin e parë të studimeve të larta duke ofruar shërbimin e konvikteve dhe kehtësirave të tjera
- ✓ 18% - 20% të studentëve të ciklit të parë dhe të dytë dhe në përputhje edhe me parimet e barazisë gjinore;
- ✓ Vajzat dhe gratë që kryejnë kërkim shkencor në IAL
- ✓ Personeli mësimdhënës në sistemin parauniversitar, ku pjesën më të madhe e zënë gratë, duke rritur pagat në vlerën 7%

Politikat e të punësimit dhe të arsimit profesional për gratë dhe vajzat vijojnë të jenë prioritet për këtë ministri, ashtu sikurse edhe politikat e mbrojtjes sociale të strehimit social apo të sigurimeve shoqërore, te cilat synojnë jo vetëm fuqizimin e grave dhe vajzave, por edhe ndihmën specifike ndaj atyre që janë viktime të dhunës me bzaë gjinore apo në familje. Rreth 9,787,459,644 lekë planifikohet të shpenzohen për këto politika gjatë 2023.

Në tabelën e mëposhtme² paraqiten në mënyrë më të detajuar shpenzimet e planifikuara me kostot përkatëse dhe disa nga produktet e drejtpërdrejta që adresojnë çështje të barazisë gjinore të sektorëve ku veprojnë ministrinë e linjës dhe institucione të tjera qendrore.

² Këtu përfshihen vetëm të dhënat e marra nga sistemi AFMIS dhe relacionet e institucioneve përkatëse. Përlllogaritjet përfshijnë vetëm të dhënat e dukshme në sistem. Politika/objektiva të tjerë që adresojnë në mënyrë jo të drejtpërdrejtë pabarazitë gjinore, nuk janë përfshirë në këtë përmbledhje.

| Ministria / Institucioni | Programi buxhetor | Kosto e planifikuar (në mijë lekë) |
|--|--------------------------------------|---|
| Ministria e Bujqesise dhe Zhvillimit Rural | Planifikim, Menaxhim, administrimi | 166,468,000 |
| | Keshillimi dhe informacioni bujqesor | 1,750,000 |
| | Zhvillimi rural | 2,905,886,575 |
| | Nen-Totali | 3,074,104,575 |
| Ministria per Evropën dhe Punet e Jashtme | Mbështetje Diplomatike jashtë vendit | 71,000,000 |
| | Nen-Totali | 71,000,000 |
| Ministria e Brendshme | Gjendja civile | 263,690 |
| | Policia e shtetit | 277,898,738 |
| | Nen-Totali | 278,162,428 |
| Ministria e Mbrojtjes | Forcat e luftimit | 850,176,998 |
| | Arsimi ushtarak | 101,804,182 |
| | Nen-Totali | 951,981,180 |
| Ministria e Shendetesisë dhe Mbrojtjes Sociale | Shëndeti parësor | 450,033,600 |
| | Shëndeti dytësor | 3,442,787,423 |
| | Shëndeti publik | 49,095,000 |
| | Mbrojtja sociale | 23,222,018,215 |
| | Nen-Totali | 27,163,934,238 |
| Ministria e Drejtesise | Planifikim, Menaxhim, administrimi | 23,100,000 |
| | Ndihma Juridike | 27,000,000 |
| | Sistemi i burgjeve | 8,390,000 |
| | Përmbarami gjyqësor | 62,157,539 |
| | Mjekesia ligjore | 14,700,000 |
| | Nen-Totali | 135,347,539 |
| | Ministria e Arsimit dhe Sportit | Planifikim, Menaxhim, administrimi |
| Arsimi bazë | | 9,319,780,635 |
| Arsimi i mesëm i pergjithshem | | 3,643,722,588 |
| Arsimi i lartë | | 4,641,288,000 |
| Fonde për shkencën | | 100,000 |
| Nen-Totali | | 17,619,791,223 |
| Ministria e Financave dhe Ekonomisë | Planifikim, Menaxhim, administrimi | 19,429,385 |
| | Arsimi i mesem profesional | 286,340,320 |
| | Tregu i punës | 646,321,503 |
| | Menaxhimi is shpenzimeve publike | 2,150,000 |
| | Sigurimet shoqërore | 3,660,645,008 |
| | Strehimi social | 534,713,429 |
| | Sigurimet shoqërore | 4,637,859,999 |
| | Nen-Totali | 9,787,459,644 |
| Ministria e Infrastrukturës dhe Energjise | Ujesjelles-Kanalizime | 10,800,000 |
| | Nen-Totali | 10,800,000 |
| Avokati i Popullit | Shërbime të avokatisë | 2,166,753 |
| | Nen-Totali | 2,166,753 |
| Shkolla e Magjistraturës | Planifikimi, menaxhimi, administrimi | 33,245,737.20 |
| | Nen-Totali | 33,245,737 |
| Totali | | 59,127,993,317 |
| Totali Shpenzimeve Buxhetore 2023 | | 681,209,000,000 |
| Perpjesa e Buxhetimit te Pergjigjshem Gjinator (ne %) | | 9% |

5. BUXHETI VENDOR 2023

Reformat në qeverisjen vendore ndër vite janë fokusuar si në thellimin e decentralizimit fiskal, ashtu edhe menaxhimin e financave publike në nivel vendor. Gjatë viteve të fundit, procesi i menaxhimit të financave publike vendore është shoqëruar me sfida për shkak të pasojave të pandemisë COVID-19, rindërtimit nga tërmetet e vitit 2019 dhe krizës ekonomike si rrjedhojë e luftës në Ukrainë. Përballimi i

këtyre sfidave të mëdha ekonomike dhe buxhetore nga njësitë e vetëqeverisjes vendore gjatë kësaj periudhe, është një tregues pozitiv i punës së zhvilluar në këto vite në drejtim të stabilitetit makroekonomik, parashikueshmërisë së fondeve dhe transparencës së përdorimit me disiplinë të fondeve buxhetore.

Pushteti vendor luan një rol të rëndësishëm si në cilësinë e shërbimeve duke qenë afër jetës së qytetarëve ashtu edhe si një aktor i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik të shoqërisë në tërësi. Fokusi në procesin e reformimit të funksionimit të pushtetit vendor, por gjithashtu edhe rritjes së kapacitetit fiskal të njësive të vetëqeverisjes vendore nëpërmjet mekanizmave të decentralizimit kanë rritur pritshmëritë e shoqërisë ndaj shërbimeve që ofrojnë njësitë e vetëqeverisjes vendore. Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka vendosur në objektivat e saj strategjike decentralizimin fiskal dhe modernizimin e menaxhimit të financave publike në nivel vendor. Disa prej arritjeve më të rëndësishme në proceset e menaxhimit të financave vendore janë:

- Rritja e mbështetjes së dhënë nga buxheti qendror për pushtetin vendor në formën e transfertave (transferta e pakushtëzuar dhe sektoriale).
- Ruajtja e qëndrueshmërisë së transfertës së pakushtëzuar pavarësisht problemeve të shkaktuara si pasojë e pandemisë COVID-19, tërmetit, krizës ekonomike e energjitike.
- Përmirësimi i menaxhimit të financave vendore përmes rritjes së peshës së taksave vendore në të ardhurat vendore.
- Shpërndarja e Tatimit mbi të Ardhurat Personale duke i dhënë mundësi financiare shtesë njësive të vetëqeverisjes vendore për të amortizuar vështirësitë dhe rritur efektshmërinë e shërbimeve.
- Reforma e iniciuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë në taksën e pasurisë është pasqyruar në rritjen e të ardhurave të pushtetit vendor nga kjo taksë.
- Konsolidimi i procedurave dhe sistemi i menaxhimit të financave vendore në të gjithë etapat, që nga hartimi i programit buxhetor afatmesëm tek zbatimi dhe monitorimi i tij; harmonizimi dhe unifikimi i procedurave për hartimin, zbatimin, raportimin, monitorimin e buxheteve të njësive të vetëqeverisjes vendore, në përputhje me standardet ndërkombëtare;
- Zbatimi i metodologjisë për hartimin e programit buxhetor afatmesëm në nivel produkti buxhetor, përmes formateve të reja;
- Prezantimi dhe përdorimi i treguesve të performancës në PBA dhe ndikimi pozitiv në rritjen e cilësisë së monitorimit të zbatimit të buxhetit vendor;
- Ulja e numrit të programeve buxhetore (nga 36 programe në 20 programe buxhetore) dhe fillimi i një faze të re pilotimi për hartimin e Programit Buxhetor Afatmesëm në tre bashki.
- Monitorimi i vazhdueshëm i treguesve fiskalë të zbatimit të buxhetit, në funksion të zbatimit të politikave buxhetore që do të rrisin efikasitetin dhe efektshmërinë e përdorimit të fondeve publike në nivel vendor;
- Përgatitja dhe publikimi periodik dhe vjetor i raportit të analizës së financave publike vendore;
- Hartimi i raporteve periodike të menaxhimit të vështirësive financiare, si një detyrim ligjor për të monitoruar situatën financiare të njësive të vetëqeverisjes vendore; publikimi i raportit vjetor: “Mbi statusin e vështirësive financiare të njësive të vetëqeverisjes vendore”;
- Asistenca e drejtpërdrejtë ndaj njësive të vetëqeverisjes vendore, në të gjitha hapat e menaxhimit financiar në nivel vendor përmes komenteve dhe konsultimit jo vetëm të hartimit të programit buxhetor afatmesëm, por edhe të raportit të monitorimit të zbatimit të buxhetit;

- Realizimi i trajnimeve, takimeve dhe konsultimeve të vazhdueshme me njësitë e vetëqeverisjes vendore në kuadër të masave të marra nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë për menaxhimin financiar në nivel vendor, si një hap parapërgatitor për zbatimin e sistemit AFMIS në nivel vendor në një periudhë afatmesme.

Të gjitha arritjet e mësipërme në drejtim të qeverisjes vendore, janë një tregues i rëndësishëm për rritjen e autonomisë financiare të njësive të vetëqeverisjes vendore dhe për rrjedhojë rritjen e cilësisë së shërbimeve të ofruara për qytetarët. Përballimi i një sfide të madhe ekonomike dhe buxhetore nga njësitë e vetëqeverisjes vendore gjatë vitit 2022, është një tregues pozitiv i punës së zhvilluar në këto vite në drejtim të stabilitetit makroekonomik, parashikueshmërisë së fondeve dhe transparencës së përdorimit me disiplinë të fondeve buxhetore.

Në funksion të reformimit dhe modernizimit të financave publike dhe kryesisht atyre vendore, në strategjinë e Menaxhimit të Financave Publike është parashikuar që në vitet e ardhshme në sistemin IPSIS të përfshihen dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore. Po ashtu strategjia e MFP-së parashikon që edhe AFMIS-i të jetë i zgjeruar dhe në njësitë e vetëqeverisjes vendore. Këto sisteme (IPSI dhe AFMIS) që parashikohet të jenë funksionale në vitet e ardhshme do të jenë një vlerë e shtuar e Menaxhimit Financiar Publik në nivel vendor. Ato do të unifikojnë të gjithë punën dhe operacionet financiare në të gjitha fazat dhe ciklet e menaxhimit financiar, do të mundësojnë një komunikim të efektshëm midis institucioneve dhe njësive qendrore me ato vendore dhe do të jenë një garanci më shumë për përdorimin e fondeve publike me efikasitet, ekonomi dhe efektshmëri.

OBJEKTIVAT E TREGUESVE TË FINANCAVE PUBLIKE VENDORE PËR VITIN 2023

Fokusi kryesor në buxhetin e vitit 2023 për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë do të jetë vazhdimi i konsolidimit të procesit të menaxhimit financiar në nivel vendor në funksion të vazhimit të zbatimit të procesit të decentralizimit fiskal të njësive të vetëqeverisjes vendore. Disa tregues të reformës së financave publike në nivel vendor me një efekt pozitiv në buxhetin e vitit 2023, pritet të jenë si më poshtë vijon:

- Buxheti vendor i vitit 2023, do të jetë **rreth 8.8 %** më i lartë se i plani i vitit 2022, dhe **11%** më i lartë se i pritshmi i vitit 2022. Krahasuar me periudhën para reformës administrativo – territoriale është **92.5%** më i lartë.
- Përmirësimi i menaxhimit të financave vendore përmes rritjes së peshës së taksave lokale në të ardhurat vendore. Të ardhurat e veta të pushtetit vendor nga viti 2015 në vitin 2023 kanë pësuar një rritje të ndjeshme me rreth **17.4 miliard lekë**, ndërkohë krahasuar me vitin 2022 janë rritur me rreth **1.5 miliard lekë**.
- Do të rritet mbështetja e dhënë nga buxheti qendror për pushtetin vendor në formën e transfertave ku më e rëndësishmja është rritja e transfertës së pakushtëzuar, e cila në krahasim me vitin 2022 është rritur në vlerën **3 miliard lekë**, dhe krahasuar me vitin 2015 është rritur nga **12.3 miliard lekë**, në **21.7 miliard lekë**, ose rreth **76.4 %** më shumë financim nga pushteti qendror.
- Transferta e pakushtëzuar për çdo bashki në vitin 2023, do të jetë me rritje mesatare në nivelin **18%** krahasuar me një vit më parë.
- Të ardhurat e bashkive nga taksat e ndara, krahasuar me vitin 2015, para reformës administrativo-territoriale, do të rriten me rreth **1 miliard lekë** për vitin 2023, duke përfshirë edhe shpërndarjen e tatimit mbi të ardhurat personale për njësitë e vetëqeverisjes vendore.

- Reforma e iniciuar nga Qeveria në taksën e pasurisë do të reflektohet në rritjen e të ardhurave të pushtetit vendor. Në buxhetin e vitit 2023 taksa e pasurisë është parashikuar në vlerën **6.9 miliard lekë** krahasuar me vitin 2022 me një rritje prej **800 milion lekë** dhe krahasuar me vitin 2015, **rreth 3 miliard** më shumë të ardhura për njësitë e vetëqeverisjes vendore.
- Rritja e pagave në buxhetin e vitit 2023 për funksionet: arsimit parashkollor, arsimit parauniversitar, shërbimi i mbrojtjes nga zjarri, administrimi i pyjeve, ujitja dhe kullimi, me një fond prej **340 milion lekë**.
- Vazhdimi i financimit të funksioneve të transferuara në pushtetin vendor në vitin 2016, në formën e transfertës së pakushtëzuar sektoriale në **vlerën 9.890 miliard lekë**.
- Në vijim të procesit efektiv të decentralizimit, vend të rëndësishëm zë vazhdimi dhe konsolidimi i reformës së financimit të arsimit parashkollor. Përmes buxhetit të vitit 2023, do të vazhdojë mbështetja financiare për reformën në arsimin parashkollor me synim konsolidimin e një skeme financimi të përshtatshme dhe efektive që synon përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimeve.

Në buxhetin e vitit 2023, fondet e pagave për edukatorët ndahen kryesisht mbi bazën e numrit të fëmijëve. Më specifikisht, 60% e fondeve për pagat e edukatorëve ndahen mbi bazën e numrit të fëmijëve (me moshë 3-6 vjeç) dhe 40% mbi bazën e numrit të edukatorëve.

Reforma për financimin e funksionit të arsimit parashkollor do të vazhdojë të sigurojë në vitin 2023:

- Uljen e madhësisë së grupeve/klasave të fëmijëve në kopshte nga raporti aktual mesatar 18 fëmijë për një edukatore në raportin 15 fëmijë për një edukatorë;
- Ruajtjen e nivelit aktual të fondeve për ato bashki të cilat rezultojnë të kenë një numër relativisht "të lartë" edukatorësh për numrin e fëmijëve të regjistruar në kopshte, krahasimisht me bashkitë e tjera;
- Një ndarje më të drejtë të fondeve për pagat e edukatorëve, duke zbutur diferencat ndërmjet bashkive përta i përket raportit fëmijë për edukatorë.

Kostoja e kësaj reforme është 327 milion lekë dhe mbulohet nga transferta e pakushtëzuar për bashkitë për vitin 2023, garanton vazhdimin e shërbimit të mbi 400 edukatorëve shtesë, me qëllim rritjen e cilësisë së shërbimit në kopshte. Kjo reformë, bën një ndarje më të drejtë të fondeve, zbut diferencat ndërmjet bashkive përta i përket raportit "fëmijë për edukatorë" dhe siguron fonde shtesë për ato bashki që kanë një nevojë imediate për rritjen e numrit të edukatorëve.

❖ **Transferta e pakushtëzuar 2023 dhe formula e shpërndarjes së saj**

Decentralizimi fiskal si një ndër shtyllat më të rëndësishme të menaxhimit financiar publik në nivel vendor duhet të shoqërohet me rritjen e të ardhurave nga burimet e veta të njësive të vetëqeverisjes vendore. Njësitë e vetëqeverisjes vendore në pëputhje më përcaktimet ligjore të ligjit për financat vendore përfitojnë të ardhura në formën e transfertave nga qeveria qendrore, ku një rol të rëndësishëm e zë transferta e pakushtëzuar.


Ndarja e transfertës së pakushtëzuar për vitin 2023, bazohet në një formulë të thjeshtë për t'u kuptuar dhe zbatuar të bazuar në kritere që garantojnë funksionimin normal të njësive të vetëqeverisjes vendore. Transferta e pakushtëzuar do t'u sigurojë njësive të vetëqeverisjes vendore mbulimin e diferencës mes

kostos së ushtrimit të funksioneve (nevojat për shpenzime) dhe të ardhurave që ato krijojnë në mënyrë të pavarur.

Për vitin 2023, transferta e pakushtëzuar përbëhet nga dy pjesë: a) pjesa e përgjithshme dhe b) pjesa sektoriale. Formula e shpërndarjes së transfertës garanton një sistem më të drejtë ekualizimi fiskal duke ndihmuar bashkitë me kapacitet më të ulët fiskal. Mekanizmi i shpërndarjes së transfertës është i përshtatur në funksion të reformës administrativo-territoriale. Ndarja e transfertës së pakushtëzuar bazohet plotësisht në formulë, pa përfshirë fondet për konviktet, shërbimet sociale, fondet e rrugëve rurale dhe rajonale. Gjithshtu, formula e shpërndarjes së transfertës së pakushtëzuar identifikon nevojat për shpenzime të bashkive duke u bazuar tek popullsia relative, dendësia e popullsisë (që reflekton diferencat në koston e ushtrimit të funksioneve ndërmjet bashkive) dhe tek numri faktik i nxënësve në shkollat 9-vjeçare dhe të mesme në çdo bashki. Përveç ekualizimit të kostove të shërbimeve që bëhet nëpërmjet komponentit të dendësisë, formula e ndarjes së transfertës së pakushtëzuar sjell edhe ekualizimin e kapacitetit fiskal (të matur nga të ardhurat faktike nga taksat e ndara ndërmjet qeverisë qendrore dhe asaj vendore), të cilat mbledhen dhe u transferohen plotësisht ose pjesërisht bashkive nga administrata tatimore qendrore. Ekualizimi fiskal bazohet në të ardhurat faktike nga tatimi mbi të ardhurat personale, nga taksa vjetore e automjeteve të përdorura dhe taksa e kalimit të pasurisë për pasuritë e paluajtshme të shitura nga personat juridik.

Transferta e pakushtëzuar për vitin 2023, krahasuar me vitin 2022 është **3 miliard lekë** më shumë osë rreth **16.1 përqind** më e lartë dhe krahasuar me vitin 2015 (viti para reformës administrativo-territoriale), është **9.4 miliardë lekë** më shumë ose rreth **76.4 përqind më e lartë** (siç paraqitet edhe në grafikun e mëposhtëm). Rritja e konsiderueshme e transfertës së pakushtëzuar, tregon rëndësinë që kjo qeveri gjatë këtyre viteve i ka kushtuar procesit të decentralizimit dhe efikasitetit të qeverisjes vendore.

Figura 1: Transferta e pakushtëzuar 2013-2023 (në mln lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022);

Në transfertën e pakushtëzuar të parashikuar për vitin 2023, **21.7 miliard lekë**, do të shtohen edhe fondet prej **9.890 miliard lekë** transfertë e pakushtëzuar sektoriale për funksionet e reja. Në total, në vitin 2023, granti nga buxheti i shtetit për pushtetin vendor do të jetë në shumën **31.5 miliard lekë**.

❖ Detyrimet e prapambetura të njësive të vetëqeverisjes vendore

Në kuadër të forcimit të disiplinës financiare për të parandaluar krijimin e detyrimeve të prapambetura, qeveria po i kushton një fokus të posaçëm shlyerjes së detyrimeve të prapambetura nga njësitë e vetëqeverisjes vendore. Ministria e Financave dhe Ekonomisë në bashkëpunim me njësitë e vetëqeverisjes vendore është duke zbatuar një plan veprimi për shlyerjen e detyrimeve. Stoku i këtyre detyrimeve,

përveçse dobëson kredibilitetin financiar të bashkive, ndikon negativisht në shëndetin financiar të ndërmarrjeve, operatorëve apo kontraktorëve të ndryshëm.

Ulja e detyrimeve të prapambetura dhe përmirësimi i gjendjes financiare të njësive të vetëqeverisjes vendore në periudhë afatgjatë është një ndër sfidat strategjike të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në drejtim të menaxhimit financiar në nivel vendor.


Stoku i detyrimeve të prapambetura në fund të muajit qershor 2022, i cili parashikohet të shlyhet në një periudhë afatmesme, bazuar në planin e shlyerjes së dërguar nga të gjitha bashkitë në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë është rreth **7.1 miliard lekë**. Vlera e stokut të detyrimeve të prapambetura është ulur me rreth **0.2 miliard lekë** krahasuar me stokun e detyrimit në fund të tremujorit të parë të vitit 2022, që ishte rreth **7.3 miliard lekë**. Ndërkohë, detyrimet e prapambetura për qeverisjen vendore në vitin 2016 kanë qenë në vlerën rreth **12.1 miliard lekë**, dhe krahasuar me 6-mujorin e parë të vitit 2022 janë ulur me rreth **5 miliard lekë** ose rreth **41 përqind**.

Gjatë vitit 2022, janë realizuar vlerësime dhe raportime periodike mbi ecurinë financiare të detyrimeve të prapambetura të njësive të vetëqeverisjes vendore. Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka përgatitur dhe publikuar raportin e gjendjes financiare për të 61 bashkitë, ku ka rezultuar se dhjetë bashki janë me probleme financiare dhe shtatë bashki me vështirësi financiare. Për këto bashki është hartuar një plan rehabilitimi për daljen nga situata e problemeve/vështirësisë financiare i cili do të vijojë të zbatohet edhe në buxhetin e vitit 2023. Mbështetur mbi treguesit fiskal janë dhënë gjithashtu rekomandime ndaj njësive të cilat kanë një ecuri jo pozitive në drejtim të rritjes së stokut të detyrimeve ndaj të tretëve. Ky proces monitorimi do të vazhdojë periodikisht edhe në vitin 2023, duke zbatuar me përpikmëri detyrimet ligjore dhe nënligjore mbi statusin e vështirësive financiare të njësive të vetëqeverisjes vendore.

❖ Treguesit Fiskal e Buxhetor të Pushtetit Vendor

Buxheti vendor i vitit 2023, parashikohet të jetë rreth 8.8 përqind më i lartë se plani i vitit 2022, ose në nivelin prej 3 përqind i Produktit të Brendshëm Bruto. Me buxhetin e vitit 2023, do të financohen funksionet e transferuara në pushtetin vendor, si dhe të gjitha funksionet e tjera të parashikuara në legjislacionin në fuqi, të cilat njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë për detyrë t'i ushtrojnë në shërbim të cilësisë së jetës së qytetarëve.

Figura 2: Buxheti Vendor 2022-P/Buxhet 2023




Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022);

Shpenzimet e buxhetit vendor për vitin 2023, janë parashikuar në masën **65,584 milion lekë** ose **3 përqind e PBB-së**. **Buxheti vendor për vitin 2023** krahasuar me buxhetin vendor 2022, parashikohet me një rritje me **rreth 5.2 miliard lekë**. Në këtë zë është përlogaritur transferta e pakushtëzuar e përgjithshme për njësitë e vetëqeverisjes vendore, financimi i funksioneve të reja, si dhe të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore.

Të ardhurat nga taksat vendore për vitin 2023, parashikohet të kenë një rritje rreth **1.5 miliard lekë** më shumë se sa plani i vitit 2022, ose e thënë ndryshe me një **rritje prej 6%**, ndërkohë krahasuar me vitin 2015 si viti para reformës administrative, të ardhurat vendore parashikohen me një rritje të konsiderueshme me rreth **17.4 miliardë lekë**. Kjo rritje e nivelit të të ardhurave do të vazhdojë si rrjedhojë e ndarjes më të drejtë dhe transparente të financave për njësitë e vetëqeverisjes vendore, përmirësimit të vazhdueshëm të skemës së financimit të funksioneve të veta si dhe rritjes së burimeve të financimit të njësite të vetëqeverisjes vendore. Gjithashtu, ndryshimet në taksën e pasurisë, parashikohet të ndikojnë në peshën e rritjes së të ardhurave në buxhetin vendor.

Tendenca e rritjes së buxhetit vendor do të vazhdojë edhe në buxhetin e vitit 2023 (grafiku 3), ku buxheti vendor parashikohet të jetë rreth 3 përqind e Produktit të Brendshëm Bruto.


Figura 3: Tendanca e buxhetit vendor 2015-P/Buxhet 2023



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022);

Rritja e të ardhurave të mbledhura nga njësitë e vetëqeverisjes vendore gjatë viteve 2015-2023, evidentohet edhe në rritjen e peshës që zënë këto të ardhura si ndaj të ardhurave totale të buxhetit të shtetit, ashtu edhe ndaj Produktit të Brendshëm Bruto, sikurse vihet re edhe në grafikun e mëposhtëm. Në përgjithësi, pesha e të ardhurave nga taksat vendore në të ardhurat totale publike është rritur, nga rreth 3.09% në vitin 2015 në 4.66% në vitin 2023. Kjo tregon përmirësimin e kapacitetit fiskal të njësite të vetëqeverisjes vendore në drejtim të mbledhjes së më shumë të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore.


Figura 4: Pesha specifike e të ardhurave të buxhetit vendor ndaj të ardhurave të buxhetit qendror dhe PBB-së



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022)

Rritja e shpenzimeve të realizuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, gjatë periudhës 2015-2023, konstatohet edhe në rritjen e peshës që zënë këto shpenzime si ndaj shpenzimeve buxhetore në total, ashtu edhe ndaj Produktit të Brendshëm Bruto. Pesa specifike e shpenzimeve të buxhetit vendor ndaj buxhetit të shtetit është rritur ndjeshëm në vitin 2023 (9.63 përqind), krahasuar me vitin 2015, ku shpenzimet e buxhetit vendor zinin vetëm 7.79 përqind të shpenzimeve të buxhetit shtetit. Ndërkohë, siç vihet re edhe nga grafiku i mëposhtëm, për vitet 2020-2023, pesha specifike e buxhetit vendor ndaj Produktit të Brendshëm Bruto është rritur ndjeshëm me rreth 1 përqind më shumë se pesha që zinte në vitin 2015.

Figura 5: Pesa specifike e shpenzimeve të buxhetit vendor ndaj shpenzimeve të buxhetit të shtetit dhe PBB-së



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022);

❖ Objektivat kryesore për buxhetin vendor të vitit 2023

Ministria e Financave dhe Ekonomisë në vitin 2023 do të vijojë me reformimin e financave publike vendore, duke u fokusuar në rritjen e investimeve, digjitalizimin e operacioneve të menaxhimit financiar në nivel vendor, rritjen e të ardhurave nga taksat vendore si dhe në reformimin e skemave të financimit të qeverisjes vendore në përputhje me performancën e tyre, duke mbështetur ato bashki që performojnë mirë dhe duke ekspozuar ato me performancë të dobët. Gjatë vitit 2023, synohet të ruhen ngushtësisht treguesit pozitiv të rritjes së rolit të pushtetit vendor në forcimin e kapacitetit fiskal por gjithashtu edhe në rëndësinë e shërbimeve publike. Ruajta e trendit pozitiv të ecurisë së konsolidimit financiar në nivel

vendor dhe zbatimi i plotë të njësitë e vetëqeverisjes vendore i të gjitha metodologjive të hartuara do të jetë fokusi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë do të vazhdojë me reformimin e taksës së pasurisë duke përfshirë këtu bërjen funksionale të kadastrës fiskale dhe njëkohësisht do të punohet për një sistem të unifikuar të mbledhjes dhe administrimit të taksave vendore.

Në vitet në vazhdim, do të implementohet sistemi AFMIS edhe për nivelin vendor duke ju ofruar njësive të vetëqeverisjes vendore digjitalizimin dhe automatizimin e shumicës së operacioneve financiare si, përgatitjen e PBA-së, zbatimin dhe monitorimin e buxhetit, integrimin e strategjive në buxhetim, menaxhimin e investimeve publike dhe menaxhimin e mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore.

Disa nga objektivat për vitin 2023 për buxhetin vendor paraqiten si më poshtë:

- Rritja e kapacitetit fiskal të njësive të vetëqeverisjes vendore

Rritja e të ardhurave të veta të njësive të vetëqeverisjes vendore, si tregues i kapacitetit fiskal është e rëndësishme për konsolidimin financiar të njësive të vetëqeverisjes vendore. Thellimi në analizën e kapacitetit sipas njësive të vetëqeverisjes vendore është thelbësor për t'u zhvilluar gjatë vitit 2023, me qëllim për të identifikuar kapacitetet e decentralizimit aktual fiskal dhe evidentimin e mundësive të reja në kuadër të këtij procesi. Rritja e burimeve të financimit të qeverisjes vendore me rreth 5.2 miliard lekë ose 8.8 % më shumë se sa plani i vitit 2022, është rritje e cila sigurohet nga transfertat e pakushtëzuar e përgjithshme dhe sektoriale dhe të ardhurat nga taksat e tarifatat vendore. Kjo rritje krijon hapësirat e nevojshme për përmirësimin e shërbimeve publike dhe fokusim më të madh në shpenzimet për investime.

Një ndër treguesit më të rëndësishëm të konsolidimit fiskal të njësive të vetëqeverisjes vendore do të jetë rritja e aftësive të tyre për të siguruar të ardhura nga burimet e veta dhe arkëtimin e tyre në mënyrë të qëndrueshme në kohë. Gjatë vitit 2022, pushteti vendor siguroi një rritje të rëndësishme të të ardhurave në raport me planin, tregues ky i kapacitetit në rritje të njësive për të siguruar qëndrueshmërinë e financimit të funksioneve. Taksa mbi pasurinë, është një burim i rëndësishëm i të ardhurave vendore përmes së cilit njësitet e vetëqeverisjes vendore mund të zhvillojnë politika vendore nën diskrecionin e plotë të përdorimit. Vitet e fundit në politikat qeveritare, hartimi i metodologjisë së vendosjes së kësaj takse në bazë vlere por dhe ndërtimi i një kadastrë të detajuar mbi pronën, përbëjnë thelbin e reformës mbi këtë burim financimi të njësive të vetëqeverisjes vendore. Ministria e Financave dhe Ekonomisë do të ndjekë me prioritet ruajtjen e qëndrueshmërisë së rritjes së të ardhurave vendore edhe në buxhetin e vitit 2023.

- Harmonizimi dhe unifikimi i procedurave për hartimin, zbatimin, raportimin, monitorimin e buxheteve të njësive të vetëqeverisjes vendore, konform standarteve ndërkombëtare;
- Konsolidimi fiskal dhe qëndrueshmëria e financave të pushtetit vendor gjatë vitit 2023, do të jenë tregues i rëndësishëm i forcimit të aftësisë së pushtetit vendor për ofrimin e shërbimeve publike.

Në këtë drejtim do të ruhet qëndrueshmëria e transfertës së pakushtëzuar pavarësisht problemeve të shkaktuara si pasojë e krizës ekonomike e cila goditi ekonominë e vendeve të zhvilluara dhe rajonin, si dhe krizës energjitike si rrjedhojë e luftës në Ukrainë.

- Ruajtja e standardeve ligjore për buxhetimin mbi bazë produkti, programi dhe funksioni në të gjitha njësitë vetëqeverisjes vendore;

Gjatë vitit 2023, njësitë e vetëqeverisjes vendore, do të konsolidojnë ecurinë e përdorimit të standartit të unifikimit të shpenzimeve vendore, jo vetëm në nivel llogarie ekonomike por gjithashtu edhe produkti, programi e funksioni. Buxheti në nivel produkti, është një ndër objektivat e rëndësishme përmes së cilit synohet që njësitë e vetëqeverisjes vendore të kostojnë produktet e shërbimeve që ofrojnë për qytetarët. Gjatë vitit 2023 do të monitorohet pilotimi i tre bashkive në përgatitjen e buxhetit me një numër të reduktuar programesh dhe detajimin deri në nivel produkti. Ministria e Financave dhe Ekonomisë do të vijojë punën për të konsoliduar buxhetimin në nivel produkti tek të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore. Përfundimi i këtij procesi do të përmbyll një etapë të rëndësishme në rrugën drejt unifikimit në AFMIS të të gjithë njësive të vetëqeverisjes vendore.

- Zhvillimi ekonomik lokal dhe ulja e pabarazive midis njësive të vetëqeverisjes vendore.

Përmes politikave të reja të menaxhimit financiar, do të synohet ulja e diferencave dhe sigurimi i një financimi të qëndrueshëm në nivel vendor. Pushteti vendor si pjesë e rëndësishme e zhvillimit ekonomik kombëtar ka në thelb nxitjen e politikave të zhvillimit rajonal. Instrumentet financiarë të vetëqeverisjes vendore do të të orientohen në funksion të zhvillimit ekonomik dhe uljen e pabarazive midis njësive në funksion të zhvillimit kombëtar.

- Implementimi i AFMIS në nivel vendor.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë do të nisë një proces të rëndësishëm të shtrirjes së Albanian Financial Management Information System (AFMIS) në nivel vendor. Nga ky proces do të synohet përfshirja e të gjitha njësive të vetëqeverisjes vendore në sistemin e menaxhimit financiar, përmes së cilit do të unifikohet procesi i planifikimit, zbatimit dhe monitorimit të buxhetit në nivel vendor.

- Rritja e transparencës dhe llogaridhënies së qeverisjes vendore në raport me komunitetin;

Një sfidë e rëndësishme për t'u thelluar në qeverisjen vendore mbetet rritja e transparencës dhe llogaridhënies përmes pjesëmarrjes qytetare në proceset e përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm dhe buxhetit vjetor. Në këto kushte, gjatë vitit 2023 Ministria e Financave dhe Ekonomisë do të synojë nxitjen e njësive të vetëqeverisjes vendore në ndërmarrjen e masave të nevojshme për përmirësimin e transparencës përmes publikimit dhe hartimit të buxhetit të qytetarit.

- Forcimi i rregullave dhe procedurave për menaxhimin e financave publike në nivel vendor duke siguruar më shumë disiplinë fiskale në menaxhimin e vështirësive financiare;

Miratimi i Ligjit nr. 68, datë 27.04.2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore” i dha frymë procesit të krjimit të rregullave dhe procedurave për menaxhimin financiar publik në nivel vendor dhe menaxhimit të vështirësive financiare. Gjatë vitit 2023, Ministria e Financave dhe Ekonomisë në mënyrë të vazhdueshme do të ndjekë e monitorojë procesin e menaxhimit financiar në nivel vendor dhe përmes tij vlerësimin e treguesve të performacës së njësive të vetëqeverisjes vendore. Në këtë drejtim, do të përgatiten raporte periodike në funksion të transparencës, përgjegjshmërisë dhe pjesëmarrjes së të gjitha grupeve të interesit në procesin e administrimit financiar vendor. Gjithashtu, do të monitorohet periodikisht nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë plani i shlyerjes së detyrimeve/rehabilitimit për bashkitë me probleme/vështirësi financiare për daljen nga kjo situatë, i cili do të vijojë të zbatohet edhe në buxhetin e vitit 2023.

6. POLITIKAT E TAKSAVE PËR VITIN 2023

6.1 PAKETA E RE FISKALE

Efektet e politikave fiskale

- Ministria e Financave dhe Ekonomisë, paralelisht me Buxhetin 2023, ka paraqitur edhe paketën fiskale me ndryshimet në ligjet tatimore, të cilat mbështesin realizimin e këtij buxheti, si në drejtim të rritjes së të ardhurave, ashtu edhe në drejtim të përmirësimit të procedurave me qëllim reduktimin e shmangieve dhe evazionit.
- Risia kryesore e kësaj pakete fiskale janë Ligji i ri “Për tatimin mbi të ardhurat”, Ligji “Për tatimin e jashtëzakonshëm në sektorin energjitik” si dhe rifutja në legjislacion e basteve sportive online. Njëkohësisht janë paraqitur edhe ndryshime të tjera më pak të rëndësishme në fushën e akcizave, taksave nacionale dhe procedurave tatimore.

- **Në tatimin mbi të ardhurat**

Projektligji i ri i cili ka synuar përmirësimin e sistemit të taksimit të individëve dhe entiteteve ligjore në Shqipëri, forcimin e parimit të neutralitetit në sistemin tatimor shqiptar, përafrimin gradual të sistemit të tatimit të të ardhurave në Shqipëri, me parimet e Direktivave të BE-së në lidhje me tatimin e të ardhurave dhe kapitalit, adresimin e mangësive dhe boshllëqeve legjislative të konstatuara gjatë periudhës 22 vjeçare të aplikimit të ligjit ekzistues duke synuar dizenjimin e një sistemi tatimi më të drejtë dhe stimulues, më të ndershëm dhe të gjithëpranuar.

Në kuadrin e këtij ligji kemi ndryshimet dhe efektet e mëposhtme:

- Rritja e kufirit të patatueshën të pagës nga 40 mijë lekë në 50 mijë lekë do reduktojë të ardhurat në buxhet për rreth 1 miliardë lekë në vit, por ndërkohë do rrisë të ardhurat e punëmarrësve me paga deri në 50 mijë lekë në muaj, ç’ka do të thotë më shumë konsum. Nga kjo masë përfitojnë mbi 70 mijë punëmarrës të cilët janë në grupin e pagave nga 40 në 50 mijë lekë në muaj.
- Futja në skemën e taksimit të të ardhurave personale të furnizuesve të shërbimeve si profesione të lira, vlerësohet të kontribuojë në buxhetin e shtetit me 2 miliardë lekë në vit.

- Nga rrija e pagave të administratës shtetërore vlerësohet që të rriten të ardhurat nga tatimi mbi pagat për 700 milionë lekë

- **Në akcizë**

Ndryshimet në akcizë synojnë që procesi i përafrimit të legjislacionit të vendit tonë me atë të BE-së dhe transpozimi i Direktivave përkatëse, në rastin konkret i Direktives së tatimeve indirekte të akcizave, të bëhet gradual, duke lejuar industrinë e prodhimit në vend të mallrave të akcizës që të jetë konkurrese me produktet e importuara. Njëkohësisht, projekligji ka synuar edhe reduktimin e mëtejshëm të hapsirave për shmangien nga pagesa e akcizës si dhe masa që do bëjnë të mundur dekurajimin e importeve ilegale me mallrat e akcizës.

Më konkretisht, në akciza janë dizenuar ndryshimet dhe efektet e mëposhtme:

Heqjen e akcizës për akumulatorët e automjeteve elektrike me efekt -50 milionë lekë. Ministria e Financave dhe Ekonomisë në kuadër të zbatimit të strategjisë për kursimin e energjisë si dhe subvencionimit të çmimit të paneleve diellore, ka propozuar heqjen e akcizës për akumulatorët për panelet diellore dhe makinerit e elektrike. Me hyrjen në përdorim të makinave elektrike që burimin e tyre të energjisë kanë akumulatorët, është e nevojshme të rishikohet akciza për këtë produkt ndërkohë që e gjithë makina elektrike jo vetëm që nuk ka akcizë, por ka edhe 0% TVSH në momentin e importit. Një masë stimulimi të përdorimit të makinave me akumulatorë është marë tashmë në të gjithë europën, si pjesë e politikave të mbrojtjes së mjedisit.

Ndryshime në akcizen e birrës me efekt 52 milionë lekë lekë në vit. Ndryshimi i akcizës së këtij artikulli, konsiston në unifikimin gradual në një afat 5 vjeçar të tarifës së akcizës për Birrën e bërë nga malto nga prodhues vendas e të huaj, ligjërisht dhe ekonomikisht të pavarur, me sasi më të vogël dhe më të mëdha se 200 000 HL në vit. Për kategorinë Birrë e bërë nga malto nga prodhues vendas e të huaj, ligjërisht dhe ekonomikisht të pavarur, me sasi më të vogël 200 000 HL, rritet akciza gradualisht për 5 vite dhe që vitin e pestë (2027) barazohet me nivelin e akcizës 710 lekë/HL/shkallë alkoolometrike sikurse kategoria e Birrës së bërë nga malto nga prodhues vendas e të huaj, me sasi më të madhe se 200 000 HL. Është menduar të propozohet një kalendar rritje akcize për këtë produkt në mënyrë graduale në mënyrë që mos të rëndohet prodhuesi vendas dhe të ketë mundësin për tu përgatitur në lidhje me këto ndryshime të parashikuara.

Ndryshime në akcizën e verës me efekt vjetor 150 milionë lekë. unifikimin e tarifës së akcizës, për të dy nivelet e prodhimit nën dhe mbi 10 000 HL dhe duke diferencuar tarifën vetëm ba Unifikohet në shkallë alkoolike. Ndryshimi bëhet pasi norma e diferencuar e nivelit të akcizës specifike për produktet alkoolike të importuara ose prodhuara nga prodhuesit e vegjël duhet të eliminohen, dhe të gjitha akcizat duhet të vendosen në nivelin e rregullt, si për birrën ashtu edhe për verën, kjo pasi akciza e verës për prodhuesit e vegjël është rreth një e treta e normës së rregullt të akcizës.

Nga unifikimi i akcizës së gazit të lëngshëm, për të cilin efekti në vitin 2022 ishte 6 mujor ndërsa në vitin 2023 do jetë 12 mujor, do gjenerohen 400 milionë lekë më shumë.

- **Në lojrat e fatit**

Nga miratimi në ligj i lojrave të fatit ‘baste sportive’, me efekt nga 1 janari 2023, vlerësohet të arkëtohen në buxhetin e shtetit 2 miliardë lekë.

- **Në kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore**

Nga rritja e pagës minimale në shtator 2022 nga 32 në 34 mijë lekë, në vitin 2023 pritet të gjenerohen 1 miliardë lekë shtesë të ardhura krahasuar me vitin 2022.

Nga rritja e fondit të pagave për administratën shtetërore që është bërë në shtator 2022, në vitin 2023 pritet të gjenerohen 1,8 miliardë lekë kontribute shtesë.

- **Taksa speciale për prodhuesit e energjisë elektrike që e eksportojnë**

Fitimet e realizuara nga prodhuesit e energjisë elektrike, të cilët, për shkak të cmimeve shumëfish të rritura gjatë vitit 2022, kanë realizuar fitime pa rritje kostosh, do tatonen për këto fitime shtesë me tarifën 33 %. Të ardhurat e pritshme vlerësohen të jenë 8.3 miliardë lekë.

6.2 PËRJASHTIMET NGA TAKSAT (“TAX EXPENDITURES”)

Shpenzimet tatimore, apo “tax expenditures” konsiderohen humbje nga të ardhurat fiskale të parashikuara në legjislacionin fiskal në fuqi, si rezultat i lehtësirave fiskale ose normave preferenciale të vendosura për kategori të caktuara tatimpaguesish ose aktiviteteve. “Shpenzimet tatimore” janë vlerësuar duke përdorur një metodologji të re bazuar mbi disa modele për vlerësimin e shpenzimeve tatimore sipas llojit të tatimeve. Analiza e përjashtimeve ligjore dhe përcaktimi i benchmark-ut (përjashtime që janë normë në të gjithë vendet) u krye me asistencë të Bankës Botërore.

Për vlerësimin dhe matjen e “përjashtimeve nga taksat” janë marrë në konsideratë tatimet dhe taksat e mëposhtme:

- Tatimi mbi vlerën e shtuar, përkatësisht në Ligjin nr. 92/2014 “Për Tatimin mbi vlerën e shtuar” në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar.
- Tatimi mbi të ardhurat, përkatësisht në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, "Për Tatimin mbi të Ardhurat", i ndryshuar.
- Akciza, përkatësisht në Ligjin nr. 61/2012 “Për Akcizën në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Duke marrë në konsideratë indeksin zinxhir të rritjes reale ekonomike, si dhe efektet e veçanta që prodhohen si pasojë e ndryshimeve në politikat fiskale, përcaktohet vlera totale paraprake e shpenzimeve tatimore për zërat e mëposhtëm:

- Shpenzime Tatimore nga Tatimi mbi Vlerën e Shtuar
- Shpenzime Tatimore nga Akciza
- Shpenzime Tatimore nga Tatimi mbi Fitimin.

Duhet theksuar se pjesën më të madhe të vlerës së shpenzimeve tatimore e zënë ato shpenzime të cilat rrjedhin si efekt i përjashtimeve nga secili prej tatimeve të mësipërme. Pjesën dërrmuese të totalit të shpenzimeve tatimore e zë shpenzimi tatimor që vjen prej TVSH, dhe diferenca e mbetur si shpenzim tatimor nga Akciza dhe Tatimi mbi Fitimin.

Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (TVSH)

Shpenzimet tatimore që vijnë nga TVSH, llogariten sipas metodologjisë së re, duke shfrytëzuar tabelat e Burim – Përdorimeve që prodhohen prej INSTAT. Duke nxjerrë për secilën nga 35 llojet e aktiviteteve (të ndara sipas kodeve dy dhe katërshifrore NACE) pjesën e aktivitetit që tatóhet me normën standarde, normën e reduktuar dhe përjashtimin, arrihet të vlerësohet sesa janë shpenzimet tatimore prej TVSH-së.

Akciza

Shpenzimet tatimore prej akcizës, llogariten duke bërë deiferencat në normat më të larta për çdo kategori mallrash të akcizueshëm me normat reale që janë akcizuar, pasi për disa kategori mallrash nën regjimin e akcizës, ekzistojnë disa norma akcize (për verën, birrën, etj).

Shpenzimet tatimore = (Norma më e lartë e përcaktuar me ligj – Normën efektive) * Sasinë e hedhur në konsum

Tatimi mbi Fitimin

Shpenzimet tatimore që vijnë nga Tatimi mbi Fitimin, llogariten me supozimin që në vitin 2020 tatimpaguesit të mos paguajnë 5% por 15% mbi fitimin e tatueshëm, të gjithë subjektet me xhiro vjetore nën 8 milionë lekë.

Sipas raportit përfundimtar për Shpenzimet Tatimore, të publikuar në faqen zyrtare të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, për vitin 2019 dhe 2020 shpenzimet tatimore janë si më poshtë:

Tabela 9

(në milionë lekë)

| Lloji i Tatimit | Viti 2019 | | Viti 2020 | |
|---------------------------------------|-------------------|-------------|-------------------|-------------|
| | Shpenzimi Tatimor | % e PBB | Shpenzimi Tatimor | % e PBB |
| TVSH | 80.9 | 4.78 | 83.20 | 5.15 |
| Akciza | 0.95 | 0.06 | 1.08 | 0.07 |
| TF + TTHF (CIT) | 2.55 | 0.15 | 2.52 | 0.16 |
| TOTALI | 84.40 | 4.99 | 86.80 | 5.37 |
| PBB Nominal sipas Kuadrit Makrofiskal | 1,691,727 | | 1,617,541 | |

(Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë, 2022)

7. RREZIQET FISKALE DHE MASAT MBROJTËSE

Risqet në krahun e të ardhurave

- *Mosarritja e objektivit të rritjes ekonomike*

Të ardhurat e buxhetit, pa përfshirë paketën fiskale, janë programuar të rriten 5%, ndërkohë që rritja ekonomike reale në vitin 2023 pitet të jetë 2.6%

- *Devijimet në ulje nga projeksionet e nivelit të inflacionit të projektuar*

TVSH si tatim indirekt ad valorem ndikohet nga indeksi i rritjes së çmimeve, i cili është projektuar 3.6%. Nëse nuk realizohet, do tëndikojë në mosrealizimin e shtesës së të ardhurave nga ky faktor.

- *Ndryshimet e paparashikuara në kurset e këmbimit të lekut me monedhat e tjera*

Ulja e kursit të këmbimit të monedhave Euro apo USD krahasuar me projeksionin, ndikon në uljen e vlerës së mallrave tek importet, për rrjedhojë edhe TVSH-në mbi këto mallra.

- *Çmimet ndërkombëtare të mallrave, sidomos çmimet e produkteve energjitike, që mund të impaktojnë rënien e konsumit*

Luhatjet në çmimet ndërkombëtare të produkteve energjitike me ndikim në të hyrat e buxhetit.

- *Mosmiratimi i ndonjë elementi të paketës fiskale mbi bazën e së cilës është ndërtuar buxheti 2023*

Mosmiratimi i ndonjë mase të propozuar do të ulë të ardhurat në atë masë që nuk miratohet.

Risku i normave të interesit

Gjatë viteve të fundit, deri në fund të vitit 2021, ekspozimi ndaj riskut të normave të interesit ka ardhur duke u zbutur, kryesisht për shkak të rikompozimit të portofolit të borxhit të brendshëm në drejtim të titujve afatgjatë me norma interesi fikse, si edhe bazuar në normat e interesit në nivele të ulëta në tregun e brendshëm dhe të të huaj. Megjithatë, duke nisur nga viti 2022 risku i normave të interesit vazhdon të jetë i konsiderueshëm, duke marrë parasysh nivelin e lartë të borxhit afatshkurtër, si edhe pritshmëritë për rritje të normave të interesit në tregje pas situatës së krijuar nga konflikti Rusi-Ukrainë. Rritja afatgjatë e normave të interesit të tregut referencë do të përfaqësonte një kërcënim të rëndësishëm për qëndrueshmërinë fiskale dhe rrjedhimisht do të gjeneronte një rritje të ndjeshme të borxhit. Në periudhën afatshkurtër, ky kërcënim është zbutur nga struktura ekzistuese e normave të interesit, në të cilën më shumë se 90% e stokut të borxhit të brendshëm përbëhet nga instrumente me normë interesi fikse. Në këtë aspekt, përveç masave për reduktimin e peshës së titujve afatshkurtër, do të vijojë të mbahet nën kontroll pesha e titujve me norma interesi të ndryshueshme, në linjë me hapësirat e tregut dhe preferencat e investitorëve. Impakti në buxhet nga luhatjet e normave të interesit mund të jetë nga i nivelit të ulët në periudhën afatshkurtër deri në i nivelit mesatar në periudhën afatmesme.

Projeksionet në lidhje me shpenzimet e interesave në buxhetin e vitit 2023 vlerësohen të jenë realiste, bazuar në zhvillimet më të fundit të tregjeve. Megjithatë, duke filluar nga viti 2017 në zbatim të detyrimit ligjor të përcaktuar në Ligjin Organik të Buxhetit, në buxhetin e shtetit janë programuar kontigjenca të veçanta për të absorbuar e rritjen e shërbimit të borxhit që mund të burojë nga rritja e normave të interesit përtej pritshmërive. Në këtë drejtim, në buxhetin e vitit 2023 janë parashikuar 4.9 miliardë lekë kontigjenca, një nivel ky i mjaftueshëm për të përballuar rritje përtej atyre të parashikuara nga ana jonë si skenar më i mundshëm, i normave të interesit përgjatë vitit 2023 dhe pjesës së mbetur të vitit 2022.

Koncesionet dhe PPP-të

Ministria e Financave dhe Ekonomisë vlerëson dhe miraton paraprakisht të gjitha projektet koncesionare dhe të partneritetit publik privat (PPP), si edhe çdo ndryshim të tyre, nga pikëpamja e implikimeve individuale apo në grup, për shpenzimet buxhetore, deficitin buxhetor, qëndrueshmërinë e borxhit publik dhe detyrimet kontingjente eventuale. Shuma e përgjithshme e pagesave vjetore neto, që kryhen nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme, të cilat rezultojnë nga kontrata koncesionare apo partneriteti publik privat (PPP), si rregull, nuk duhet të tejkalojnë kufirin prej 5 për qind të të ardhurave tatimore faktike të vitit paraardhës buxhetor. Në rast tejkalimi të këtij kufiri, Këshilli i Ministrave merr masa korrektuese në krahun e të ardhurave buxhetore, të nevojshme dhe të mjaftueshme, për t'u rikthyer brenda kufirit të lejuar, gjatë dy viteve të ardhshme buxhetore.

Aktualisht, janë aktive 11 kontrata koncesionare apo partneriteti publik privat (PPP) sipas Tabelës 10 të mëposhtme:

Tabela 10: Koncesionet/PPP aktive me mbështetje financiare nga buxheti i shtetit

| Autoriteti Kontraktor | Nr. | Emertimi i Kontrates PPP | Viti i fillimit | Viti i perfundimit | Programi | Lloji i shpenzimit | në mijë Lekë | | | | | | |
|--|-----|--|-----------------|--------------------|----------|--------------------|-------------------|------------------|-------------------|---------------------|---------------------|---------------------|---------------------|
| | | | | | | | 2019 Fakt | 2020 Fakt | 2021 Fakt | 2022 I rishikuar | 2023 Parashikimi | 2024 Parashikimi | 2025 Parashikimi |
| Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë | | Ndërtimi, operimi dhe transferimi e inceneratorit për përpunimin e mbetjeve urbane të Bashkisë së Elbasanit | 2015 | 2021 | 06220 | Investime | 581,936 | 582,720 | 40,292 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | | Ndërtimi, operimi dhe transferimi e inceneratorit për përpunimin e mbetjeve urbane të Bashkisë Fier | 2016 | 2022 | 06220 | Investime | 752,770 | 752,770 | 690,040 | 376,400 | 0 | 0 | 0 |
| | | Ndërtimi, Operimi dhe Transferimi (BOT) HEC mbi lumin Devoll, rimbursimi i ndërtimit të rugëve zëvendësuese | 2015 | 2019 | 04320 | Investime | 1,505,822 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | 1 | Ndërtimi dhe Operimi i Rrugës së Arbrit | 2018 | 2030 | 04520 | Investime | 3,910,860 | 2,691,055 | 3,392,727 | 2,940,000 | 2,918,500 | 3,504,000 | 3,360,000 |
| | 2 | Ndërtim, Operim dhe Mirëmbajtje e Rrugës Millot-Morinë | 2017 | 2047 | 04520 | Investime | 570,643 | 811,734 | 790,027 | 743,000 | 761,700 | 735,000 | 735,000 |
| Ministria e Financave dhe Ekonomisë | 3 | Ndërtimi dhe Operimi i Porti Jahteve Oriku - Dukat | 2018 | 2030 | 04520 | Investime | 0 | 0 | 47,069 | 312,000 | 911,000 | 998,670 | 926,000 |
| | 4 | Ndërtimi dhe Mirëmbajtja e Portit të Integruar të Triportit Vlore | 2023 | 2032 | 04520 | Investime | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | 1 | Shërbimi i Skanimit në Dogana | 2013 | 2030 | 01150 | Korrente | 1,509,659 | 1,140,893 | 1,660,686 | 1,725,708 | 1,670,146 | 1,720,249 | 1,771,857 |
| | 1 | Konçesioni/PPP Kontrolli baze i popullsisë 35-70 vjeç (check up) | 2015 | 2025 | 07220 | Korrente | 876,083 | 322,322 | 219,021 | 876,090 | 876,090 | 876,090 | 876,090 |
| Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale | 2 | Konçesioni/PPP (Ofrimi i setit të personalizuar të instrumenteve kirurgjikale, material mjekësor steril njëpërdorimësh në sallat kirurgjikale, trajtimi i mbetjeve biologjike dhe dezinfektimi i sallave kirurgjikale) | 2016 | 2026 | 07330 | Korrente | 2,163,282 | 1,288,269 | 1,500,924 | 1,700,000 | 1,750,000 | 1,770,000 | 1,790,000 |
| | 3 | Konçesioni/PPP (Ofrimi i shërbimit të dializës në 5 spitale rajonale) | 2016 | 2026 | 07330 | Korrente | 804,388 | 733,203 | 747,195 | 835,000 | 875,000 | 915,000 | 955,000 |
| | 4 | Ofrimi i Shërbimeve laboratorike spitalore | 2020 | 2030 | 07330 | Korrente | 0 | 30,670 | 1,103,199 | 1,574,900 | 1,700,000 | 1,750,000 | 1,850,000 |
| Bashkia Tiranë / Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë | 1 | Për përmirësimin e infrastrukturës arsimore në Bashkinë Tiranë | 2017 | 2025 | 09120 | Investime | 0 | 0 | 0 | 685,325 | 763,086 | 1,485,611 | 1,427,413 |
| Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë / Bashkia Tiranë | 1 | Per ndërtimin e landfillit, inceneratorit dhe rehabilitimin e venddepozimeve ekzistuese Tiranë dhe prodhimin e energjisë elektrike | 2018 | 2048 | 06220 | Korrente | 977,125 | 1,280,000 | 1,249,399 | 1,246,762 | 1,270,935 | 1,366,200 | 1,366,200 |
| | 11 | TOTALI | | | | | 13,652,568 | 9,633,636 | 11,440,579 | 13,015,185 | 13,496,457 | 15,120,820 | 15,057,560 |
| | | Totali i te Ardhurave Tatimore per periudhen 2019-2025 | | | | | 426,270,680 | 398,658,000 | 475,611,880 | 544,187,400 | 587,853,000 | 609,435,289 | 640,674,200 |
| | | Respektimi i Rregullit Fiskal (perpjesa e pagesave te PPP ndaj totalit te te ardhurave tatimore te vitit paraardhes buxhetor me pak se 5%) | | | | | 3.3% | 2.3% | 2.9% | 2.7% | 2.5% | 2.6% | 2.5% |

Për sa i përket respektimit të nenit 4/2 të ligjit nr.9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor ku përcaktohet se "...shuma e përgjithshme e pagesave vjetore neto, që kryhen nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme, të cilat rezultojnë nga kontrata koncesionare apo partneriteti publik privat (PPP), si rregull, nuk duhet të tejkalojnë kufirin prej 5 për qind të të ardhurave tatimore faktike të vitit paraardhës buxhetor.", për vitin 2023 vërehet se:

- Për vitin 2023, kufiri i lejuar i pagesave neto për kontratat koncesionare/PPP, prej 5% i të ardhurave tatimore të pritshme të vitit 2022, është rreth 27.2 miliardë LEK.
- Referuar Tabelës 10, për vitin 2023 pagesat vjetore neto që parashikohen të kryhen nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme për kontratat koncesionare apo PPP, kapin vlerën rreth 13.5 miliardë LEK.
- Rrjedhimisht, në buxhetin 2023 respektohet kufizimi ligjor i sipërcituar në zbatim të rregullit fiskal respektiv, pasi vlera e parashikuar prej rreth 13.5 miliardë LEK për pagesat vjetore neto të

kontratave koncesionare apo PPP për vitin 2023, përbën vetëm 2.5 përqind të totalit të të ardhurave tatimore faktike të pritshme për vitin 2022, prej rreth 544.2 miliardë LEK.

Gjatë vitit 2022, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka vijuar monitorimin e performancës së kontratave koncesionare/PPP-ve me mbështetje buxhetore, duke monitoruar ecurinë e pagesave faktike buxhetore dhe treguesit e performancës të planifikuar/realizuar për secilën kontratë koncesionare/PPP. Monitorimi dhe raportimi mbi kontratat koncesionare/PPP është institucionalizuar përmes përfshirjes në udhëzimin plotësues nr.1, datë 10.01.2022 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2022”, të skedulit të detyrueshëm kohor të raportimit të tyre nga çdo Autoritet Kontraktor dhe të formateve standarde respektive, me qëllim thellimin e analizës dhe rritjen e transparencës. Ky monitorim është kryer në bazë të rregullt mujore.

Përsa i përket ecurisë faktike të pagesave koncesionare, për periudhën **Janar-Gusht 2022**, në vijim jepet një tablo përmbledhëse:

- Fondet buxhetore të planifikuara për vitin 2022, sipas planit të ndryshuar, me destinacion mbështetjen buxhetore për kontratat koncesionare/PPP, rezultojnë në total rreth 12.1 miliard LEK. Nga këto, rreth 4.77 miliard LEK investime dhe rreth 7.3 miliard LEK shpenzime korente.
- Krahasuar me pagesat faktike të vitit 2021 të cilat arritën vlerën rreth 11.52 miliard LEK, pagesat e planifikuara për vitin 2022 janë rreth 5.2% më të larta ose rreth 596.7 milion LEK më shumë.
- Pagesat faktike për periudhën 8 mujore 2022 rezultojnë në masën rreth 6.88 miliard LEK ose 56.8% të pagesave të planifikuara, sipas planit vjetor të rishikuar për vitin 2022.
- Për periudhën 8 mujore, niveli më i lartë i pagesave është realizuar në muajin Korrik me rreth 1.32 miliard LEK, duke rezultuar 19.2% të pagesave faktike 8 mujore.
 - Pagesa më e lartë e realizuar në muajin Korrik është pagesa prej rreth 197.5 milion LEK për kontratën “Për Përmirësimin e Infrastrukturës Arsimore në Bashkinë e Tiranës”, për projektimin, financimin, ndërtimin, mobilimin, mirëmbajtjen, mbikqyrjen dhe kolaudimin e pesë objekteve arsimore në Zonën Tirana 1”, pagesë e cila përbën rreth 15 përqind të totalit të pagesave faktike të realizuara në muajin Korrik.
- Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, pagesat faktike 8 mujore rezultojnë rreth 609.5 milion LEK më të larta ose rreth 9.7% më shumë. Rritja e pagesave faktike ka ardhur si pasojë e pagesave më të larta të realizuara kryesisht për kontratat:
 - “Për ofrimin e shërbimeve laboratorike spitalore” ku pagesat faktike 8 mujore 2022 rezultojnë rreth 620 milion LEK më të larta se e njëjta periudhë e një viti më parë, pasi pagesat për këtë kontratë filluan në muajin Qershor 2021.
 - “Për paketën e shërbimeve të kontrollit mjekësor bazë (Check-up)” ku pagesat faktike 8 mujore 2022 rezultojnë rreth 584.06 milion LEK më të larta se e njëjta periudhë e një viti më parë. Kjo duke konsideruar faktin se, për vitin 2021, për shkak të situatës së pandemisë kjo kontratë u ndërpre përkohësisht dhe pagesat buxhetore rifilluan në muajin Nëntor 2021.
 - “Për Përmirësimin e Infrastrukturës Arsimore në Bashkinë e Tiranës ‘Për Projektimin, Financimin, Ndërtimin, Mobilimin, Mirëmbajtjen, Mbikqyrjen dhe Kolaudimin e pesë objekteve arsimore në Zonën Tirana 1” ku pagesat faktike 8 mujore 2022 rezultojnë në masën rreth 395.07 milion LEK. Pagesat për këtë kontratë kanë filluar në vitin 2022.

- “Financimi, ngritja dhe operimi i shërbimit të skanimit të konteinerve e automjeteve të tjera në Republikën e Shqipërisë” ku pagesat faktike 8 mujore 2022 rezultojnë rreth 213.6 milion LEK më të larta se e njëjta periudhë e një viti më parë (Rritja e planit të pagesave për vitin 2022 lidhet me procesin e rinegociimit të kësaj kontrate ndërmjet MFE dhe kompanisë konçesionare ‘S2 Albania’, fokusi i së cilit ishte lehtësimi i barrës buxhetore të vitit të vështirë 2020, përmes reduktimit të planit të pagesave për kontratën e Rapiscan, përmes shtyrjes së pagesave me këste, për periudhën 1 Janar-31 Dhjetor 2022).

Ndërkohë që, për disa kontrata koncesionare/PPP me mbështetje buxhetore, për periudhën 8 mujore të vitit 2022 ka pasur ulje të pagesave buxhetore krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë ku veçojmë kontratat:

- “Përmirësimi, Ndërtimi, Operimi dhe Mirëmbajtja e Rrugës së Arbrit” ku pagesat faktike 8 mujore 2022 rezultojnë 660 milion LEK më të ulëta se e njëjta periudhë e një viti më parë, gjithsesi në terma vjetor pritet një realizim i plotë i pagesave të planifikuara.
- Subvencioni i kontratës koncesionare "Për ndërtimin, përmirësimin, shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe rehabilitimin e autostradës Milot - Morinë", ku pagesat faktike 8 mujore 2022 rezultojnë rreth 357.7 milion LEK më të ulëta se e njëjta periudhë e një viti më parë, gjithsesi në terma vjetor pritet një realizim i plotë i pagesave të planifikuara.
- “Ndërtimi i Landfillit, inceneratorit dhe rehabilitimit të venddepozitimeve ekzistuese Tiranë dhe prodhimin e energjisë elektrike" ku pagesat faktike 8 mujore 2022 rezultojnë rreth 269.2 milion LEK më të ulëta se e njëjta periudhë e një viti më parë.

Sektori Energjitik

Ky sektor strategjik ka qenë dhe mbetet nën monitorimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, duke patur parasysh ndikimin e konsiderueshëm fiskal dhe impaktin e ndjeshëm të tij në ekonomi. Ky monitorim, i cili është kryer periodikisht mbi bazë tremujore, ka konsistuar në analizimin e treguesve të performancës financiare të secilës prej tre kompanive KESH, OST dhe OSHEE Group.

Në mbështetje të nenit 4/2 të ligjit 57, datë 2.06.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”, sipas së cilit: “*Planet financiare vjetore dhe pasqyrat financiare mbi bazë tremujori, të çdo njësie jo të qeverisjes së përgjithshme, dorëzohen në Ministrinë e Financave*”, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, periodikisht mbi bazë tremujore, ka mbledhur, përpunuar dhe analizuar informacionin e nevojshëm në lidhje me treguesit e performancës financiare të tre kompanive të sektorit energjitik. Kjo, me qëllim identifikimin, vlerësimin, monitorimin dhe raportimin e risqeve fiskale që rezultojnë nga ndërmarrjet publike me kapital shtetëror në tërësi dhe nga sektori energjitik në veçanti, duke konsideruar rëndësinë strategjike të tij dhe problematikat sensitive që e karakterizojnë.

Në tabelën e mëposhtme paraqitet në mënyrë të përmbledhur ndikimi që sektori i energjisë ka patur në financat publike në vite.

Tabela 11. Të dhënat mbi impaktin e sektorit të energjisë në financat publike (në milion lekë)

Disbursimet për sektorin e Energjisë (2018-6M 2022) Nënua

në milion lekë

| | 2018 | 2019 | 2020 | 2021 | 6M 2022 | |
|-----------------|----------------------|----------------|----------------|----------------|----------------|-----------------|
| ENERGJIA | Projekte | 4,510.5 | 1,142.2 | 1,696.5 | 1,172.5 | 5,608.4 |
| | Mbeshtetje Buxhetore | - | - | - | - | 23,907* |
| | Gjithsej | 4,510.5 | 1,142.2 | 1,696.5 | 1,172.5 | 29,515.7 |

Burimi: Drejtoria e Borxhit Publik, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, FRU 2022

Arkëtimet nga nënhuaja për sektorin e Energjisë (2018-6M 2022)

në milion lekë

| | 2018 | 2019 | 2020 | 2021 | 6M 2022 | |
|-----------------|-----------------|--------------|--------------|--------------|--------------|--------------|
| ENERGJIA | Interesa* | 91.7 | 404.3 | 193.3 | 53.2 | 45.3 |
| | Principal* | 161.3 | 67.0 | 274.4 | 183.8 | 253.3 |
| | Gjithsej | 253.0 | 471.2 | 467.7 | 237.0 | 298.6 |

Detyrimet kontigjente nga garancitë (në milion lekë)

| | 31 Dhjetor | | | | | | 8M 2022 |
|------------------------------------|------------|--------|--------|--------|--------|--------|---------|
| | 2016 | 2017 | 2018 | 2019 | 2020 | 2021 | |
| Stoku i borxhit të garantuar | 53,468 | 49,885 | 44,672 | 41,853 | 48,813 | 48,102 | 56,009 |
| Grancitë e brendshme | 30,286 | 30,117 | 15,218 | 15,154 | 13,297 | 14,500 | 20,955 |
| Grancitë e jashtme..... | 23,182 | 19,768 | 29,454 | 26,698 | 35,516 | 33,603 | 35,053 |

Burimi: Drejtoria e Borxhit Publik, FRU 2022

Përsa i përket performancës së Sektorit në tërësi dhe OSHEE sh.a në veçanti, vlen të theksojmë se:

- ❖ **Gjatë vitit 2021** në veçanti në tremujorin e tretë dhe të katërt të vitit, sektori u përball me një situatë aspak të favorshme që rrjedhimisht ndikoi negativisht në pozicionin financiar të sektorit. Gjatë kësaj periudhe OSHEE sh.a është përballur me një rritje të paparashikuar eksponenciale të çmimit të energjisë në Tregun e Lirë, për rrjedhojë mosplotësimi i planit të furnizimit me energji elektrike si pasojë e motit të thatë ka detyruar OSHEE Group sh.a të plotësojë këtë mungesë me blerje në tregun e lirë, e cila ka ndikuar negativisht në ulje të performancës financiare dhe mungesë likuiditeti të shoqërisë. Konkretisht gjatë 12M të vitit 2021, KESH Sh.a realizoi një nivel të prodhimit publik neto prej rreth 5.34 TËh, krahasuar me 3.09 TËh realizuar në 12M e vitit 2020; një rritje kjo prej rreth 72.9 përqind. Humbjet në sistemin e shpërndarjes së energjisë elektrike rezultuan në nivelin **20.62 përqind** për 12M 2021, duke shënuar një rënie të mëtejshme të tyre krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Niveli i arkëtimeve për 12M 2021 arriti vlerën prej **97.4 përqind** krahasuar me nivelin prej **95.8 përqind** realizuar në vitin 2020, e cila dëshmon stabilitetin e operatorit në këtë drejtim. Megjithëse edhe pse treguesit e përgjithshëm për vitin 2021 duken pozitivë, shqetësuese ka qenë niveli i basenëve prodhues të hidrocentraleve publike. Konkretisht niveli i basenit të Fierzës deri në muajin Nëntor 2021 ishte në kuotën **267.8m**. Ky është **niveli më i ulët** për muajin Nëntor që prej vitit 2018 dhe **niveli shumë më i ulët sesa kuota mesatare** prej 274.7m e 30 viteve të fundit, për të njëjtën periudhë. Shqetësues ka qenë dhe fakti që niveli i basenit ka zbritur nga kuota 291.7m në fund të Qershorit, në 271.3m vetëm 3 muaj më vonë në fund të Shtatorit. Mosplotësimi i planit të furnizimit me energji

elektrike si pasojë e motit të thatë ka detyruar OSHEE Group sh.a të plotësojë këtë mungesë me blerje në tregun e lirë, dhe rrjedhimisht ka ndikuar në ulje të performancës financiare dhe mungesë likuiditeti të kompanisë. Për rrjedhojë projektvendimi Nr.584, datë 8.10.2021 “Për Shpalljen e emergjencës në furnizimin me energji elektrike” hyri në fuqi në fund të vitit me efekt deri më datë 15 prill 2022 me qëllim garantimin e pandërprerë të energjisë elektrike nga operatorët publik.

❖ **Gjatë 6 mujorit 2022** sektori energjitik vazhdon të përballet me një situatë jo të favorshme në terma financiarë, një vazhdimësi kjo e fund-vitit 2021, si pasojë e situatës jo të mirë meteorologjike në vend e cila ka ulur nivelin e prodhimit të energjisë vendase nga KESH sh.a.. Sikurse në periudhën e fund-vitit 2021, edhe për 6 mujorin e parë 2022 shqetësuese vazhdon të mbetet niveli i basenëve prodhues të hidrocentraleve publike. Konkretisht për periudhën raportuese niveli i basenit të Fierzës deri në muajin Qershor 2022 ishte në kuotën **288.0m**, duke shënuar kështu **nivelin më të ulët** për muajin Qershor që prej vitit 2017, si dhe **nivelin më të ulët sesa kuota mesatare** prej 289.53m e 30 viteve të fundit, për të njëjtën periudhë. Mosplotësimi i planit të furnizimit me energji elektrike si pasojë e motit të thatë ka detyruar KESH sh.a të plotësojë këtë mungesë me blerje në tregun e lirë³. Ndikim në sektor kanë patur dhe goditjet që tregjet evropiane të energjisë pësuan përgjatë kësaj periudhe si pasojë e konfliktit në Ukrainë dhe rritjes së paparashikuar eksponenciale të çmimit të energjisë në Tregun e Lirë. Për rrjedhojë, KESH sh.a si pasojë e motit të thatë është detyruar të plotësojë këtë mungesë në prodhim me blerje në tregun e lirë, duke ndikuar negativisht kjo në një ulje të performancës financiare të shoqërisë dhe duke sjellë mungesë likuiditeti për të. Sa i përket humbjeve në sistemin e shpërndarjes së energjisë elektrike ato rezultuan në nivelin 21.26 përqind për 6M 2022, duke shënuar një rënie të mëtejshme të nivelit të humbjeve krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, ku humbjet figuruan në nivelin 22.30 përqind. Niveli i arketimeve për 6M 2022 arriti vlerën prej 93.9 përqind, një shifër mjaft e mirë por një rënie krahasuar me vlerën prej 96.1 përqind të njëjtën periudhë të një viti më parë. Për rrjedhojë të situatës jo të mirë të sektorit energjitik përmendur sa më sipër, VKM Nr.584, datë 8.10.2021 “Për Shpalljen e emergjencës në furnizimin me energji elektrike” i shtriu efektet e gjëndjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike deri me 31 Dhjetor 2022.

❖ **Gjatë 8 mujorit 2022**, KESH sh.a realizoi një nivel prodhimi neto publik prej rreth 2.43 TËh. Ky tregues dëshmon që deri në 8M e vitit 2022, situata hidrike vijon të mos jetë në kushte të favorshme të një viti normal furnizimi nga KESH sh.a prej 3.85 TËh kundrejt OSHEE Group sh.a. Gjithashtu, një tregues shqetësues për periudhën mbetet niveli i basenëve hidrikë. Konkretisht, niveli i basenit të Fierzës deri në muajin Gusht 2022 ishte në kuotën **270.4m**. Ky është **niveli më i ulët** për këtë periudhë që prej vitit 2017 dhe **nivel shumë më i ulët sesa kuota mesatare** prej 279.3m e 30 viteve të fundit, për të njëjtën periudhë. Shqetësues është fakti që niveli i basenit të Fierzës ka zbritur nga kuota 288m në Qershor, në 270.4m vetëm në 3 muajt e fundit. Mosplotësimi i planit të furnizimit me energji elektrike si pasojë e motit të thatë do të detyrojë KESH sh.a të plotësojë këtë mungesë me blerje në tregun e lirë, që mund të ndikojë në ulje të performancës financiare dhe mungesë likuiditeti për shoqërinë. Për vitet 2022-2023, KESH sh.a ka raportuar se rritja e paparashikuar eksponenciale e çmimit të energjisë në Tregun e Lirë ka ndryshuar tërësisht perspektivën e zhvillimit të aktivitetit të shoqërisë duke ndikuar negativisht në

³ Në zbatim të VKM-së nr. 757 datë 09.12.2021, për ndryshimin e VKM-së nr.620/2021, shoqëria KESH sh.a është ngarkuar me vazhdimin e furnizimit të pandërprerë të konsumatorëve, me detyrimin për të furnizuar FSHU me të gjithë sasinë e nevojshme, për qëllime të plotësisht të kërkesës së plotë të saj.

performancën e saj financiare. Në këto kushte, KESH sh.a është detyruar të kërkojë mbështetje buxhetore për të përballuar rritjen e çmimeve në tregun e parregulluar të energjisë për qëllime të plotësimit të kërkesës së plotë të OSHEE Group sh.a dhe vazhdimin e furnizimit të pandërprerë për konsumatorët. Sa i përket humbjeve në sistemin e shpërndarjes së energjisë elektrike ato rezultuan në nivelin 20.42 përqind për 8M 2022, duke shënuar një rënie të mëtejshme të nivelit të humbjeve krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, ku humbjet figuruan në nivelin 21.30 përqind. Niveli i arkëtimeve për 8M 2022 arriti vlerën prej 96.0 përqind, një shifër mjaft e mirë dhe e pandryshuar krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, gjë që dëshmon stabilitetin e operatorit në këtë drejtim.

- **Financimi i huaj** për sektorin e energjisë **për vitin 2022**, është miratuar në nivelin 2.1 miliard LEK. Duke marrë në konsideratë situatën e pafavorshme hidrike të vitit 2022 dhe efektet në vazhdim të krizës globale energjitike, kompanive iu është kërkuar të rishikojnë dhe të prioritarizojnë investimet e planifikuara përgjatë vitit 2022 (*investimet e nevojshme emergjente*), për të garantuar blerjen e energjisë elektrike në tregun e lirë dhe vazhdimin e furnizimit të pandërprerë të konsumatorëve.

Parashikimet për vitet 2022-2023 dhe problematika të tjera

Nisur nga informacionet më të fundit të përcjella nga KESH sh.a., vërehet se sektori i energjisë elektrike në vend po përballlet me një situatë të vështirë financiare, si pasojë e një sërë faktorësh të brendshëm dhe të jashtëm, të cilët konsistojnë në:

- ✓ *Vështirësitë financiare ndikuar nga situata e një viti të thatë hidrologjik,*
- ✓ *Shtrirja e efektit të gjëndjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike deri me 31 Dhjetor 2022, në zbatim të VKM nr.584 datë 08.10.2021 “Për shpalljen e gjëndjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike”.*
- ✓ *Rritja e jashtëzakonshme e çmimit të energjisë elektrike në tregjet e energjisë (Bursa) ndërkombëtare, të ndikuar nga situata globale. Kjo rritje në çmime ka sjellur nevojën e menjëhershme për financimin e KESH sh.a, për të përballuar nevojat për likuiditet për shpenzimet e rritura të blerjes së energjisë, në mënyrë funksionin e rregullt dhe pa ndërprerje të shërbimit për furnizim me energji elektrike.*
- ✓ *Në zbatim të VKM nr. 757 datë 09.12.2021, për ndryshimin e VKM-së nr.620/2021, shoqëria KESH sh.a është ngarkuar me vazhdimin e furnizimit të pandërprerë të konsumatorëve, me detyrimin për të furnizuar FSHU me të gjithë sasinë e nevojshme, për qëllime të plotësimit të kërkesës së plotë të saj.*

Me qëllim përmbushjen e detyrimit për vazhdimin e furnizimit të pandërprerë të konsumatorëve në zbatim të VKM-së nr. 757 datë 09.12.2021, garantimin dhe demonstrimin e aftësisë paguese të KESH sh.a. në tregun e energjisë (*bursa*), si dhe për mbulimin e nevojave shtesë si pasojë e parashikimeve të rritjes së çmimit në bursë për periudhën në vijim, në buxhetin e vitit 2022 është planifikuar (i) Hua e dhënë për energjinë në shumën 8 miliard lekë (disbursuar në masën 7.9 miliard lekë) dhe (ii) Mbështetje buxhetore për sektorin e energjisë në shumën 20 miliard lekë (disbursuar me VKM në masën 16 miliard lekë).

Detyrimet e ndërsjellta midis ndërmarjeve të sektorit energjitik, ML/IB, MFE dhe DPT

Në kuadër të reformës në sektorin e energjisë, në muajin Dhjetor të vitit 2020 u finalizua me sukses plani i masave për reduktimin e detyrimeve të prapambetura në sektorin e energjisë elektrike. Ky plan masash, sipas Urdhërit të përbashkët të MFE dhe MIE nr.304/2020 “Për miratimin e planit të masave të reduktimit të detyrimeve të prapambetura në sektorin e energjisë elektrike”, i vënë në zbatim që prej Janarit 2021 e në vijim, shërben si një instrument kryesor për realizimin e një prej elementeve kryesore të reformës në këtë sektor jetik për ekonominë e vendit, siç është arritja e konsolidimit financiar të sektorit elektroenergjitik. Ky plan ofron një seri masash për parandalimin e detyrimeve të prapambetura dhe disiplinimin e pagesave ndërmjet kompanive të sektorit energjitik dhe palëve kryesore të lidhura me to. Me qëllim zbatimin me sukses të këtij plani, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, bashkëfirmosën Urdhërin e Përbashkët nr.379/2021 me datë 30.09.2021 “Mbi zbatimin e planit të masave për reduktimin e detyrimeve të prapambetura në sektorin e energjisë elektrike”, që ngarkon ndërmarrjet e sektorit energjitik për raportimin mujor nga ana e tyre, mbi shlyerjen e detyrimeve të prapambetura dhe statusin e detyrimeve ndërmjet sektorit të energjisë dhe entiteve të tjera publike.

Tabela e mëposhtme paraqet në mënyrë tabelare detyrimet e ndërsjella në sektorin e energjisë elektrike:

Tabela 12. Detyrimet e ndërsjella midis ndërmarrjeve të sektorit energjitik, ML/IB, MFE dhe DPT:

| Deri në Qershor 2022 (në mld lekë) | KESH | OST | OSHEE | MFE | DPT | Total |
|---------------------------------------|--------------|--------------|--------------|--------------|-------------|---------------|
| KESH ndaj: | | 0* | | 19.83 | 0.01 | 19.84 |
| OST ndaj: | 7.48** | | 1.54 | 15.80 | | 24.82 |
| OSHEE ndaj: | 51.87 | 19.42 | | 4.60 | 6.70 | 82.59 |
| Ndermarrjet UK ndaj: | | | 22.71 | | 0.76 | 23.47 |
| ML/IB | | | 5.50 | | | 5.50 |
| Total | 59.35 | 19.42 | 29.75 | 40.23 | 7.47 | 156.22 |

*Vlera e detyrimeve të ndërsjellta varion nga 0-63 mln lekë, për arsye të pretendimeve të ndryshme të kompanive

** Vlera e detyrimeve të ndërsjellta varion nga 7,482-7,489 mln lekë, për arsye të pretendimeve të ndryshme të kompanive
Burimi: MFE, KESH, OST, OSHEE Group, dhe AKUM, 2022

Tabela 13. Të dhëna të raportuara nga Drejtoria e Borxhit pranë MFE dhe DPT (në miliardë lekë).

| Deri në Qershor 2022 | MFE | DPT |
|-----------------------------|-------|------|
| KESH ndaj: | 32.16 | 0.01 |
| OST ndaj: | 10.57 | |
| OSHEE Group ndaj: | 2.76 | 5.44 |
| Ndermarrjet UK ndaj: | 10.37 | |

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, FRU 2022

Detyrimet e shoqërive të Ujësjiellës - Kanalizimeve ndaj OSHEE Group Sh.a sipas raportimit më të fundit të FSHU-së, vazhdojnë të mbeten në një vlerë të konsiderueshme, rreth 24.47 miliardë Lekë. Nga të cilat, 13.23 miliard Lekë janë detyrime të faturuara ndaj kompanisë dhe 11.24 miliard Lekë janë detyrime për kamatëvonesa.

- ✓ Nga totali i detyrimeve të raportuara, vetëm ndërmarrja e UK Sh.a Durrës ka 8.28 miliard Lekë detyrime të akumuluar në vite. Në tabelën e mëposhtme listohen pesë ndërmarrjet që kanë pjesën më të madhe të detyrimeve ndaj OSHEE Group Sh.a.

Tabela 14. Ujësjiellësat me detyrimet më të mëdhaja ndaj OSHEE Group

(miliardë/lekë)

| <u>5 UK kryesore me detyrime ndaj OSHEE</u> | <u>15.24</u> |
|--|---------------------|
| Durrës UK Sh.a | 8.28 |
| Vlorë UK Sh.a | 2.60 |
| Patos UK Sh.a | 1.79 |
| Fier UK Sh.a | 1.42 |
| Kavajë UK Sh.a | 1.15 |

Akumulimi i detyrimeve të prapambetura vazhdon trendin rritës, kryesisht për shkak të performancës së ulët të shumicës së shoqërive U-K sha. Nisur nga kjo, ka startuar procesi i reformimit dhe riorganizimit të sektorit të Ujit, në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve 2020-2030. Synimi është ridimensionimi i 61 ndërmarrjeve U-K aktuale, përmes rigrupimit të tyre në 15 subjekte me kompetenca të përbashkëta (SKP), të cilat do të jenë shoqëri të reja aksionare, me qëllim final menaxhimin optimal dhe rritjen e performancës së tyre financiare. Për këtë qëllim është miratuar VKM nr. 302, datë 11.05.2022 “Për Politikat Kombëtare për Riorganizimin e Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe të Largimit, Trajtimit dhe Përpunimit të Ujërave të Ndotura”.

Të tjera Ndërmarrje Shtetërore (NSH) të monitoruara gjatë 6M 2022:

Përveç sektorit të energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë monitoron në mënyrë periodike ndërmarrje të tjera shtetërore të cilat kanë impaktin më të lartë financiar për buxhetin e shtetit apo që mund të paraqesin rrisje të konsiderueshme fiskale, duke analizuar në baza tremujore performancën e tyre financiare.

Referuar analizës mbi raportimin më të fundit të treguesve financiarë të miratuar zyrtarisht për ndërmarrjet shtetërore në monitorim, vlen të theksojmë:

- **UKT Sh.a (Ujësjetllës Kanalizime Tiranë sh.a):**

Në fund të vitit 2021, për UKT sh.a (Ujësjetllës Kanalizime Tiranë), niveli i të ardhurave ishte 4,347 milionë lekë dhe shpenzimet 3,461 milionë lekë. Firma regjistroi një fitim neto pozitiv prej 886 milionë lekë për vitin 2021. Ky trend pozitiv vazhdoi dhe në gjashtë mujorin e vitit 2022, ku të ardhurat e UKT sh.a arritën në rreth 2,151 milionë lekë ndërsa totali i shpenzimeve ishte rreth 1,757 milionë lekë. Kjo tregon një vazhdimësi të ecurisë pozitive të kompanisë ku fitimi neto për periudhën rezuloi me rreth 395 milionë lekë.

- **Hekurudha Shqiptare Sh.a:**

Në fund të vitit 2021, Hekurudha Shqiptare nëpërmjet pasqyrave financiare ka raportuar se të ardhurat arritën në masën 587 milionë lekë, ndërsa shpenzimet e përgjithshme në masën 1,014 milionë lekë. Shoqëria regjistroi një humbje neto prej 427 milionë lekë për vitin 2021. Për periudhën 6M 2022, të ardhurat nga Hekurudhat Shqiptare arritën në masën 215 milionë lekë, ndërsa shpenzimet e përgjithshme arritën në masën rreth 442 milionë lekë. Shoqëria rezulton me një humbje neto prej rreth 227 milionë lekë, duke shfaqur më tej një ecuri negative të shoqërisë si në vitin 2021 ashtu edhe në gjashtë mujorin e vitit 2022.

- **AlbGaz Sh.a:**

Në fund të vitit 2021, AlbGaz raportoi të ardhurat në shumën 163 milionë lekë dhe shpenzimet në 195 milionë lekë. Në fund të vitit 2021, raportohet një humbje neto prej 32 milionë lekë për shoqërinë, duke treguar kështu një performancë të dobët për periudhën. Në raportin e tyre të mes-vitit 6M 2022, shoqëria

AlbGaz Sh.a raportoi të ardhurat në një vlerë rreth 113 milionë lekë dhe shpenzimet në rreth 82 milionë lekë. Shoqëria pati një ecuri kthese pozitive në 6M 2022, me një fitim neto prej rreth 31 milionë lekë.

- **Albcontrol Sh.a:**

Të ardhurat e AlbControl në fund të vitit 2021 ishin 2,777 milionë lekë dhe shpenzimet 2,264 milionë lekë. Shoqëria regjistroi një fitim neto prej 513 milionë lekë për vitin 2021. Për periudhën 6M 2022, të ardhurat e AlbControl sh.a ishin në vlerën prej 1,497 milionë lekë ndërsa shpenzimet në total ishin në vlerën prej 1,072 milionë lekë. Albcontrol Sh.a ka vazhduar të ndjekë trendin pozitiv të fund vitit 2021 duke regjistruar një fitim neto për periudhën gjashtë mujore 2022 në një vlerë prej rreth 425 milionë lekë.

- **Radio Televizioni Shqiptar Sh.a (RTSH):**

Të ardhurat e RTSH-së në fund të vitit 2021 ishin në vlerën rreth 2,109 milionë lekë ndërsa shpenzimet në total ishin në vlerën rreth 2,570 milionë lekë. Shoqëria rezultoi me një humbje neto prej 461 milionë lekë. Për periudhën 6M 2022, të ardhurat e RTSH sh.a ishin në një vlerë rreth 1,089 milionë lekë, ndërsa shpenzimet në total ishin në një vlerë rreth 906 milionë lekë, duke rezultuar me një fitim neto rreth 182 milion LEK. Deri në 6M 2022 vërehet një përmirësim i treguesve financiarë të RTSH krahasuar me v.2021.

Detyrimet Kontigjente

- **Vendimet e Gjykatës së të Drejtave të Njeriut në Strasburg (GJEDNJ)** kryesisht çështje dhe vendime që lidhen me kthimin dhe kompensimin e pronave tek ish-pronarët. Sipas Avokaturës së Shtetit, risqet financiare që burojnë nga vendimet e GJEDNJ-së janë të karakterizuara nga një aftësi e dobët parashikuese, përse kohë që kjo Gjykatë nuk funksionon më me një kalendar të përcaktuar për komunikimin e çështjeve dhe nxjerrjen e vendimeve.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka respektuar në vazhdimësi të gjitha vendimet e miratuara nga GJEDNJ përmes zbatimit të VKM-ve respektive miratuar në mbështetje të tyre, me përpikmëri dhe brenda afateve strikte të përcaktuara prej këtij organi. Kjo, duke konsideruar faktin se kur pagesat nuk kryhen brenda afatit tre mujor nga data kur vendimi përkatës merr formën e prerë, shteti shqiptar ngarkohet me pagesën e një kamatë-vonese për çdo ditë vonesë. Sidoqoftë, për garantimin e shlyerjes në kohë të këtyre vendimeve, MFE ka rekomanduar vazhdimisht përdorimin e të gjitha kanaleve të mundshme institucionale dhe procedurale, brenda hapësirave që siguron kuadri ligjor në fuqi, duke sugjeruar skedulimin e detyrimit financiar, sipas mundësive të buxhetit të shtetit me këste, në negociim me përfituesit. Edhe për vitin 2022, likuidimi i detyrimeve të këtij lloji parashikohet të përballohet nga Fondi Rezervë i buxhetit të shtetit.

Ndërkohë, hyrja në fuqi më datë 30.12.2018 e ndryshimeve në ligjin “Për Avokaturën e Shtetit”, përmban një kre të veçantë dedikuar ekzekutimit të vendimeve të GJEDNJ-së, ku specifikisht në nenin 19/5 përcaktohen dy mënyra ekzekutimi të shpërblimit:

- ✓ *Detyrimet financiare që burojnë nga vendimet e GJEDNJ-së mbulohen nga buxheti i shtetit, sipas përcaktimeve të parashikuara në vendimin e Këshillit të Ministrave për ekzekutimin e vendimit të GJEDNJ.*
- ✓ *Përrjashtimisht, për detyrimet financiare deri në 10.000 (dhjetë mijë) euro, pagesa ekzekutohet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga ministria përgjegjëse për financat, pas njoftimit nga Avokatura e Shtetit.*

Mëposhtë paraqitet tabela përmbledhëse e detyrimeve për vendimet e GJEDNJ-së, bazuar në informacionin që disponon Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Tabela 15: Detyrimet faktike dhe kontigjente nga vendimet e GJEDNJ-së (në Euro)

| Vendimet e GJEDNJ | Detyrimi faktik | Detyrimi kontigjent | Totali i detyrimit faktik dhe kontigjent |
|--|---------------------|---------------------|--|
| Delijorgji kundër Shqipërisë | 15,600 € | | 15,600 € |
| Prizreni kundër Shqipërisë | 13,450 € | | 13,450 € |
| Balkasi kundër Shqipërisë | 13,500 € | | 13,500 € |
| Rista dhe të tjerë kundër Shqipërisë (Kërkesa:Dhimërtika dhe Nika k. Shqipërisë) | 4,417,750 € | | 4,417,750 € |
| Sharrxhi kundër Shqipërisë | 13,447,300 € | | 13,447,300 € |
| Sharra dhe të tjerë kundër Shqipërisë (çështjet Maçi dhe Vrioni) | | 3,811,365 € | 3,811,365 € |
| Strazimiri kundër Shqipërisë | 17,500 € | | 17,500 € |
| Cështjet: “Milo kundër Shqipërisë”, “Kalemaj kundër Shqipërisë”, “Jahbala kundër Shqipërisë”, “I.M.S kundër Shqipërisë”, “Sovjani kundër Shqipërisë” | | 16,800 € | 16,800 € |
| Cështjet: “Habilaj kundër Shqipërisë” dhe “Danushi kundër Shqipërisë” | | 7,050 € | 7,050 € |
| “Peshkopia dhe Talipi kundër Shqipërisë” | | 3,850 € | 3,850 € |
| X dhe të tjerë kundër Shqipërisë | | 18,000 € | 18,000 € |
| Totali | 17,925,100 € | 3,857,065 € | 21,782,165 € |

Burimi: Avokatura e Shtetit, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022)

- Vendimet e Gjykatës Ndërkombëtare të ARBITRAZHIT** që kanë të bëjnë me zgjidhjen e konflikteve në mosmarrëveshjet dy ose shumëpalëshe, në ngarkim të shtetit shqiptar. Duke patur parasysh efektet e qënësishme financiare që rëndom shoqërojnë këto vendime, ato vlerësohen me risk të konsiderueshëm për buxhetin e shtetit. Në pjesën më të madhe, efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtyre vendimeve janë përballuar nga buxheti i vetë institucioneve buxhetore (kryesisht ministri linje) të cilat kanë qenë edhe palë e paditur në gjykimet respektive. Ndërkohë që, në rastet kur palë e paditur cilësohet ‘shteti shqiptar’ apo ‘qeveria shqiptare’, këto vendime likujdohen përmes buxhetit të MFE dhe/ose Fondit Rezervë të buxhetit të shtetit, nëse lind nevoja.

 - ✓ *Ministria e Financave dhe Ekonomisë, në vazhdimësi, ka rekomanduar forcimin e rolit negociues të institucioneve buxhetore dhe Avokaturës së Shtetit në çështjet e kësaj natyre, si edhe disiplinimin e procesit të shlyerjes financiare të përfituesve. Kjo, me qëllimin final të lehtësimit, reduktimit dhe/ose shmangies së barrës financiare mbi buxhetin e shtetit.*

Mëposhtë paraqitet tabela përmbledhëse e detyrimeve për vendimet e Arbitrazhit Ndërkombëtar, bazuar në informacionin që disponon Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Tab.16

në Euro

| Ministritë e Linjës | Përshkrimi i Vendimeve të Arbitrazhit | Detyrimi Faktik | Detyrimet Kontigjente | Totali i detyrimit faktik dhe kontigjent |
|---------------------|--|-------------------|-----------------------|--|
| MIE | ICC Case 23998/MHM (c - 24011/MHM/HHB). Vendimi i Arbitrazhit datë 01.09.2020, në favor të JV Copri-Aktor dhe palë të paditur ARRSH | 42,915,256 | 0 | 42,915,256 |
| | Kosto ligjore dhe shpenzime gjyqësore lidhur me vendimin e Arbitrazhit ICC Case 23998/MHM (c - 24011/MHM/HHB) | 225,000 | 0 | 225,000 |
| | ICC Case no.22676/GR GBC Oil Company LTD vs MIE, AKBN dhe Albpetrol | 13,399,888 | | 13,399,888 |
| | Kosto administrative dhe ligjore ICC Case no.24140/MHM/HHB Construzioni DONDI S.P.A me palë të paditur AKUM. | 150,000 | 0 | 150,000 |
| | Kosto ligjore në procedurën e anulimit të vendimit të arbitrazhit datë 11.02.2020, kundër rishikimit të vendimit përfundimtar datë 04.06.2019 ICC Case no.22919/GR | 58,500 | 111,150 | 169,650 |
| | Kosto administrative në çështjen ICSID Case no.ARB/20/54 Arka Energy B.V | 700,000 | 950,000 | 1,650,000 |
| | Kosto administrative dhe ligjore për çështjen ICSID Case no.ARB/20/37 (Durrës Kurum Shipping dhe të tjerë kundër Shqipërisë) | 1,290,000 | 0 | 1,290,000 |
| | Kosto ligjore për procedurat e përfaqësimit të MIE/AKBN në çështjen ICC Case 21349/EMT/GR (BPAL v MIE/AKBN dhe Albpetrol) | 2,627,200 | 0 | 2,627,200 |
| | Konsulencë ligjore dhe financiare për projektin e Investimit strategjik Marina & Jahtet Durrës | 224,000 | | 224,000 |
| MIE | Arbitrazhi me kompaninë Starbridge për Portin e Karpenit, "HFV" LLP | 32,457 | 0 | 32,457 |
| MFE | | 0 | 0 | 0 |
| MIE | | 0 | 50,000 | 50,000 |
| MFE | | 0 | 50,000 | 50,000 |
| | Përfaqësimi i Shqipërisë në çështjen SCC Case no.2021/155 'IVICOM Holding GmbH' | 750,000 | 900,000 | 1,650,000 |
| | Kosto ligjore për këshillime ligjor dhe shërbime konsulence për mosmarrëveshjet dhe arbitrazhet ndërkombëtare | 450,000 | 0 | 450,000 |
| | Arbitrazhi ICSID nr.ARB/15/28 "Hydro dhe të tjerët kundër Shqipërisë" | 0 | 108,000,000 | 108,000,000 |
| | Kosto ligjore lidhur me vendimin e Arbitrazhit ICSID nr.ARB/15/28 "Hydro dhe të tjerët kundër Shqipërisë" | 1,854,379 | 1,084,280 | 2,938,659 |
| MBZHR | Kosto ligjore për PCA Case 2018-49 'Valeria Italia' srl | 494,250 | 0 | 494,250 |
| Total | | 65,170,930 | 111,145,430 | 176,316,360 |

Burimi: Avokatura e Shtetit, Ministritë e Linjës, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022)

- **Vendimet gjyqësore administrative të formës së prerë**, kryesisht për largime nga puna të ish-punonjësve, procese gjyqësore me karakter shpronësimi etj, implikojnë kosto buxhetore të paparashikuara. Për t'i paraprirë stokut eventual të akumulimit të tyre në kohë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë përveç një monitorimi periodik, vazhdimisht i ka bërë apel edhe aftësisë menaxhuese të vetë institucioneve buxhetore, përmes aplikimit me këste apo instrumentave të tjerë zbutës në kohë të barrës së tyre buxhetore.

Detyrimet e Prapambetura

Bazuar në VKM nr. 50 datë 05.02.2014 “Për miratimin e Strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit” dhe Strategjisë së Menaxhimit të Financave Publike 2014-2021, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka ndërmarrë disa hapa konkretë në drejtim të monitorimit, raportimit dhe parandalimit të detyrimeve të prapambetura. Vlen për t’u theksuar se tashmë monitorimi i detyrimeve të prapambetura është një proces i konsoliduar në kohë dhe cilësi, përmes monitorimit periodik intensiv të të gjitha detyrimeve të pashlyera të institucioneve buxhetore. Duke nisur nga muaji Dhjetor 2020, ky monitorim dhe raportim i cili më parë kryhej mbi bazë bazë tremujore nëpërmjet raportimit shkresor të institucioneve tashmë gjenerohet automatikisht nga Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë (SIFQ) sipas përcaktimve të udhëzimit nr.37 të datës 06.10.2020. Ky format i raportimit të detyrimeve të prapambetura përveç se rrit saktësinë dhe siguron të dhënat në kohë, është gjithashtu një format gjithëpërfshirës duke unifikuar raportin për të gjithë njësitë e qeverisjes së përgjithshme.

Deri në fund të muajit Qershor 2022 regjistrohet një stok kumulativ prej 15.45 miliard LEK⁴ detyrime të prapambetura nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme. Konkretisht:

- ✓ *Totali detyrimeve të qeverisë qendrore rreth 7.91 miliard LEK*
- ✓ *Totali detyrimeve për rimbursimin e TVSH-së rreth 0.48 miliard LEK*
- ✓ *Totali detyrimeve të qeverisë vendore rreth 7.06 miliard LEK*

Krahasuar me stokun e detyrimeve të raportuara për 6M e vitit 2021 rezulton që:

- ✓ *Niveli i përgjithshëm i detyrimeve të prapambetura është rreth 2.64 miliard LEK me i ulët, ku detyrimet e njësitë të qeverisjes qendrore dhe detyrimet për rimbursimin e TVSH-së janë ulur ndjeshëm respektivisht me rreth 1.81 miliard LEK dhe 1.25 miliard LEK krahasuar me 6M 2021.*


8. VEPRIMTARITË POTHUAJSE FISKALE

Në fund të muajit qershor 2022, portofoli i borxhit të garantuar vlerësohet në 55.2 miliard Lekë (2.7% e PBB) ose 4.0% e portofolit të borxhit të qeverisjes qendrore. Garancitë në tregun e brendshëm zënë 38.6% të stokut total të borxhit të garantuar ose 21.3 miliardë lekë, ndërsa garancitë e dhëna në favor të kreditorëve të huaj përfaqësojnë 61.4% të stokut të borxhit të garantuar ose 33.8 miliardë lekë. Në stokun e garancive përfshihen dhe dy garancitë që emtoi qeveria e Republikës së Shqipërisë gjatë muajve prill – maj 2020, në kuadër të menaxhimit të situatës së krijuar nga pandemia COVID-19. Në gjysmën e parë të vitit 2022, Qeveria e Republikës së Shqipërisë emtoi dhe një tjetër garanci shtetërore, për të menaxhuar situatën e krijuar nga ndikimi i konfliktit ruso-ukrainas në rritjen e çmimeve. Kjo Marrëveshje Garancie, e cila u miratua me VKM nr. 349, datë 26.05.2022, është në vlerën prej 3.0 miliardë lekësh, dhe është nënshkruar nga katër banka kryesore tregtare në Shqipëri (*BKT bank, Raiffeisen Bank, OTP Bank dhe Credins Bank*). Miratimi i kësaj Marrëveshje Garancie ishte pjesë e paketës së masave të ndërmarra nga qeveria e Republikës së Shqipërisë në mbështetje të qytetarëve dhe biznesit nga ndikimi i luftës Rusi-Ukrainë mbi rritjen e çmimeve. Qëllimi kryesor i kësaj skeme është mbështetja e biznesit duke bërë të mundur huadhënien për subjektet që tregtojnë me shumicë, produkte ushqimore bazë për të mbajtur

⁴ Pa përfshirë detyrimet e prapambetura të Ujësjellës Kanalizime dhe Universiteteve


rezerva për një periudhë 3 mujore, ose në përputhje me jetëgjatësinë e produktit, me qëllim përballimin e situatës së veçantë të krijuar në treg.

Grafiku 6: Portofoli i Garancive Shtetërore (2017 – Qershor 2022)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022)

Grafiku 7: Portofoli i Garancive shtetërore (2017 – Qershor 2022)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022)


Më shumë se 70% e totalit të garancive shtetërore i përkasin sektorit të energjisë, duke reflektuar politikat e qeverisë në drejtim të mbështetjes së sektorit të energjisë, sidomos në situatën më të fundit me të cilën ku sektor po përballlet.

9. SHTOJCA ILUSTRUESE

9.1 TREGUESIT E PËRZGJEDHUR MAKROEKONOMIKË DHE FISKAL

Në muajin Gusht 2022 ndryshimi vjetor i indeksit të çmimeve të konsumit është +8%, një vit më parë ky ndryshim ishte +2.4%. Ndryshimi mujor i indeksit të çmimeve të konsumit në muajin Gusht 2022, krahasuar me Korrik 2022, është 0.8%. Inflacioni mesatar për periudhën Janar – Gusht 2022 është +6.1%.

Figura 1: Ndryshimi Vjetor i Inflacionit, në %.




Treguesi i ndjesisë ekonomike (TNE)⁵ shënoi nivelin 104.4 në Gusht 2022, duke pësuar një rënie prej 1.8 pikësh nga muaji i kaluar dhe një rënie me 5.3 pikë përqindje në krahasim me Gusht 2021. Niveli aktual i TNE-së qëndron 104.4 pikë mbi mesataren afatgjatë⁶ (në nivelin 100) vijon të qëndrojë mbi mesataren historike, dhe rreth 4.6 pikë përqindje mbi mesataren e 5 viteve të fundit (gusht 2017 – gusht 2022) (në figurën 1 ilustrohet vetëm mesatarja historike me vijë të drejtë). Rënia e TNE-së u përcaktua nga përkeqësimi i besimit në industri, ndërtim, shërbime dhe tregti. Ndërkohë, treguesi i besimit të konsumatorëve regjistroi pothuajse të njëjtat vlera si një muaj më parë.

Figura 2: Treguesi i Ndjesisë Ekonomike

⁵ Duke filluar nga muaji maj 2021, seritë kohore të vërtetimit të besimit do të publikohen për herë të parë me frekuencë mujore (me përjashtim të pyetjeve të cilat do vijojnë të kryhen vetëm me frekuencë tremujore).


⁶ Vija tek niveli 100 përfaqëson mesataren afatgjatë



Burimi: Banka e Shqipërisë, Shtator 2022

Indeksi i Tregtisë me Pakicë gjatë tremujorit të dytë të vitit 2022 në terma *Volumi*, krahasuar me të njëjtin tremujor të vitit të mëparshëm, u rrit me **+6.1%**. Gjithashtu Indeksi i Tregtisë me Pakicë gjatë tremujorit të dytë të vitit 2022 në terma *Vlere*, krahasuar me të njëjtin tremujor të vitit të mëparshëm, u rrit me **+22.7%**.

Figura 3: Rritja e vlerës të tregtisë me pakicë (vit-më-vit, në %)



Burimi: Instat, MFE, Shtator 2022

Në gusht 2022, eksportet e mallrave arritën vlerën 35.19 mld lekë, duke u rritur me 48.1%, në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë dhe duke rënë me 10.8% në krahasim me korrik 2022. Rritja vjetore e eksporteve prej 48.1%, këtë muaj është ndikuar nga grupet: “Minerale lëndë djegëse, energji elektrike” me kontribut +19.4 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me +14.8 pikë përqindje.

Në gusht 2022 importet e mallrave arritën vlerën 79.57 mld lekë, duke u rritur me 30.8%, në krahasim me një vit më parë dhe duke rënë me 2.57%, në krahasim me korrik 2022. Rritja vjetore e importeve prej 30.8%, këtë muaj është ndikuar kryesisht nga grupet: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me +20.3 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me kontribut +2.6 pikë përqindje.

Tabela 6: Eksportet dhe Importet për periudhën Janar- Gusht 2022 (krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit më parë).


| | Eksporte | | Importe | |
|---------------------------------------|-------------|---------------------|-------------|---------------------|
| | Rritja në % | Kontibuti në rritje | Rritja në % | Kontibuti në rritje |
| Ushqime, pije, duhan | 15.0 | 1.9 | 10.1 | 2.1 |
| Minerale, lëndë djegëse, en.elektrike | 104.9 | 19.4 | 157.1 | 20.3 |
| Produkte kimike dhe plastike | 25.0 | 0.7 | 10.5 | 1.4 |
| Lëkurë dhe artikujt prej tyre | 68.6 | 0.3 | 14.1 | 0.2 |
| Prodhime druri dhe letre | 51.9 | 1.6 | 18.7 | 0.7 |
| Tekstile dhe këpucë | 23.0 | 5.6 | 16.6 | 1.4 |
| Materiale ndërtimi dhe metale | 55.4 | 14.8 | 18.8 | 2.6 |
| Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi | 43.6 | 3.4 | 5.8 | 1.3 |
| Të tjera | 9.9 | 0.3 | 18.9 | 0.8 |
| Gjithsej | 48.1 | 48.1 | 30.7 | 30.7 |

Burimi: Instat, Shtator 2022

Gjatë muajit Korrik të vitit 2022 *stoku total i depozitave bankare* ka shënuar rritje me 7.3% krahasuar me Korrikun e vitit 2021. Stoku total i depozitave në Lekë pësoi rritje me 2.0%, ndërsa ai në valutë është rritur me 11.9% krahasuar me të njëjtin muaj të vitit 2021. Gjatë muajit korrik të vitit 2022, *stoku total i kredive bankare* pati një rritje me 12%, krahasuar me muajin korrik të vitit 2021.

Stoku i kredive në lekë shënoi një rritje prej 8.8%, ndërsa ai në valutë rritje prej 15.6%, krahasuar me muajin korrik të vitit të kaluar.



Figura 4: (a) Ecuria e rritjes së stokut total të depozitave, në %, në terma vjetorë; (b) Ecuria e rritjes së stokut total të kredive, në %, në terma vjetorë.



Burimi: Banka e Shqipërisë, Shtator 2022

Sipas opinionit të bankave tregtare, standardet e kreditimit për bizneset u shtrënguan në tremujorin e dytë të vitit 2022. Ato u perceptuan me shtrëngim të standarteve për biznesin e vogël dhe të mesëm në nivelin -1.8%, për biznesin e madh në nivelin -2.3%, për kredinë dhënë me qëllim investimi u shtrëngua në nivelin -8.1%, dhe për likuiditet në nivelin -1.9%. Ndërkohë, *standartet për kredinë dhënë individëve* gjatë tremujorit të dytë 2022 për blerje banese u lehtësuan në nivelin 11.8%, ndërsa për kredinë dhënë individëve për konsum gjatë tremujorit të dytë 2022 u lehtësuan në nivelin 4.8%.

Figura 5: (a) Lehtësimi (+) Shtrëngimi (-) Standardeve Kredisë për Biznesin - [Investime]; b) Lehtësimi (+) Shtrëngimi (-) Standardeve të Kredisë për Individët - [Konsum]



9.2 ZHVILLIMET FISKALE GJATË 9-MUJORIT 2022

Të ardhurat tatimore totale për 9 mujorin 2022, u realizuan në vlerën 292.8 miliardë lekë, 21.7% ose 52.3 miliardë lekë më shumë se 9 mujori i vitit 2021 dhe 0.9% ose 2.6 miliardë lekë më shumë se plani 9 mujor i vitit 2022.

Nga totali i të ardhurave, të ardhurat e arkëtuara nga “tatimet dhe doganat” (përfshirë kontributet e mbledhura nga DPT) për 9 mujorin 2022, u realizuan në vlerën 379.9 miliardë lekë, 19.1% ose 60.8 miliardë lekë më shumë se 9 mujori 2021 dhe 1.1% ose 4 miliardë lekë më shumë se plani 9 mujor i vitit 2022.

Tabela 18 Performanca Tatime+Dogana dhe Kontributet Janar-Shtator 2022

(në milionë lekë)


| Lloji i taksave | Fakt 9M 2022 | Plan 9M 2022 | Diferenca Fakt/Plan 2022 | |
|--|----------------|----------------|--------------------------|--------------|
| | | | në vlerë | në % |
| 1. TVSH Neto TOTAL | 143,915 | 139,515 | 4,400 | 3.2% |
| a. Tvsh në import | 115,465 | 112,914 | 2,551 | 2.3% |
| b. Tvsh brenda vendit Neto | 28,450 | 26,601 | 1,849 | 7.0% |
| c. Rimbursim TVSH | 13,762 | 13,644 | 118 | 0.9% |
| 2. Tatimi mbi fitimin | 33,960 | 33,650 | 310 | 0.9% |
| 3. Akciza | 39,395 | 40,102 | -707 | -1.8% |
| 4. Tatimi mbi të ardhurat personale | 34,298 | 35,108 | -810 | -2.3% |
| 5. Taksat Nacionale Total | 34,913 | 35,584 | 653 | 1.8% |
| a. Taksat nacionale | 31,603 | 32,222 | -619 | -1.9% |
| b. Renta Minerare në eksport | 3,310 | 3,362 | -52 | -1.5% |
| 6. Taksë doganore | 6,275 | 6,207 | 68 | 1.1% |
| TOTAL TATIME + DOGANA | 292,756 | 290,166 | 2,590 | 0.9% |
| 7. Kontributet e mbledhura (DPT) | 87,111 | 85,652 | 1,459 | 1.7% |
| TOTAL DPD + DPT (Kontributet) | 379,867 | 375,818 | 4,049 | 1.1% |

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022)

Faktorët kryesorë që kanë ndikuar në performancën e 9 mujorit kundrejt planit janë:

- ✓ Mireadministrimi, lufta ndaj informalitetit dhe kontrolli i zinxhirit të transaksioneve ndërmjet operatorëve.
- ✓ Zgjerimi i aktivitetit ekonomik, duke u mbështetur nga performanca e mirë e sektorit privat dhe nga kërkesa e brendshme.
- ✓ Rritja e aktivitetit ekonomik I cili ka çuar në rritje të tregtisë që ka nxitur më tej rritjen ekonomike.
- ✓ Performanca e mirë e sektorit të ndërtimit ne vijim të masave të suksesshme të qeverisë në lidhje me investimet në kuadër të rindërtimit pas tërmetit, si dhe investimeve në infrastrukturë, të cilat kanë ndikuar në rritjen e qarkullimit, të importeve, prodhimit të brendshëm si dhe të ardhurave në buxhetin e shtetit.

Grafiku 13 Performanca e të ardhurave tatimore dhe doganore (përfshirë kontributet) 2021/2022



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022)

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për 9-mujorin e vitit 2022, ka arkëtuar 164.4 miliardë lekë, me një rritje krahasuar me vitin 2021, në masën 28.5 miliardë lekë ose 21% dhe me realizim kundrejt planit në masën 101.1%. Performanca pozitive krahasuar me planin ku vlen të theksohet rritja e volumit të importeve shoqëruar me rritjen së çmimeve të mallrave në tregjet ndërkombetare çka ndikon pozitivisht në të ardhura nga veprimtaria doganore.

Të ardhurat nga “TVSH”-ja në import janë realizuar në vlerën 115,5 miliardë lekë, me realizim në masën 102.3% kundrejt planit të periudhës. Ekzistojnë një sërë faktorësh që kanë ndikuar në realizimin e performancës së tatimit mbi vlerën e shtuar. Rritja e çmimeve të mallrave të importit por edhe rritja e importeve të taksueshme, ka ndikuar direkt në rritjen e arkëtimeve të TVSH-së në import. Produktet doganore si karburant import, metalet bazë dhe energjia elektrike të cilat zënë peshë të konsiderueshme rreth 36.1% në strukturën e të ardhurave të TVSH-së, kanë dhënë një efekt pozitiv me + 13 miliardë lekë, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të mëparshëm.

Të ardhurat nga “Akciza” janë realizuar në vlerën 39.4 miliardë lekë, me realizim kundrejt planit në masën 98.2%. Ndikim të rëndësishëm pozitiv në të ardhurat nga akciza kanë pasur produktet Cigare, me një rritje 199 mijë ton, (+14.6%) më shumë se viti i kaluar, me efekt në të ardhurat e akcizës +2 miliard lekë, ose 14.6%, Gazi I lënget, me një rritje 1.3 mij ton, (+61.6%) më shumë se viti i kaluar, me efekt në të ardhurat e akcizës +190 milionë lekë. Ndër produktet e akcizueshme që kishin ndikim negativ janë Karburant Import me një rënie prej -42.1 ton (-9.1%) krahasuar me një vit më parë, me efekt negative në akcizë me -1,2 miliardë lekë.

Të ardhurat nga “Renta Minerare” në eksport janë realizuar në vlerën 3.3 miliardë lekë, me realizim në masën 98.5% kundrejt planit. Gjatë 9 mujorit të vitit 2022 krahasuar me vitin e kaluar, të ardhurat nga renta minerare për naftën bruto kanë pësuar rritje si rezultat i rritjes së çmimit të naftës bruto në tregjet ndërkombëtare, ka sjellë një efekt +1.2 miliardë lekë. Ndërkohë, edhe të ardhurat nga mineralet e eksportuara kanë pësuar rritje për shkak të rritjes së çmimit në tregjet ndërkombëtare në masën 391 milionë lekë ose 113% krahasuar me 9 mujorin e vitit 2021.

Të ardhurat nga “Taksa Doganore” janë realizuar në vlerën 6,3 miliardë lekë, me realizim në masën 101.1% me planin e periudhës. Vlera e importi të taksuar për 9 mujorin 2022, është rritur me 31% krahasuar me periudhën Janar-Shtator 2021. Peshën më të madhe në taksën doganore e zënë produktet si mish (13%), gaz i lengshem (13%), cigaret (9%), metalet baze dhe artikujt prej tyre (8%).

Të ardhurat e mbledhura nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (përfshirë kontributet) për 9 mujorin e vitit 2022 janë realizuar në vlerën 215.4 miliardë lekë, 32.3 miliardë lekë ose 17.6% më shumë se e njëjta periudhë e një viti më parë dhe realizim të planit të 9 mujorit në masën 101%.

Të ardhurat nga TVSH-ja brenda vendit janë realizuar në vlerën 28.5 miliardë lekë, ose 1.8 miliard lekë më shumë se plani. Rimbursimi i TVSH është realizuar në vlerën 13.8 miliardë lekë, 0.9% ose 118 milionë lekë më shumë se plani për 9 mujorin e vitit 2022. Sektorët me kontribut pozitiv krahasuar me 9 mujorin e vitit 2021 janë; sektori i ndërtimit dhe i shërbimit.

Të ardhurat nga “Tatimi mbi Fitimin” janë realizuar në vlerën 34 miliardë lekë, me realizim 0.9% ose 310 milionë lekë më shumë se plani. Nga analiza e tatimit mbi fitimin sipas sektorëve rezulton sektori i shërbimit me rritje 27% krahasuar me 9-mujorin e vitit 2021, sektori i prodhimit me rritje 64% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të mëparshëm dhe sektori i tregëtisë me rritje 36% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të mëparshëm

Nga tatimi mbi të ardhurat personale janë realizuar në vlerën 34.3 miliardë lekë, ose 810 milionë lekë më pak se plani. Ndikim të rëndësishëm në të ardhurat nga tatimi mbi të ardhurat personale kanë patur të ardhurat nga tatimi, shitja e pasurisë së paluajtëshme me rritje 113% krahasuar me 9-mujorin e vitit 2021 dhe të ardhurat nga tatimi mbi dividentin dhe aksionet me rritje 23% krahasuar me 9-mujorin e vitit 2021.

Të ardhurat nga “Taksat Nacionale” janë realizuar në vlerën 31.6 miliardë lekë, me realizim në masën 98.1% e planit të periudhës. Peshën më të madhe në të ardhurat e taksës nacionale e zë taksa e qarkullimit

rrugor me 50% të totalit të taksës nacionale, e cila gjatë 9 mujorit 2022 ka pësuar rënie me 7% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2021, si rrjedhojë e rritjes së cmimit të karburanteve.

Të ardhurat nga “Kontributet e D.P.T-së” janë realizuar në vlerën 87.1 miliardë lekë, me realizim në masën 101.7% e planit të periudhës.

9.3 TË ARDHURAT E PRITSHME PËR VITIN 2022

Të ardhurat nga Tatimet, Doganat dhe Kontributet në vitin 2022, pritet të realizohen në nivelin 101.3% të programit të rishikuar. Krahasuar me vitin 2021, të ardhurat tatimore do jenë +71.1 miliard lekë më shumë, ose 16 % më të larta. Niveli i të ardhurave të vitit 2022 është impaktuar pozitivisht nga rigjallërimi i ekonomisë në vitin 2022, sidomos sektori privat. Ecurinë pozitive të të ardhurave si dhe vlerësimet e bëra bazuar në faktorët që do impaktojnë këtë periudhë si, importet, çmimet në rritje të zërave kryesor të të ardhurave në buxhetin e shtetit(energji elektrike dhe karburant).

Tabela 19

(në milionë lekë)

| Lloji i taksave | Plan 2022 | I Pritshmi | Diferenca | |
|--|----------------|----------------|-----------------|-------------|
| | | 2022 | I Pritshmi/Plan | Në % |
| 1. TVSH Neto TOTAL | 190,000 | 196,000 | 6,000 | 3% |
| <i>a. Tvsh në import</i> | 153,000 | 158,500 | 5,500 | 4% |
| <i>b. Tvsh brenda vendit Neto</i> | 37,000 | 37,500 | 500 | 1% |
| <i>c. Rimbursim TVSH</i> | 18,500 | 16,500 | -2,000 | -11% |
| 2. Tatimi mbi fitimin | 46,000 | 47,500 | 1,500 | 3.3% |
| 3. Akciza | 55,000 | 55,000 | 0 | 0% |
| 4. Tatimi mbi të ardhurat personale | 47,000 | 46,500 | -500 | -1% |
| 5. Taksat Nacionale Total | 48,500 | 41,500 | -7,000 | -14% |
| <i>a. Taksat nacionale</i> | 44,000 | 37,000 | -7,000 | -16% |
| <i>b. Renta Minerare në eksport</i> | 4,500 | 4,500 | 0 | 0% |
| 6. Taksë doganore | 8,500 | 8,500 | 0 | 0% |
| TOTAL TATIME + DOGANA | 395,000 | 395,000 | 0 | 0% |
| 7. Kontributet e mbledhura (DPT) | 113,655 | 120,500 | 6,845 | 6.0% |
| TOTAL DPD + DPT (Kontributet) | 508,655 | 515,500 | 6,845 | 1.3% |

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022)

Pritshmëria e të ardhurave nga Administrata Doganore

Të ardhurat e pritshme për vitin 2022, janë vlerësuar mbi bazën e performancës së të ardhurave në periudhën Janar-Shtator 2022, rezultateve pozitive, si dhe të faktorëve që do të ndikojnë në muajt në vijim.

Tabela 20

(në milionë lekë)

| Lloji i taksave | Plani Vjetor | I Pritshmi 2022 | Diferenca I Pritshem /Plan 2022 | Në % |
|--------------------------|----------------|-----------------|---------------------------------|-------------|
| 1. Tvsh në import | 153,000 | 158,500 | 5,500 | 3.6% |

| | | | | |
|-------------------------------------|----------------|----------------|--------------|-------------|
| 2. Akciza | 55,000 | 55,000 | 0 | 0% |
| 3. Renta Minerare ne eksport | 4,500 | 4,500 | 0 | 0% |
| 4. Taksë doganore | 8,500 | 8,500 | 0 | % |
| TOTAL DOGANA | 221,000 | 226,500 | 5,500 | 2.5% |

Burimi: *Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022)*

Performanca e të ardhurave nga TVSH në import është ndikuar në një masë të rëndësishme nga disa faktorë:

- Rritja e volumit të importeve, të cilat në 9 mujorin Janar-Shtator, janë rritur me 25 % krahasuar me 9 mujorin e vitit të kaluar.
- Rritja e çmimi të importit të energjisë elektrike, e cila gjatë 9 mujorit 2022 rezulton:
 - Rënie e sasisë me -52.5 mijë megaëatorë ose me -4% krahasuar me vitin e kaluar, shoqëruar me rritje të çmimit, me efekt 5 miliardë lekë ose rritje 200% të të ardhurave për njësi për tvsh-në.
- Rritje e çmimit të produktit karburant importi me efekt +4.5 miliardë lekë në të ardhurat për tvsh-në, ose rritje me 34% rritje në të ardhurën për njësi për tvsh-në.
- Rritja në çmim dhe ne sasi e importit të metaleve bazë dhe artikujt prej tyre, e cila gjatë 9 mujorit 2022 rezulton:
 - Rritje e sasisë me 62.4 mijë ton ose me 8.1% krahasuar me vitin e kaluar, shoqëruar me rritje të çmimit, me efekt 3.6 miliardë lekë ose rritje 23% të të ardhurave për njësi.

Në të ardhurat nga akciza pritet të arkëtohen mbi 55 miliard lekë, sa programi. Ecuria e 9 mujorit dhe perspektiva deri në fund të vitit ndikohet nga disa faktorë:

- Cigare për konsum, objekt akcize është rritur 9.3% ose 199 ton krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, me efekt në të ardhurat për akcizën +2 miliardë lekë ose 14.6% më shumë se 9 mujori 2021. Pritshmëria është që të realizohet objektivi vjetor i programuar.

Të ardhurat nga Renta Minerare në eksport për vitin 2022 pritet të jenë 4.5 miliardë lekë, në nivel realizimi 100% kundrejt planit. Të ardhurat nga renta minerare për naftën bruto janë rritur si rezultat i rritjes së sasisë së eksportuar, si dhe si rezultat i rritjes së çmimit të naftës bruto në tregjet ndërkombëtare krahasuar me vitin 2021, duke sjellë rritje të rentës për njësi nga 3,15 lekë/ton në 5,76 lekë/ton. Ndërkohë edhe të ardhurat nga mineralet e eksportuara kanë pësuar rënie për shkak të rritjes së çmimit të mineraleve në tregjet ndërkombëtare, e cila është shoqëruar edhe me uljen e sasisë së eksportuar me -239.8 mijë ton, krahasuar me vitin 2021.

Të ardhurat nga Taksa Doganore parashikohet të realizohen për 12-mujorin 2022 në masën 100% ndaj planit.

Pritshmëria e të ardhurave nga Administrata Tatimore

Të ardhurat e pritshme për vitin 2022 janë vlerësuar mbi bazën e performancës gjatë periudhës Janar-Shtator 2022, si dhe të faktorëve që do të ndikojnë në muajt në vijim.

Tabela 21

(në milionë lekë)

| Lloji i taksave | Plani Vjetor | I Pritshmi 2022 | Diferenca I Pritshem/Plan 2022 | Në % |
|-------------------------------------|----------------|-----------------|--------------------------------|--------------|
| 1. Tvsh brenda vendit Neto | 37,000 | 37,500 | 500 | 1.4% |
| Rimbursim TVSH | 18,500 | 16,500 | -2,000 | -10.8% |
| 2. Tatimi mbi fitimin | 46,000 | 47,500 | 1,500 | 3.3% |
| 3. Tatimi mbi të ardhurat personale | 47,000 | 46,500 | -500 | -1.1% |
| 4. Taksat nacionale | 44,000 | 37,000 | -7,000 | -15.9% |
| TOTAL TATIME | 174,000 | 168,500 | -5,500 | -3.2% |
| 5. Kontributet e mbledhura (DPT) | 113,655 | 120,500 | 6,845 | 6.0% |
| TOTAL DPT + Kontributet | 287,655 | 289,000 | 1,345 | 0.5% |

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022)

Të ardhurat nga Tatimi mbi Vlerën e shtuar brenda vendit pritet të realizohen në masën 37.5 miliardë lekë, me realizim në masën 101.4% kundrejt planit, ose 500 milionë lek më shumë. Krahasuar me planin, rimbursimi i TVSH-se ulet 10.8 % ose -2 miliard lekë.

Të ardhurat nga Tatimi mbi Fitimin pritet të realizohen në masën 47.5 miliardë lekë, me realizim 103.3% të planit vjetor të përcaktuar. Sektorët e ekonomisë me rritje në të ardhurat vihet re në sektorin e prodhimit, tregtisë dhe të shërbimit.

Tatimi mbi të Ardhurat Personale pritet të realizohen në masën 46.5 miliardë lekë, duke shënuar ulje me rreth 500 milion lekë ose 1.1% më pak se parashikimi. Ndikim të rëndësishëm në të ardhurat nga tatimi mbi të ardhurat personale kanë Tatim, shitja e pasurisë së paluajtshme me rritje 113% krahasuar me 9-mujorin e vitit 2021 si dhe të ardhurat nga tatimi mbi dividendin dhe aksionet me rritje 23% krahasuar me 9-mujorin e vitit 2021;

Të ardhurat nga Taksa Nacionale pritet të realizohen në masën 37 miliardë, duke shënuar një ulje prej 7 miliardë lekë ose 15.9% më pak se plani. Ndikim të rëndësishëm në uljen e të ardhurave qe vijnë nga taksa nacionale ka taksa e qarkullimit rrugor e cila zë 50% të totalit të taksës nacionale, dhe gjatë 9 mujorit 2022 ka pësuar rënie me 1.1 miliardë leke krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2021.

Të ardhurat nga Kontributet e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore priten të realizohen në masën 114 miliardë lekë, duke shënuar një realizim 106% te planit të parashikuar. Rezultatet me rritje të qëndrueshme në arkëtimin e kontributeve janë pasojë e përmirësimeve në luftën kundër informalitetit dhe punës së zezë, çka ka rritur numurin e të punësuarve.

Krahasimi me vitin 2021 për të Ardhurat Doganore, Tatimore dhe Kontributet e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore

Viti 2022 pritet të mbyllet me një performancë pozitive në të ardhura, duke shënuar një rritje me 71.1 miliardë lekë, ose 16% kundrejt vitit 2021. Rritja e të ardhurave tatimore tregon se tashmë ekonomia

shqiptare e ka marrë ritmin e saj të rritjes e ndikuar edhe nga rritja globale të çmimeve si pasojë e luftës në Ukrainë.

- Të ardhura nga TVSH-ja në import pritet të jenë +27.2 miliardë lekë ose +20.7% kundrejt vitit 2021.
- Të ardhura nga TVSH-ja brenda vendit Neto pritet të jenë +7.3 miliardë lekë ose +24% kundrejt vitit 2021.
- Të ardhurat nga Tatimi mbi Fitimin, pritet të jenë +11,9 miliardë lekë, ose +33.4% kundrejt vitit 2021.
- Të ardhurat nga Tatimi mbi të Ardhurat Personale, pritet të jenë 7.2 miliardë lekë, ose +18.3% krahasuar me vitin 2021.
- Të ardhurat nga Akciza pritet të jenë +3.4 miliardë lekë ose +6.5% kundrejt vitit 2021.
- Të ardhurat nga Taksat Nacionale dhe të tjera pritet të jenë 1 miliardë lekë ose 2.4% me pak kundrejt vitit 2021.
- Të ardhurat nga Taksa Doganore pritet të jenë 1 miliardë lekë ose +14% kundrejt vitit 2021.
- Të ardhurat nga kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore pritet të jenë 14.2 miliardë lekë ose +13.4% kundrejt vitit 2021.

Tabela 22

(në milionë lekë)

| Lloji i taksave | I Pritshmi 2022 | Fakt | Diferenca | Në % |
|--|-----------------|----------------|----------------------------|------------|
| | | 2021 | I Pritshem2022 / Fakt 2021 | |
| 1. TVSH Neto TOTAL | 196,000 | 161,536 | 34,464 | 21% |
| <i>a. Tvsh në import</i> | 158,500 | 131,301 | 27,199 | 20.7% |
| <i>b. Tvsh brenda vendit Neto</i> | 37,500 | 30,235 | 7,265 | 24% |
| <i>c. Rimbursim TVSH</i> | 16,500 | 24,102 | -7,602 | -32% |
| 2. Tatimi mbi fitimin | 47,500 | 35,610 | 11,890 | 33.4% |
| 3. Akciza | 55,000 | 51,637 | 3,363 | 6.5% |
| 4. Tatimi mbi të ardhurat personale | 46,500 | 39,312 | 7,188 | 18.3% |
| 5. Taksat Nacionale Total | 41,500 | 42,521 | -1,021 | -2.4% |
| <i>a. Taksat nacionale</i> | 37,000 | 40,076 | -3,076 | -7.7% |
| <i>b. Renta Minerare në eksport</i> | 4,500 | 2,445 | 2,055 | 84.0% |
| 6. Taksë doganore | 8,500 | 7,457 | 1,043 | 14.0% |
| TOTAL TATIME + DOGANA | 395,000 | 338,073 | 56,927 | 17% |
| 7. Kontributet e mbledhura (DPT) | 120,500 | 106,266 | 14,234 | 13.4% |
| TOTAL DPD + DPT (Kontributet) | 515,500 | 444,339 | 71,161 | 16% |


Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022)

9.4 ANALIZA E SHPENZIMEVE BUXHETORE PËR PERIUDHËN JANAR-SHTATOR 2022

9.4.1 BUXHETI QENDROR

Shpenzimet e përgjithshme publike, për periudhën tetë mujore të vitit 2022, arritën në rreth 362.4 miliard LEK me një realizim në masën 96.8 përqind të planit të periudhës ndërkohë që, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2021 ky zë ka rezultuar 1.6 përqind më i lartë ose rreth 5.8 miliard LEK më shumë. Në terma vjetorë, shpenzimet e përgjithshme për 8 mujorin e vitit 2022 u realizuan në masën 56.8 përqind të planit vjetor sipas Buxhetit Fillestar dhe 54.9 përqind të planit vjetor sipas Aktit Normativ nr.12, datë 29.07.2022 (AN nr.12).

Grafiku 14: Shpenzimet e përgjithshme korrente dhe kapitale (miliardë LEK) dhe ritmi i rritjes për periudhën 8 mujore (në %)




Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022)

a. Shpenzimet sipas natyrës ekonomike

Shpenzimet korente dhe ato kapitale, për periudhën 8 mujore kanë shënuar një realizim respektivisht:

- ✓ Shpenzimet korente 98 përqind të planit të periudhës, 59.8 përqind të planit vjetor fillestar dhe 60.1 përqind të planit vjetor sipas AN nr.12.
- ✓ Shpenzimet kapitale 89.1 përqind të planit të periudhës, 36 përqind të planit vjetor fillestar dhe 38.3 përqind të planit vjetor sipas AN nr.12.

Grafiku 15: Shpenzimet korente dhe kapitale fakt dhe plan 8 mujor (në milionë LEK)




Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022)

Shpenzimet korente për periudhën 8 mujore të vitit 2022 rezultuan në rreth 303.4 miliard LEK, ndërsa krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë ky zë ka rezultuar 2.7 përqind më i lartë ose rreth 8.07 miliard LEK më shumë. Shpenzimet korente për muajin e tetë të vitit 2022 zënë 83.7 përqind të totalit të shpenzimeve ndërkohë që, krahasuar me PBB zënë 16.2 përqind. Për shpenzimet korente, për periudhën 8 mujore ndër vite, raporti kundrejt PBB ka një nivel mesatar prej 15.8 përqind.

Shpenzimet kapitale për periudhën 8 mujore të vitit 2022 paraqesin një realizim në masën rreth 43.05 miliard LEK. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2021, ky zë rezulton 28.9 përqind më i ulët ose rreth 17.5 miliard LEK më pak. Shpenzimet kapitale për muajin e tetë të vitit 2022 zënë 11.9 përqind të totalit të shpenzimeve ndërkohë që, krahasuar me PBB zënë 2.3 përqind. Për shpenzimet kapitale, për periudhën 8 mujore ndër vite, raporti kundrejt PBB ka një nivel mesatar prej 2.8 përqind.

Grafiku 16: Struktura e shpenzimeve të përgjithshme dhe raporti me PBB-në për periudhën 8 mujore




Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022)

Shpenzimet korente në raport me planin 8 mujor të këtij viti, paraqesin një realizim prej rreth 98 përqind, duke rezultuar në rreth 303.4 miliard LEK. Zërat kryesorë që ndikuan në nivelin e realizimit të shpenzimeve korente kundrejt planit 8 mujor janë përkatësisht:

- ✓ *Shpenzimet e tjera sociale me 99.6 përqind të planit të periudhës, 65.8 përqind të planit vjetor sipas buxhetit fillestar dhe të ndryshuar me AN nr.12.*
- ✓ *Shpenzimet për fonde speciale me 99.4 përqind të planit të periudhës, 64.1 përqind të planit vjetor sipas buxhetit fillestar dhe të ndryshuar me AN nr.12.*
- ✓ *Shpenzimet për interesa me 98.6 përqind të planit të periudhës, 52 përqind të planit vjetor sipas buxhetit fillestar dhe të ndryshuar me AN nr.12.*


Grafiku 17: Struktura e shpenzimeve korente (milionë LEK)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022)

Shpenzimet e Personelit për periudhën 8 mujore të vitit 2022, përfaqësuan 18.2 përqind të totalit të shpenzimeve korente. Niveli i shpenzimeve faktike të personelit prej rreth 55.2 miliard LEK, realizon nivelin e parashikuar për këtë zë në planin e periudhës 8 mujore, në masën 98 përqind. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2021, ky zë është 0.1 përqind më i ulët ose 35 milion LEK më pak.


Grafiku 18: Shpenzimet e Personelit dhe ritmi i rritjes së tyre (në miliard LEK)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022)

Shpenzimet për Interesa për periudhën 8 mujore të vitit 2022 kanë përfaqësuar 8.7 përqind të shpenzimeve korente. Niveli faktik i tyre prej rreth 26.4 miliard LEK ka rezultuar në masën 98.6 përqind të planit të periudhës. Në raport me planin vjetor, në nivel 8 mujori këto shpenzime janë realizuar në masën 52 përqind të planit vjetor sipas buxhetit fillestar dhe të ndryshuar. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2021, ky zë ka rezultuar 4.1 përqind më i lartë ose rreth 1.04 miliard LEK më shumë.


Grafiku 19: Shpenzimet për Interesa (në miliard LEK)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022)

Shpenzimet Operative & Mirëmbajtje, gjatë periudhës 8 mujore të vitit 2022, kanë shënuar një realizim në masën rreth 33.4 miliard LEK ose 95.1 përqind të planit të periudhës. Niveli faktik i tyre ka rezultuar në masën 52.7 përqind të planit vjetor sipas Buxhetit fillestar dhe 52.8 përqind të planit vjetor sipas AN nr.12. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2021, ky zë ka rezultuar rreth 0.5 përqind më i lartë ose 163 milion LEK më shumë.


Grafiku 20: Shpenzimet Operative e Mirëmbajtje dhe ritmi i rritjes së tyre (në miliard LEK)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022)

Shpenzimet për Subvencione, gjatë periudhës 8 mujore të vitit 2022, arritën nivelin 702 milion LEK, me një realizim në masën 83.3 përqind të planit të periudhës. Në raport me planin vjetor, ky zë është realizuar në masën 45.3 përqind të planit vjetor sipas buxhetit fillestar dhe 41.5 përqind të planit të ndryshuar me AN nr.12. Kundrejt të njëjtës periudhë të vitit 2021 shpenzimet për subvencione rezultojnë 1.1 përqind më të ulëta ose 8 milion LEK më pak.

Grafiku 21: Shpenzimet për Subvencione dhe ritmi i rritjes së tyre (në miliard LEK)




Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022)

Shpenzimet për Fondet Speciale për periudhën 8 mujore të vitit 2022 rezultuan në nivelin rreth 136 miliard LEK, me një realizim prej 99.4 përqind kundrejt planit të periudhës, 64.1 përqind të planit vjetor fillestar dhe të ndryshuar. Përkatësisht:

- shpenzimet për sigurime shoqërore u realizuan në masën rreth 101.6 miliard LEK,
- shpenzimet për sigurime shëndetësore në rreth 33.1 miliard LEK dhe
- shpenzimet për kompensimin e pronarëve në rreth 1.2 miliard LEK.

Kundrejt të njëjtës periudhë të vitit 2021, shpenzimet për sigurime shoqërore janë rreth 6.2 miliard LEK më të larta, shpenzimet për sigurime shëndetësore janë 979 milion LEK më të larta dhe shpenzimet për kompensimin e pronarëve janë 442 milion LEK më të ulëta.

Grafiku 22: Shpenzimet për Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore (në miliard LEK)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022)


Shpenzimet për Papunësinë për 8 mujorin e vitit 2022 janë realizuar në masën 480 milion LEK ose 93.1 përqind e planit të periudhës dhe 53.3 përqind e planit vjetor sipas buxhetit fillestar dhe të ndryshuar. Kundrejt të njëjtës periudhë të vitit 2021 shpenzimet për këtë zë rezultojnë me një ulje në masën 32.4 përqind, ose 230 milion LEK më pak.

Shpenzimet për Ndhimën Ekonomike dhe Pagesën e Paaftësisë (PAK) për periudhën 8 mujore të vitit 2022 u realizuan në masën rreth 15.3 miliard LEK duke rezultuar 99.1 përqind e planit të periudhës. Në raport me planin vjetor, këto shpenzime janë realizuar në masën 65 përqind e planit vjetor sipas buxhetit fillestar dhe të ndryshuar. Kundrejt të njëjtës periudhë të vitit 2021 shpenzimet për këtë zë rezultojnë me një ulje në masën 2.3 përqind ose 353 milion LEK më pak në terma nominalë.

Shpenzimet për kompensimin e ish-të përndjekurve politik për periudhën 8 mujore të vitit 2022 u realizuan në masën 390 milion LEK duke rezultuar rreth 80.3 përqind e planit të periudhës. Në raport me planin vjetor, këto shpenzime janë realizuar në masën 39 përqind të planit vjetor sipas buxhetit fillestar dhe të ndryshuar me AN nr.12. Kundrejt të njëjtës periudhë të vitit 2021 shpenzimet për këtë zë rezultojnë me një ulje në masën 16.4 përqind ose 77 milion LEK më pak.

Shpenzimet për bonusin e lindjeve për periudhën 8 mujore të vitit 2022 u realizuan në masën 2 miliard LEK duke rezultuar 111.1 përqind e planit të periudhës ose 90.9 përqind e planit vjetor sipas buxhetit fillestar dhe të ndryshuar me AN nr.12. Kundrejt të njëjtës periudhë të vitit 2021 shpenzimet për këtë zë rezultojnë një ulje në masën 9.1 përqind ose 200 milion LEK më pak.


Grafiku 23: Shpenzimet për Ndhimën Ekonomike, PAK dhe Papunësinë (në miliard LEK)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022)

Shpenzimet për Pushtetin Vendor, gjatë periudhës 8 mujore të vitit 2022 kanë arritur në masën rreth 33.6 miliard LEK duke përbërë 11.1 përqind të totalit të shpenzimeve korente. Këto shpenzime janë realizuar në masën 94.4 përqind e planit të periudhës ose 55.7 përqind e planit vjetor sipas buxhetit fillestar dhe të ndryshuar. Kundrejt të njëjtës periudhë të vitit 2021 ky nivel rezulton 3.3 përqind më i lartë ose rreth 1.07 miliard LEK më shumë.

Grafiku 24: Shpenzimet e Pushtetit Vendor dhe ritmi i rritjes së tyre (në miliard LEK)




Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022)

Shpenzimet kapitale, për periudhën 8 mujore të vitit 2022 kanë një realizim në masën rreth 43.05 miliard LEK ose 89.1 përqind në raport me fondet e planifikuara për këtë periudhë. Financimi i brendshëm është realizuar në masën rreth 20.3 miliard LEK ose 85.6 përqind në raport me fondet e planifikuara për këtë periudhë. Investimet nga të ardhurat e arsimit të lartë janë realizuar në masën 495 milion LEK ose 88.7 përqind të planit të periudhës. Financimi i huaj ka shënuar një realizim prej rreth 10.4 miliard LEK ose 86.7 përqind të planit të periudhës. Fondi i rindërtimit është realizuar në masën rreth 11.9 miliard LEK ose 98.5 përqind në raport me fondet e planifikuara për këtë periudhë. Nga shpenzimet për fondin e rindërtimit rreth 3.9 miliard LEK janë shpenzime nga Qeverisja Qendrore dhe 7.95 miliard LEK janë shpenzime nga Qeverisja Vendore.

Krahasuar me planin vjetor 2022, për 8 mujorin e vitit 2022, shpenzimet kapitale janë realizuar në masën 36 përqind të planit vjetor sipas buxhetit fillestar dhe 38.3 përqind të planit vjetor sipas AN nr.12. Financimi i brendshëm është realizuar në masën 32.3 përqind të planit vjetor sipas buxhetit fillestar dhe 34.7 përqind të planit vjetor të ndryshuar me AN nr.12. Investimet nga të ardhurat e arsimit të lartë janë realizuar në masën 49.5 përqind të planit vjetor fillestar dhe të ndryshuar. Financimi i huaj është realizuar në masën 30.1 përqind të planit vjetor sipas buxhetit fillestar dhe 30.6 përqind të planit vjetor të ndryshuar me AN nr.12. Fondi i rindërtimit është realizuar në masën 59.4 përqind të planit vjetor fillestar dhe të ndryshuar.

Grafiku 25: Shpenzimet Kapitale dhe burimi i financimit të tyre (në miliard LEK)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022)

FONDI I RINDËRTIMIT prej 20 000 milionë LEK, është përdorur sipas përcaktimeve të Ligjit nr.115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, të ndryshuar”, për të përballuar kostot e financimit të (i) projekteve të miratuara dhe të pafinancuara në vitin 2021, si dhe (ii) të projekteve të reja në vitin 2022.

Projektet për t’u financuar nga viti 2021 janë rreth 9.8 miliard LEK, nga të cilat:

- ✓ Rreth 9 501.6 milion LEK janë për projekte të Qeverisjes Vendore; dhe
- ✓ Rreth 378.7 milion LEK janë për projekte të Qeverisjes Qendrore.

Ndërkohë, rreth 10 miliard LEK janë akorduar për financimin e projekteve të reja të vitit 2022, në zbatim të Vendimeve përkatëse të Këshillit të Ministrave.

Fondi i Rindërtimit për 8 mujorin e vitit 2022 është realizuar në masën 11.8 miliard LEK. Nga ky realizim, rreth 8 miliard LEK janë shpenzime të Qeverisjes Vendore dhe 3.8 miliard LEK të Qeverisjes Qendrore.

FONDI REZERVË

Fondi Rezervë, i miratuar me Ligjin nr. 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, të ndryshuar, në masën 3.35 miliardë lekë, është parashikuar të përdoret me vendim të Këshillit të Ministrave për raste të paparashikuara të njëjësive të qeverisjes së përgjithshme.

Deri në fund të periudhës 9 mujore 2022 ky fond është përdorur si më poshtë:

Fondi Rezervë për raste të paparashikuara të njësisve të qeverisjes së përgjithshme është përdorur nëpërmjet 11 Vendimeve të Këshillit të Ministrave (VKM) me vlerë totale prej rreth 1.837 miliard lekësh, nga 3.35 miliard lekë të planifikuara ose në rreth 55% përqind të planit. Nga këto:

- ✓ 53.1 milion lekë janë përdorur për shpenzime personeli
- ✓ 1 508.2 milion lekë janë përdorur për shpenzime të tjera korrente (shpenzime operative dhe transfera të brendshme),

Gjendja e papërdorur e fondit rezervë të buxhetit të shtetit, në fund të 9 mujorit 2022, rezulton rreth 1.5 miliard lekë.

Fondi kontigjencës për Paketën e rezistencës sociale ndaj pasojave të krizës.

Gjatë vitit 2022 nëpërmjet rishikimeve të buxhetit me AN nr. 3, datë 12.03.2022 dhe Nr. 12, datë 29.07.2022, janë akorduar fonde shtesë për t'iu përgjigjur krizës energjetike dhe krizës nga çmimet e mallrave.

Nëpërmjet Aktit Normativ Nr.3 datë 12.03.2022 “Për disa ndryshime në Ligjin nr.115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, u miratua:

- *Akordimi i mbështetjes buxhetore për sektorin e energjisë, prej 20 miliard lekë;*
- *Financimi i një fondi kontigjencë për Paketën e Rezistencës Sociale ndaj Pasojave të Krizës, prej 6 miliard lekë:*
 - ✓ *Fondi prej 5 miliard lekë është përdorur me anë të VKM nr. 159 datë 12.03.2022 “Për mbështetjen financiare të disa kategorive të veçanta për zbutjen e efekteve të ndikuara nga lufta në Ukrainë”, konkretisht:*
 - *MSHMS-së iu akordua fondi për 1.116 miliard lekë për mbështetjen e kategorive që përfitojnë ndihmë ekonomike dhe pagesë të aftësisë së kufizuar;*
 - *ISSH iu akordua fondi prej 3.883 miliard lekë për mbështetjen e kategorive të personave që përfitojnë pensione.*
 - ✓ *Me anë të VKM nr. 225, datë 13.4.2022, “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës së kompensimit për shoqëritë e linjave të transportit qytetase, rrethqytetase dhe ndërqytetase, pjesë e paketës antikrizë”, u miratua kompensimi i shoqërive të transportit për linjat qytetëse, rrethqytetëse dhe ndërqytetëse në masën 100 lek për litër, për një periudhë tre mujore (mars-maj 2022). Efekti financiar është në vlerën 430 milionë lekë.*
 - ✓ *Nëpërmjet VKM nr.245, datë 20.4.2022 “Për disa ndryshime në VKM nr.101 datë 09.02.2022 “Për përcaktimin e kriterëve bazë, të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së përfitimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, për vitin 2022”, u miratua akordimi i 500 milionë lekë shtesë për mbështetjen e sektorit të bujqësisë, për tu përdorur në skemën mbështetëse të naftës.*

Nëpërmjet Aktit Normativ Nr.12 datë 29.07.2022 “Për disa ndryshime në Ligjin nr.115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022, i ndryshuar”, u miratua:

- *Shtirja e financimit të paketës së parë të ndihmës për konsumatorët, të akorduar përmes AN nr.3/2022, me qëllim përballimin e mëtejshëm të pasojave të rritjes së çmimeve të konsumit, nëpërmjet alokimit sërish të një fondi kontigjencë për Paketën e Rezistencës Sociale ndaj pasojave të krizës, me kosto 6.1 miliard lekë.*

9.4.2 BUXHETI VENDOR


Me miratimin e Ligjit nr.68, datë 27.04.2018 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, procesi i menaxhimit të financave publike në nivel vendor, ka hyrë në një fazë të re konsolidimi. Në këtë kuadër, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ndjek vazhdimisht treguesit e të ardhurave dhe shpenzimeve të buxhetit vendor, me qëllim monitorimin dhe asistencën e njëjësive të vetëqeverisjes vendore për përmirësimin e këtij procesi. Referuar të dhënave të treguesve fiskalë të konsoliduar për pushtetin vendor për 8 mujorin 2022, mund të themi se edhe gjatë 2022 buxheti vendor ka vazhduar rikuperimin dhe rimëkëmbjen, pas vitit 2020 që përbënte një vit përjashtimor për menaxhimin financiar publik në nivel vendor për shkak të situatës së krijuar nga pandemia COVID-19. Pavarësisht kësaj rritje, referuar situatës ekonomike globale të krijuar si pasojë e luftës në Ukrainë, gjendemi në një vit gjatë të cilit parashikohen vështirësi dhe sfida jo të pakta në aspektin ekonomik e financiar.

Bazuar në të dhënat e Sistemit Informatik Financiar të Qeverisë, është realizuar analiza e të ardhurave dhe shpenzimeve të 8 mujorit 2022 të buxhetit vendor.

Të ardhurat e Pushtetit Vendor

Konsolidimi financiar i pushtetit vendor gjatë 8 mujorit të vitit 2022 reflektohet në rritjen e kapacitetit fiskal nga të ardhurat e veta vendore, por gjithashtu dhe në përmirësimin menaxhimit financiar në nivel vendor përmes rritjes së shpenzimeve vendore në raport me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Për 8 mujorin e vitit 2022, njësitë e vetëqeverisjes vendore në shkallë kombëtare kanë mbledhur të ardhura në masën mbi 20 miliard lekë, shifër kjo që është rreth 1.6 miliard lekë më shumë se vlera e të ardhurave të mbledhura gjatë të njëjtës periudhë të vitit 2021. Rritja e efektshmërisë së mbledhjes së taksave nga pushteti vendor për vitin 2022 ka ardhur si pasojë e vendosjes së një stabiliteti në mbledhjen e taksave lokale që vazhdon të rritet nga viti në vit e po ashtu edhe si pasojë e rimëkëmbjes ekonomike pas një situatë të vështirë ekonomike të shkaktuar nga pandemia globale COVID-19 gjatë vitit 2020. Pavarësisht se në raport me planin e periudhës kemi një realizim më të ulët me rreth 2%, të ardhurat faktike vendore për 8 mujorin 2022 janë rritur me rreth 9% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Grafiku 26: Të ardhurat e përgjithshme të pushtetit vendor dhe ritmi i ndryshimit të tyre



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022)


Rikthimi i ekonomisë në prodhim dhe aktivitet normal ka nisur që prej mesit të vitit 2020 e në vazhdim dhe pritshmëria e rritjes së nivelit të arkëtimit të të ardhurave për njësitë e vetëqeverisjes vendore duket edhe në rezultatin e deritanishëm.

Ndër vite, të ardhurat e pushtetit vendor kanë pësuar ndryshime si në vlerë ashtu edhe në strukturën e burimit të tyre. Përmirësimi i treguesve fiskalë të pushtetit vendor gjatë 8 mujorit 2022 në drejtim të konsolidimit të burimeve të të ardhurave të veta vendore ka sjellë qëndrueshmëri të menaxhimit financiar publik në nivel vendor. Burimet kryesore të të ardhurave të veta gjatë kësaj periudhe kanë pësuar një rritje të konsiderueshme duke u bërë thelbësorë për financimin e shërbimeve nga njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Nga të ardhurat që sigurojnë njësitë e vetëqeverisjes vendore peshën më të madhe e zënë taksat lokale. Për 8 mujorin e parë të vitit 2022 të cilat zënë rreth 76.7% të shumës totale të të ardhurave. Nga ana tjetër nga taksa e pasurisë (ndërtesa, trualli dhe toka bujqësore) janë mbledhur rreth 4.6 miliard lekë apo rreth 23% e totalit të të ardhurave vendore. Taksa mbi biznesin e vogël (tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël dhe taksa vendore mbi biznesin e vogël) pas ndryshimeve fiskale ligjore të cilat e kanë zeruar atë (ligji nr.112/2020 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar”), ka ardhur drejt uljes duke zënë vetëm 0.3% të të ardhurave vendore në 8 mujorin 2022, të cilat përfaqësojnë detyrime të paguara me vonesë. Nga realizimi faktik gjatë 8 mujorit të vitit 2022, rezulton se nga ky zë janë mbledhur vetëm 53 milion lekë nga 345 milion lekë që u mbledhën një vit më parë, për arsye të reflektimit të efekteve nga zbatimi i ndryshimit ligjor të lartpërmendur i cili zeroi këtë taksë.

Në grafikun e mëposhtëm paraqiten nivelet e të ardhurave sipas llojit të taksave për të njëjtën periudhë për disa vite, të cilat kanë pësuar ndryshime si në vlerë ashtu edhe në strukturën e burimit të tyre.

Grafiku 27: Të ardhurat e pushtetit vendor sipas burimit



Burimi:

Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022)


Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka vënë vazhdimisht theksin, në drejtim të rritjes së raportit të të ardhurave nga taksat vendore ndaj transfertave të buxhetit qendror, si një tregues thelbësor i nivelit të decentralizimit fiskal të pushtetit vendor.

- **Taksa mbi Pasurinë**

Të ardhurat nga taksa mbi pasurinë përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të të ardhurave të pushtetit vendor. Për 8 mujorin e vitit 2022, kjo taksë zë 23 % të totalit të të ardhurave dhe është mbledhur në vlerën 4.6 miliardë lekë, ose rreth 3 % më shumë se e njëjta periudhë e vitit 2021. Parë në këndvështrimin e efencës, mbledhja e kësaj takse është me rritje nga viti në vit, me një performancë shumë të mirë gjatë vitit 2022, duke përmirësuar në këtë mënyrë menaxhimin e të ardhurave nga kjo taksë, përmes përdorimit

të metodologjisë së re së përlogaritjes mbi bazë vlere. Ministria e Financave dhe Ekonomisë, ka pjesë të objektivave rritjen e të ardhurave nga ky burim, përmes së cilave do t'i sigurojë pushtetit vendor konsolidimin e një burimi të rëndësishëm të të ardhurave dhe sigurisht një mundësi më të madhe për të zhvilluar investime publike në nivel vendor.

Grafiku 28: Të ardhurat nga taksa mbi pasurinë dhe ritmi i ndryshimit të tyre



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022)


- **Taksa e biznesit të vogël**

Siç e theksuam më lart, taksa mbi biznesin e vogël pas ndryshimeve fiskale ligjore është bërë zero (ligji nr.112/2020 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar”). Nga realizimi faktik gjatë 8 mujorit të vitit 2022, rezulton se nga ky zë janë mbledhur vetëm 53 milion lekë, që zënë vetëm 0.3% të të ardhurave vendore në 8 mujorin 2022, të cilat përfaqësojnë detyrime të paguara me vonësë.

- **Taksa lokale**

Të ardhurat nga taksat lokale kanë konsoliduar trendin në rritje nga viti në vit pas reformës administrativo-territoriale. Për 8 mujorin e vitit 2022 këto taksa janë mbledhur në vlerën 15.4 miliard lekë, pra rreth 1.8 miliard lekë më shumë se një vit më parë ose ndryshe rreth 13% rritje në raport me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Mbështetur në parashikimin fillestar mbi të ardhurat vendore, rezultati në mbledhjen e taksave lokale ka një diferencë me pritshmërit vetëm me 3% për 8 mujorin 2022. Megjithatë konstatojmë se rritja e kapaciteteve të krijuara nga njësitë e reja vendore dhe kontrolli më i mirë i shtrirjes territoriale, kanë filluar të japin efektin pozitiv të rritjes së mbledhshmërisë së taksave lokale duke ndikuar pozitivisht edhe në qëndrueshmërinë financiare të njësive të vetëqeverisjes vendore. Në një analizë më të thelluar të taksave lokale vërejmë se pjesën më të madhe të tyre e zë ‘taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja’ e cila zë 45.6% të taksave lokale ose rreth 35% të totalit të të ardhurave nga taksat dhe tarifat. Si rrjedhim, edhe rritja më e madhe e të ardhurave vendore vjen nga rritja e mbledhjes së kësaj takse me rreth 942.4 milion lekë, që vërehet sidomos në bashkitë e mëdha të vendit, si Tirana, Vlora, Saranda, Shkodra, etj.

Grafiku 29: Të ardhurat nga taksa lokale dhe ritmi i ndryshimit të tyre



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022)

- ***Të ardhura të tjera jotatimore të Pushtetit Vendor***


Për 8 mujorin e vitit 2022, njësitë e vetëqeverisjes vendore në shkallë kombëtare kanë mbledhur të ardhura jo tatimore në masën mbi 2 miliard lekë, shifër kjo që është rreth 191 milion lekë më shumë se vlera e të ardhurave të mbledhura gjatë të njëjtës periudhë të vitit 2021 prej 1,8 miliard lekë, ose ndryshe një realizim me rritje prej 10.5%.

Shpenzimet e Pushtetit Vendor

Shpenzimet e qeverisjes vendore janë një tregues i rëndësishëm i procesit të menaxhimit të financave publike në nivel vendor dhe tendencave zhvillimore të ekonomisë në tërësi pasi reflektojnë drejtpërdrejt këto tregues. Rritja e peshës së shpenzimeve të pushtetit vendor në raport me shpenzimet e buxhetit qendror apo ndaj produktit të brendshëm bruto përbëjnë një tregues të rëndësishëm të ecurisë pozitive të reformave në menaxhimin financiar në nivel vendor në drejtim të thellimit të decentralizimit fiskal. Ndër vite shpenzimet e qeverisjes vendore evidentohen si një tregues financiar në rritje dhe kjo vjen si pasojë e rritjes së nivelit të shërbimeve apo funksioneve që qeverisja vendore ofron për qytetarët, të financuara këto si nëpërmjet mbështetjes financiare nga qeveria qendrore po ashtu edhe rritjes së të ardhurave të veta vendore. Rritja e kompetencave dhe hapësirës administrative ka bërë që tashmë njësitë e vetëqeverisjes vendore të rrisin përgjegjësinë, transparencën e konsultimin publik, si dhe llogaridhënien në përdorimin e financave publike vendore, tregues këto të cilësisë së mirëmenaxhimit financiar publik në nivel vendor. Buxheti vendor ndër vite ka një rritje të dukshme që vjen si rrjedhojë e decentralizimit fiskal në aspektin e mbledhjes dhe përdorimit në mënyrë autonome të të ardhurave dhe rritjes së transfertave buxhetore nga qeveria qendrore. Konsolidimi i financimit të funksioneve të pushtetit vendor dhe menaxhimi i mirë i shpenzimeve është reflektuar gjatë kësaj periudhe në financimin e shërbimeve publike. Rritja e kapaciteteve administrative për mbulimin e shërbimeve publike ka fuqizuar ndjeshëm personelin e njësitë të vetëqeverisjes vendore për të arritur rezultate. Referuar treguesve fiskalë të buxhetit të konsoliduar, niveli i shpenzimeve për 8 mujorin e vitit 2022, është realizuar në masën rreth 33.6 miliard lekë. Në raport me planin e periudhës, shikojmë që ka një realizim më të ulët me rreth 2 miliard lekë ose rreth 6% më pak se plani i miratuar për 8 mujorin, megjithatë në raport me atë të 8 mujorit të vitit 2021, shpenzimet e qeverisjes vendore paraqiten me rritje prej rreth 1 miliard lekë ose 3.3%.

Grafiku i mëposhtëm në tërësi evidenton që buxheti i qeverisjes vendore tashmë është drejt konsolidimit duke mos paraqitur luhate të konsiderueshme dhe jo të logjikshme krahasuar nga viti në vit, ndryshim ky i cili vjen që prej vitit 2017.

Grafiku 30: Shpenzimet për pushtetin vendor dhe ritmi i ndryshimit të tyre




Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022)

Në 8 mujin 2022 në tërësi, të gjithë zërat e buxhetit vendor kanë pësuar rritje në raport me 8 mujin e vitit 2021, me përjashtim të shpenzimeve kapitale, të cilat rezultojnë me ulje rreth 11% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Peshën më të madhe të zërave të shpenzimeve e zënë ato për personelin me rreth 49% të totalit të shpenzimeve, më pas vjen zëri i shpenzimeve operative me rreth 30.5%, shpenzime të tjera korente rreth 3% dhe shpenzimet për investime të cilat zënë rreth 17.4% të totalit të shpenzimeve të pushtetit vendor në 8 mujin e vitit 2022.

Grafiku 31: Shpenzimet e pushtetit vendor sipas strukturës



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022)

Sic shikohet edhe nga grafiku më sipër për shpenzimet e pushtetit vendor sipas zërave buxhetorë konstatohet që për 8 mujin 2022 shpenzimet e personelit kanë pësuar një rritje të lehtë në vlerë, në raport me një vit më parë me rreth 501 milion lekë, ose rreth 3.1%. Megjithatë tashmë shpenzimet e personelit kanë marrë një natyrë të qëndrueshme në vite, tregues ky që reflekton mbylljen e periudhës tranzitore të konsolidimit të njësisve të reja vendore. Kjo reflektohet edhe në përqindjen që këto shpenzime zënë kundrejt buxhetit total me rreth 48.8% që është e njëjtë me vitin 2021. Gjatë 8 mujorit të vitit 2022 konstatohet gjithashtu rritje e konsiderueshme në zërin shpenzime operative të pushtetit vendor në raport

me një vit më parë, prej rreth 1.164 milion lekë. Ndërsa në zërin shpenzime për investime për 8 mujorin 2022, ndryshimi vjen me një ulje prej rreth 754 milion lekë ose 11.4% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2021.

Më poshtë paraqitet në mënyrë të përmbledhur tabela e ndryshimeve të të ardhurave dhe shpenzimeve në financat publike vendore gjatë 8 mujorit të vitit 2022 dhe 8 mujorit të vitit 2021.

Tabela 23: Të ardhurat dhe shpenzimet faktike të pushtetit vendor sipas natyrës (në milion lekë)

| Nr | E M Ë R T I M I | Fakt 8 mujori | | Diferencat | |
|------------|---------------------------------------|---------------|---------------|-------------------------|---------------------|
| | | 2022 | 2021 | në vlerë 2022 ndaj 2021 | në % 2022 ndaj 2021 |
| I. | Të ardhura nga Pushteti vendor | 20,023 | 18,410 | 1,613 | 108.8% |
| I.1 | Taksa mbi pasurinë | 4,603.5 | 4,475 | 129 | 102.9% |
| I.2 | Taksa e biznesit të vogël | 52.6 | 345 | -292 | 15.3% |
| I.3 | Taksa Lokale | 15,367.0 | 13,591 | 1,776 | 113.1% |
| II. | Shpenzime nga Pushtetit Vendor | 33,591 | 32,524 | 1,067 | 103.3% |
| II.1 | Shpenzime Korente | 27,751 | 25,930 | 1,821 | 107.0% |
| | Personeli | 16,403 | 15,902 | 501 | 103.1% |
| | Shpenzime Oper. Mirmbajtje | 10,243 | 9,079 | 1,164 | 112.8% |
| | Subvencione | 110 | 83 | 27 | 132.4% |
| | Te tjera | 996 | 866 | 130 | 115.0% |
| II.2 | Shpenzime Kapitale | 5,840 | 6,594 | -754 | 88.6% |

Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022)

Shpenzimet e Personelit, përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të shpenzimeve totale të njësisve të vetëqeverisjes vendore. Për 8 mujorin e vitit 2022, këto shpenzime janë realizuar në masën 16.4 miliard lekë ose rreth 501 milion lekë më shumë se e njëjta periudhë e vitit 2021. Në këtë rezultat financiar ka ndikuar edhe politika për rritjen e pagave të edukatorëve të arsimit parauniversitar që gjatë vitit 2022 u financua edhe me 100 milion lekë shtesë, dhe si rrjedhim shpenzimet e personelit për këtë kategori punonjësish kanë pësuar rritje krahasuar më një vit më parë.

Shpenzimet Operative dhe të mirëmbajtjes, të cilat janë shumë të rëndësishme për mbarëvajtjen dhe ushtrimin e funksioneve, rezultojnë me rritje në 8 mujorin e vitit 2022 në krahasim më të njëjtën periudhë të një viti më parë. Shpenzimet operative përbëjnë rreth 30.5% të totalit të shpenzimeve të pushtetit vendor për 8 mujorin e vitit 2022. Në vlerë absolute në 8 mujorin e parë të vitit 2022 janë shpenzuar rreth 10.2 miliard lekë ose rreth 1.1 miliard lekë më shumë se në të njëjtën periudhë të një viti më parë. Duke marrë në analizë edhe vitet e kaluara vihet re tendenca e rritjes nga viti në vit i shpenzimeve operative, e cila vjen si rrjedhojë e konsolidimit të NJVQV-ve në ushtrimin e funksioneve, por edhe të rritjes së nivelit të shpenzimeve të mirëmbajtjes së vazhdueshme që shoqërojnë investimet tashmë të realizuara.

Shpenzimet për subvencione dhe të tjera, janë shpenzimet që përdorin njësitë e vetëqeverisjes vendore për të paguar interesat, për të subvencionuar politikat e ndryshme vendore dhe mbuluar funksione të tjera administrative. Në këto kushte nga sa përcaktohet në tabelën mësipërme në raport me 8 mujorin e vitit 2021, shpenzimet për subvencione në 8 mujorin e vitit 2022 kanë rritje me rreth 27 milion lekë apo rreth 32.4% më shumë, ndërsa shpenzimet e tjera janë rritur me rreth 130 milion lekë. Kjo reflekton kontributin e financimit nga vetë njësitë e vetëqeverisjes vendore nëpërmjet transfertave në buxhetet familjare apo individët, të ndihmës ekonomike, bursave etj, ndaj qytetarëve në nevojë.

Shpenzimet Kapitale, janë një zë mjaft i rëndësishëm jo vetëm për faktin që përbëjnë një pjesë të rëndësishme të buxhetit vendor me rreth 17.4 % të totalit të shpenzimeve për 8 mujorin 2022, por edhe për shkak se këto shpenzime janë ato që ndikojnë drejtpërdrejt në rritjen ekonomike dhe përmirësimin e cilësisë së jetesës së qytetarëve. Nga tabela e mësipërme vëmë re që shpenzimet për investime janë realizuar në masën 5.8 miliard lekë, e në krahasim me 8 mujorin e vitit 2021, shpenzimet për investime kanë patur një ulje me rreth 754 milion lekë apo 11.4%. Si faktorët që kanë ndikuar në këtë realizim me ulje vlerësohet të jetë rritja e çmimeve dhe vështirësitë e krijuara nga situata e përgjithshme ekonomike globale, krijuar nga lufta në Ukrainë.

Fondi i rindërtimit është një pjesë tjetër e shpenzimeve të buxhetit vendor. Përveç granteve nga qeverisja qendrore dhe të ardhurave të veta të njësisive të vetëqeverisjes vendore, edhe ky fond ka ndikuar gjithashtu në rritjen ekonomike të tyre. Financimi për NJVQV-të në vitin 2022 (çelur deri në fund të 8 mujorit, ku përfshihet edhe mbartja e fondit të akorduar me VKM, por e papërdorur në vitin 2021), është rreth 17 miliard lekë, ndërkohë që përdorimi i tij deri në fund të 8 mujorit 2022 është rreth 8 miliard lekë.

Tabela 24: Detajimi i fondit të rindërtimit sipas llojit të shpenzimeve (në milion lekë)


| Nr | E M Ë R T I M I | 8 mujori 2022 | |
|-------------|--|---------------|--------------|
| | | Buxheti | Fakti |
| III. | Fondi i Rindërtimit | 16,952 | 7,950 |
| | <i>Shpenzime kapitale</i> | <i>10,750</i> | <i>5,616</i> |
| | <i>Shpenzime Operative & Mirëmbajtje</i> | <i>698</i> | <i>121</i> |
| | <i>Transferta për familjet dhe individët</i> | <i>5,503</i> | <i>2,213</i> |

9.5 ECURIA E BORXHIT PUBLIK PËR PERIUDHËN JANAR-SHTATOR 2022

Në fund të muajit qershor 2022, borxhi i qeverisjes qendrore u vlerësua në nivelin 1,389.7 miliard Lekë ose 69.1% e PBB. Niveli i borxhit ndaj PBB-së u ul me 4.1 pp krahasuar me fundin e 2021, ose me 5.4 p.p në krahasim me të dhënat e fundit të 2020. Në fund të vitit 2020 raporti i borxhit ndaj PBB-së arriti në një nivel të paprecedentë të shkaktuar nga dy goditje radhazi që goditën ekonominë dhe financat publike shqiptare, si tërmeti në fund të vitit 2019 dhe më pas pandemia Covid 19, ndërkohë që në fundin e vitit 2021, ky nivel pësoi një rënie me 1.3 pikë përqindje (pra nga 74.5% në fund të 2020-ës, që ishte dhe niveli më i lartë i arritur ndonjëherë, në 73.1%).

Në terma nominalë, niveli i borxhit deri në mesin e vitit 2022 është rritur me 7.1 miliardë lekë krahasuar me fundin e vitit 2021, nga i cili 1.5 miliardë lekë i korrespondon borxhit të brendshëm dhe 5.6 miliardë lekë borxhit të jashtëm. Në vitet në vijim, raporti i borxhit ndaj PBB-së do të planifikohet më i ulët se niveli i parashikuar për vitin e kaluar, derisa niveli i borxhit të arrijë dhe të qëndrojë nën 45% të PBB-së, kjo në përputhje me parimin përkatës fiskal të përcaktuar në kuadrin ligjor.

Grafiku 32: Borxhi i Qeverisjes Qendrore në vlerë absolute dhe relative ndaj PBB (2017–Qershor 2022)




Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022)

Borxhi i qeverisjes qendrore pritet të qëndrojë poshtë nivelit prej 70% deri në fund të vitit 2022, ku konkretisht parashikimet janë drejt një niveli prej 68.8%.

Për sa i përket kompozimit të portofolit të borxhit të qeverisjes qendrore sipas instrumenteve, më shumë se 60% të peshës vazhdojnë ta mbajnë instrumentet e tregtueshme (*bono thesari, obligacione, eurobond*). Pesha e instrumenteve të tregtueshme vlerësohet të jetë në rritje nga viti në vit kryesisht për shkak të emetimeve më të shpeshta në tregjet ndërkombëtare, por edhe për shkak të rritjes së huamarrjes në tregun e brendshëm bazuar në rritjen e nevojave për financim gjatë viteve të fundit duke filluar nga viti 2020.

Grafiku 33: Përbërja e borxhit të qeverisjes qendrore në raport me totalin (2017–Qershor 2022)




Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022)

Përbërja e Borxhit Shtetëror

Në portofolin e borxhit të brendshëm shtetëror, gjatë gjashtëmuajorit të parë të vitit 2022, peshën më të madhe vazhdojnë ta mbajnë titujt afatshkurtër. Ndërkohë, është rritur pesha e titujve afatgjatë me 1.3 pp, si rezultat i një peshe të shtuar të emetimit të instrumenteve afatgjatë, ku gjatë gjashtëmuajorit të parë të vitit 2022 ka vazhduar edhe emetimi i obligacionit 15 vjeçar, i cili u prezantua për herë të parë në tremujorin e fundit të vitit 2021. Ndërkohë, pesha e titujve me norma interesi të ndryshueshme është reduktuar edhe përgjatë këtij gjashtëmuajori, pasi edhe gjatë kësaj periudhe nuk ka patur emetime të titujve me norma interesi të ndryshueshme, në përputhje me objektivat për reduktimin e riskut të normave të interesit dhe shmangien e fragmentimit të kërkesës për titujt me maturitet të ngjashëm.


Grafiku 34: Kompozimi i Borxhit të Brendshëm Shtetëror (2017–Qershor 2022)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022)

Në portofolin e borxhit të jashtëm, mbi 60% të peshës e mban borxhi me normë interesi fikse. Për sa i përket kompozimit sipas instrumenteve, pavarësisht diversifikimit të portofolit drejt instrumenteve të tregtueshme, peshën më të madhe vazhdojnë ta mbajnë huatë me burim kreditorët dypalësh dhe shumëpalësh, me destinacion financimin e projekteve me natyrë zhvillimore.

Grafiku 35: Kompozimi i borxhit të jashtëm shtetëror sipas interesit dhe instrumenteve (2017–Qershor 2022)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022)

Realizimi i Huamarrjes

Gjatë viteve të fundit, huamarrja është realizuar në përputhje me nevojat buxhetore dhe në përputhje me objektivat strategjikë për ruajtjen e stabilitetit të marrëdhënies ndërmjet raporteve të kostos dhe risqeve, krahas nevojave të rritura për financim. Gjatë vitit 2022, ka pasur një kërkesë të kufizuar për letrat me vlerë të borxhit të qeverisë në tregun e brendshëm, si rezultat i pasigurisë në treg dhe pritshmërive për rritje të normave të interesit.

Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit, huamarrja në terma bruto u realizua në vlerën 218.0 miliard Lekë, nga të cilat 90.7% (ose 197.7 miliard Lekë) u financuan nëpërmjet burimeve të brendshme dhe 9.3% (ose 20.3 miliard Lekë) nëpërmjet burimeve të huaja.

Huamarrja e Brendshme

Gjatë periudhës janar-qershor 2022, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka emetuar në tregun e brendshëm tituj shtetërorë në vlerën 197.7 miliard Lekë, nga të cilat 124.6 miliard Lekë nëpërmjet titujve afatshkurtër dhe 73.1 miliard Lekë nëpërmjet titujve afatgjatë. Totali i financimit neto rezultoi në nivelin -2.8 miliardë lekë. Rënia e huamarrjes së brendshme neto ka reflektuar hezitimin e bankave për të investuar në obligacione shtetërore, kryesisht në ato afatgjata, për shkak të pasigurisë së ardhshme dhe pritshmërive për rritje të normave së interesit, bazuar në zhvillimet e fundit në tregjet financiare, ndikuar nga pasojat e konfliktit Rusi-Ukrainë.

Tabela 25: Huamarrja shtetërore nga burime të brendshme në terma bruto dhe neto

| Lloji i Titullit | 6M1 2022 | | |
|----------------------------------|-------------------------|--------------------------|---------------------------------|
| | Emetim (në mld Lekë) | Maturim (në mld Lekë) | Huamarrja Neto (në mld Lekë) |
| Tituj Afatshkurtër | 124.6 | 128.0 | -3.4 |
| Bono Thesari në Lekë | 124.6 | 128.0 | -3.4 |
| Tituj Afatgjatë | 73.1 | 72.5 | 0.6 |
| Obligacione 2 vjeçare | 23.0 | 21.9 | 1.0 |
| Obligacione 2 vjeçare në Euro | 8.4 | 12.1 | -3.8 |
| Obligacione 3 vjeçare | 14.4 | 18.2 | -3.8 |
| Obligacione 5 vjeçare | 10.4 | 13.0 | -2.6 |
| Obligacione 7 vjeçare | 6.8 | 7.3 | -0.5 |
| Obligacione 10 vjeçare | 7.2 | 0.0 | 7.2 |
| Obligacione 15 vjeçare | 3.0 | 0.0 | 3.0 |
| Gjithsej Tituj Shtetërorë | 197.7 | 200.6 | -2.8 |

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022)

Huamarrja e Huaj

Përsa i përket huamarrjes së huaj, në fund të muajit qershor 2022, financimi i jashtëm bruto arriti në 20.3 miliardë lekë. Krahasuar me vitin e kaluar, financimi i jashtëm u ul me 7.7 miliardë lekë, kryesisht për shkak se këtë vit niveli i mbështetjes buxhetore ishte më i ulët se vitin e kaluar dhe gjithashtu vlera e kredive të disbursuara për financimin e projekteve është më e ulët se në të njëjtën periudhë të vitit 2021. Mbi 60% e financimit të huaj bruto vjen nga disbursimi i kredive në formën e mbështetjes buxhetore dhe pjesa tjetër për projekte, kryesisht nga projektet e transportit, pasuar nga sektori i shërbimeve shëndetësore, infrastrukturë urbane si dhe furnizim me ujë dhe kanalizime.

Tabela 26: Huamarrja e huaj në terma bruto

| Huajamarrja e Huaj Bruto | 6M1 2021 | | 6M1 2022 | |
|-------------------------------------|------------------------|---------------|------------------------|---------------|
| | Vlera (në mld Lekë) | %/Total | Vlera (në mld Lekë) | %/Total |
| Kredi për financim projektsh | 8.6 | 30.7% | 6.3 | 31.0% |
| Energjia | 0.9 | 3.4% | 0.2 | 1.1% |
| Transporti | 3.6 | 13.0% | 3.3 | 16.3% |
| Ujësjellës Kanalizime | 2.3 | 8.4% | 0.6 | 2.9% |
| Infrastruktura Urbane | 0.7 | 2.4% | 1.0 | 5.1% |
| Shëndetësia | 0.8 | 2.9% | 1.1 | 5.5% |
| Të Tjera | 0.2 | 0.7% | 0.0 | 0.1% |
| Mbështetje Buxhetore | 19.4 | 69.3% | 13.9 | 69.0% |
| Eurobond | 0.0 | 0.0% | 0.0 | 0.0% |
| Total Huamarrja e Huaj | 28.0 | 100.0% | 20.3 | 100.0% |


Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022)

Kostot dhe Risqet

Kostot


Krahasuar me gjashtëmuajorin e parë të vitit 2021, shpenzimet për interesa vlerësohen rreth 0.8 miliard Lekë më të larta, kryesisht si rezultat i rritjes së stokut të borxhit në vlerë nominale. Ndërkohë, që raporti i interesave ndaj të ardhurave tatimore, ka shënuar ulje në krahasim me gjashtëmuajorin e parë të vitit 2021 si rezultat i rritjes së të ardhurave tatimore gjatë periudhës janar-qershor 2022.

Grafiku 36: Interesat e Borxhit Shtetëror në vlerë absolute dhe relative ndaj PBB



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022)

Grafiku 37: Kosto mestare dhe jetëgjatësia mestare e borxhit të brendshëm



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022)

Risqet

Strategjia Afatmesme e Menaxhimit të Borxhit synon të përmirësojë më tej strukturën e borxhit (*kryesisht strukturën e portofolit të borxhit të brendshëm*), në drejtim të uljes së ekspozimit ndaj risqeve, si dhe mbajtjes nën kontroll të kostove. Pavarësisht se gjashtëmuajori i parë i vitit 2022 ka qenë sfidues për sa i përket rritjes së normave të interesit dhe plotësisht të huamarrjes për shkak të pasigurive në treg, portofoli i borxhit të brendshëm është arritur të menaxhohet me efektivitet, duke përmirësuar raportet e riskut, si dhe duke mbajtur nën kontroll koston.

Treguesit e riskut të refinancimit dhe riskut të normave të interesit të portofolit të borxhit të brendshëm janë përmirësuar. Për sa i përket riskut të refinancimit, koha mesatare në maturim është rritur nga 793 ditë në fund të vitit 2021 në 850 në fund të qershorit 2022, si dhe pesha e borxhit që maturohet brenda një viti është ulur nga 46.6% në fund të vitit 2021 në 45.1% të totalit të portofolit të borxhit të brendshëm në fund të muajit qershor 2022.

Ndërkohë, për sa i përket riskut të normave së interesit, koha mesatare në rifiksim u rrit nga 2.19 vite në fund të vitit 2021 në 2.34 vjet në fund të qershorit 2022, si dhe pesha e borxhit të brendshëm që rifiksohet brenda një vit u ul nga 48.0% në fund të muajit dhjetor 2021 në 46.5% të totalit të portofolit të borxhit të brendshëm në fund të muajit qershor 2022.

Tabela 27: Treguesit e riskut të normave të interesit (2020–Qershor 2022)

| Treguesi | 2020 | 2021 | Qer-2022 |
|---------------------------------|-------|-------|----------|
| Borxh me normë fikse/total | 65.3% | 68.5% | 69.45 |
| Borxhi i rivlerësuar në një vit | 46.7% | 48.0% | 46.5% |
| KMR (në vite) | 2.14 | 2.19 | 2.34 |


Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022)

Zhvillimet e Tregut Primar të Titujve Shtetërorë

Ecuria e ankandeve dhe kërkesa për titujt shtetërorë

Gjatë 6-mujorit të parë të vitit 2022 kërkesa për tituj shtetërorë ka rezultuar në vlerën 237.5 miliard Lekë, nga të cilat 143.2 miliard Lekë për bono thesari dhe 94.3 miliard Lekë për obligacione. Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2022, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka organizuar 42 ankande, gjysma e të cilave nuk janë mbuluar. Të gjitha ankandet e pambuluara janë zhvilluar pas fillimit të luftës në Ukrainë. Mospërmbushja e ankandeve ka ardhur kryesisht nga pasiguritë në treg si edhe nga pritshmëritë për rritje të normave të interesit në të ardhmen.


Grafiku 38: Raporti i mbulimit të ankandeve të titujve shtetërorë (Janar–Qershor 2022)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022)

Nga pikëpamja e investitorëve, baza e investitorëve, vijon të jetë e përqëndruar në mbi 60% tek sektori bankar duke e bërë portofolin e borxhit të brendshëm të ndjeshëm ndaj risqeve sistematike që mund të paraqesë ky sektor. Struktura e tregut primar të titujve po konsolidohet nga strategjia e ndjekur duke filluar nga muaji korrik 2018, me anë të së cilës synohet zhvillimi i tregut për titujt referencë, si shtysë për zhvillimin e tregut sekondar në të ardhmen.


Grafiku 39: Mbajtësit e borxhit të brendshëm shtetëror (2017- Qershor 2022)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022)

Yield-et e letrave me vlerë të qeverisë kanë ndjekur një tendencë rritëse duke filluar nga muaji Mars 2022, rritje kjo e ndikuar nga rritja e normës bazë të interesit në tregun vendas si edhe nga pritshmëritë për rritje të mëtejshme të normave të interesit në përgjigje të inflacionit të rritur. Banka e Shqipërisë ka rritur 4 herë normën bazë të interesit gjatë vitit 2022 duke prekur nivelin prej 2.25%, krahasuar me 0.5% në fund të vitit 2022. Për sa i përket rritjes së Yield-eve të titujve qeveritarë, rritja varion sipas instrumenteve, nga rreth 100 pikë bazë në rreth 280 pikë bazë ku për pjesën dërmuese të instrumenteve kjo rritje tejkalon rritjen e normës bazë nga Banka e Shqipërisë.

Grafiku 40: Kurba e yield-it mesatar të ponderuar të titujve shtetërorë



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022)

Pritshmëritë për Borxhin në vitin 2023

Referuar parashikimeve të rritjes ekonomike, si edhe deficitit buxhetor të planifikuar për vitin 2023, niveli i borxhit publik në raport me PBB parashikohet të ulet me rreth 1.3 pikë përqindje krahasuar me nivelin e fundit të vitit 2022.

Huamarrja e brendshme planifikohet të jetë më e lartë se huamarrja që pritet të realizohet në vitin 2022 dhe huamarrja e re mendohet të vijojë të realizohet kryesisht nëpërmjet titujve shtetërorë afatgjatë në

përputhje me objektivat për reduktimin e risqeve, por gjithashtu duke ju përshtatur edhe preferencave të investitorëve për titujt.

Huamarrja e huaj do të realizohet nëpërmjet disbursimit të huave që financojnë ecurinë e zbatimit të projekteve prioritare të qeverisë. Gjithashtu, pritet të ketë edhe disbursime të huave në formën e mbështetjes buxhetore nga kreditorë multilateral, në kuadër të mbështetjes së reformave të qeverisë, si dhe emetimi i një instrumenti Eurobond në tregjet e kapitalit, nëse tregjet do të jenë të favorshme për të siguruar financim me një normë interesi në nivele të pranueshme.

Duke marrë në konsideratë deklaratat dhe vendimet e fundit të Rezervës Federale dhe BQE, këto institucione do të vijojnë ndjekjen e politikave monetare shtrënguesë edhe për të paktën vitin 2022 dhe fillimin e vitit 2023, si rrjedhojë pritet një rritje e normave të interesit në tregun e huaj. Gjithashtu, edhe në tregun e brendshëm pritet të ketë rritje të normave të interesit. Në këto kushte, kostot për njësi të borxhit të brendshëm dhe atij të huaj pritet të shënojnë rritje në periudhën afatshkurtër dhe atë afatmesme.

Ndërkohë për sa i përket shpenzimeve për interesa të borxhit, gjatë vitit 2023 parashikohet një rritje e tyre me rreth 15 mld Lekë kryesisht për shkak të rritjes së konsiderueshme të normave të interesit në tregun e brendshëm dhe atë të huaj. Për sa i përket ripagesave të borxhit të jashtëm, në vitin 2023 planifikohet që në rast se tregjet do të jenë të favorshme, të mundësohet së bashku me emetimin e një Eurobondi të ri, edhe maturimi i pjesshëm (blerje) i Eurobondit që maturohet në vitin 2025, me qëllim zbutjen e profilit të amortizimit të borxhit të jashtëm për vitin 2025.

Tabela 28: Shërbimi i borxhit shtetëror 2022-2023

(në milion Lekë)

| Shërbimi | Janar-Qershor 2022 (Fakt) | 2022 (I Pritshmi) | 2023 |
|--|------------------------------|----------------------|----------------|
| Shërbimi Borxhit Shtetëror | 39,707 | 80,496 | 136,352 |
| Interesat e Borxhit të Brendshëm Shtetëror | 12,598 | 24,377 | 34,283 |
| Interesat e Borxhit të Jashtëm Shtetëror | 6,519 | 16,593 | 21,760 |
| Ripagesat e Borxhit të Jashtëm | 20,589 | 39,526 | 80,310* |

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022)

*Përfshin realizimin e një blerje /maturim të parakohshëm të një pjese të Eurobondit që maturohet në 2025 (prej 29,668 milion Lekë)

9.6 LISTA E KONCENSIONEVE AKTIVE DHE TË PLANIFIKUARA

Tab 29

Kontrata Koncesion/PPP aktive deri në 2021

| Kategoria | Lloji | Objekti i Kontratës | Vlera e kontratës |
|------------------------------------|-------|--|------------------------|
| Kontrata mbi Bazë Tarifore | | | 2,493,100,000 |
| Kontratë Shërbimesh | | | 2,493,100,000 |
| | | Dhënie me Koncesion/Partneritet Publik Privat të Shërbimit të Sistemit dhe Menaxhimit të Parkimit në Qytetin e Vlorës | - |
| | | Krijimi dhe funksionimi i sistemit të kontrollit të pullave fiskale | 1,223,100,000 |
| | | Kryerja e shërbimit të rimorkimit të anijeve, Shërbimi i Transportit, Transportimi i Ekuipazheve të anijeve, Operacionet e ngarkim-shkarkimit | 1,200,000,000 |
| | | Prodhimi dhe shpërndarja e kartave të identitetit dhe pasaportave elektronike | - |
| | | Shërbimi i kontrollit ligjor të instrumentave matës, nëpërmjet instrumentave shpërndarës të karburantit dhe gazit të lëngshëm | 70,000,000 |
| Sektori i Arsimit | | | 3,339,318,008 |
| Ndërtim, Operim, Transferim | | | 3,339,318,008 |
| | | Për përmirësimin e infrastrukturës Arsimore në Bashkinë e Tiranës për katër objektet arsimore në zonën Tirana 4 | 1,738,456,242 |
| | | Për përmirësimin e infrastrukturës Arsimore në Bashkinë Tiranë | 1,600,861,766 |
| Sektori i Bujqësisë | | | 1,906,500,000 |
| Ndërtim, Operim, Transferim | | | 1,906,500,000 |
| | | Kontratë Koncesioni për kultivimin e ullirit deri në 1000 ha, Kavajë | 1,906,500,000 |
| Sektori i Energjisë | | | 411,227,448,631 |
| Ndërtim, Operim, Transferim | | | 411,227,448,631 |
| | | Financimi, Projektimi, Ndërtimi, Vënia në Punë, Administrimi, Mirëmbajtja dhe Transferimi i Hidrocentraleve "Shkallë", "Cerrujë", "Plesha", "Bejni1", "Bejni2", "Klos" | 1,465,039,743 |
| | | Ndërtim, operim dhe transferim i Hidrocentraleve Gjuraj, Kashëc, Ragam dhe Lepurushe | 780,000,000 |
| | | Ndërtim, operim dhe transferim i hidrocentraleve mbi Lumin Kardhiq | 1,041,453,039 |
| | | Ndërtim, operim dhe transferim i hidrocentraleve mbi Përroit Ujëmbledhës të Përroit të Zhejës | 61,916,210 |
| | | Ndërtim, operim dhe transferim i Hidrocentraleve në Pellgun Ujëmbledhës të Shmilit dhe Zallit të Gjurait, Rrethi Librazhd | 1,165,964,018 |
| | | Ndërtim, operim dhe transferim i hidrocentraleve RAPUN 3, RAPUN 3A dhe RAPUN 4 | 790,361,250 |
| | | Ndërtim, operim dhe transferim i hidrocentraleve TREBINJA 1, TREBINJA 2, POTGOZHAN, KALIVAÇ dhe DUNICE | 175,585,602 |
| | | Ndërtim, operim dhe transferim i Hidrocentraleve, Cemerica 1, Cemerica 2 dhe Cemerica 3 | 300,673,715 |
| | | Ndërtim, operim dhe transferim i hidrocentralit ARSTI | 225,125,130 |
| | | Ndërtim, operim dhe transferim i Hidrocentralit Begaj | 2,794,366,000 |
| | | Ndërtim, operim dhe transferim i Hidrocentralit Egnatia | 321,956,600 |
| | | Ndërtim, operim dhe transferim i hidrocentralit KALIVAR | 465,326,140 |
| | | Ndërtim, operim dhe transferim i Hidrocentralit Lingjaca | 149,524,860 |
| | | Ndërtim, operim dhe transferim i hidrocentralit QYTEZË | 27,700,000 |
| | | Ndërtim, operim dhe transferim i Hidrocentralit Stojan | 124,333,623 |
| | | Ndërtim, operim dhe transferim i hidrocentralit VILLIQ | 199,260,305 |
| | | Ndërtim, operim dhe transferim i hidrocentralit LLËNGË | 252,559,542 |
| | | Ndërtim, operim dhe transferim i hidrocentraleve SHEBA 1, SHEBA 2, SHEBA 3 dhe SHEBA 4 | 416,000,000 |
| | | Ndërtim, operim dhe transferim Hec Holta Kabash dhe Holta Porocan | 500,000,000 |
| | | Ndërtim, operim dhe transferim i hidrocentraleve GERMANI 1, 2, 3, 4 dhe 5 | 348,238,001 |
| | | Ndërtim, operim dhe transferim i hidrocentraleve mbi Lumin SETA | 1,400,805,550 |
| | | Ndërtim, operim dhe transferim i hidrocentraleve PRELLE 1 dhe PRELLE 2 | 1,512,585,536 |
| | | Ndërtim, operim dhe transferim i hidrocentraleve të Lashkizës | 322,691,040 |
| | | Ndërtim, operim dhe transferim i hidrocentralit RUNJA | 351,244,805 |
| | | Ndërtim, operim dhe transferim i hidrocentraleve ARRËZ, SHËNDELLI, SOTIRE, PODE, MESARE, URA, RAJAN 2, RADON, DEDOVE, PESHTAN, OSNATI DHE GRADISHT | 837,404,386 |
| | | Ndërtim, operim dhe transferim i hidrocentraleve FLETI 1, FLETI 2, FLETI A dhe FLETI B | 815,963,996 |
| | | Ndërtim, operim dhe transferim i hidrocentraleve KUKUR 1, 2, 3, 4 dhe 5 | 4,547,551,449 |
| | | Ndërtim, operim dhe transferim i Hidrocentralit Dragobia | 2,404,858,492 |
| | | Ndërtim, operim dhe transferim i Hidrocentraleve në Kaskadën e Osumit | 30,994,337,216 |
| | | Ndërtim, operim dhe transferim i Hidrocentraleve, Prishta1, Prishta 2, | 329,256,843 |
| | | Ndërtim, operim dhe transferim i hidrocentraleve ZAJE, TUJAN, XHAFERAJ, KOLLOVOZ, NOVOSEJË, MËSHTEKËN | 223,087,239 |
| | | Ndërtim, operim dhe transferimin i hidrocentralit ZERC | 120,311,959 |
| | | Ndërtim, operim, transferim i 5 Hidrocentraleve në rrjedhën e lumit Shkumbin | 847,000,000 |
| | | Ndërtim, operim, transferim i Hidrocentraleve Arrez 1, Arrez 2, Arrez 3 dhe Arrez 4 | 295,860,000 |
| | | Ndërtim, operim, transferim i Hidrocentraleve Backa 1, Backa 2, Backa A, Backa B, Backa C | 1,156,808,769 |
| | | Ndërtim, operim, transferim i Hidrocentraleve Ballenjë | 138,314,960 |
| | | Ndërtim, operim, transferim i Hidrocentraleve Batra 1, Batra 2, Batra 3 | 369,786,250 |
| | | Ndërtim, operim, transferim i Hidrocentraleve Bershi-Klos | 250,548,894 |
| | | Ndërtim, operim, transferim i Hidrocentraleve Bëncë dhe Tepelenë | 675,221,200 |
| | | Ndërtim, operim, transferim i Hidrocentraleve Bigas dhe Veleshnje | 42,420,000 |
| | | Ndërtim, operim, transferim i Hidrocentraleve Bregu i Madh | 128,136,000 |
| | | Ndërtim, operim, transferim i Hidrocentraleve Cangonj | 62,650,250 |
| | | Ndërtim, operim, transferim i Hidrocentraleve Çaje, Reke, Livadhe, Shkinak, Lapaj 2, Bushtrica 1, Bushtrica 2 dhe Bushtrica 3 | 3,673,402,000 |
| | | Ndërtim, operim, transferim i Hidrocentraleve Darsi 1, Darsi 2, Darsi 3, Darsi 4 | 1,230,440,516 |
| | | Ndërtim, operim, transferim i Hidrocentraleve Gavran1 dhe Gavran | 164,333,245 |
| | | Ndërtim, operim, transferim i Hidrocentraleve Gojan, Gjegjan, Peshqesh, Ura e Fanit, Fangu | 16,322,955,740 |

| | |
|--|----------------|
| Ndërtim, operim, transferim i Hidrocentraleve Guri I Kuq 1/1 dhe Guri I Kuq 1/2 | 136,963,790 |
| Ndërtim, operim, transferim i Hidrocentraleve Gjoni, Blishta, Klosi, Domi, Luçi, Shoshaj, Zenishti, Burreli | 4,069,596,314 |
| Ndërtim, operim, transferim i Hidrocentraleve Iballe 1, 2, Sapaç 1, 2, Berisha dhe Liqeni, Rrethi Pukë | 1,572,169,360 |
| Ndërtim, operim, transferim i Hidrocentraleve Kaskada e Hec-eve të Hotolishtit | 567,859,875 |
| Ndërtim, operim, transferim i Hidrocentraleve Kasollet e Selcës | 526,318,254 |
| Ndërtim, operim, transferim i Hidrocentraleve Kryezi 3, Kryezi 4 dhe Kryezi 5 | 131,064,360 |
| Ndërtim, operim, transferim i Hidrocentraleve Lajthia, Kolesjan, Domaj | 123,761,020 |
| Ndërtim, operim, transferim i Hidrocentraleve Lefter 1, Lefter 2A, Lefter 2B, Lefter 3 (Zgjidhur me marrëveshjen me nr 2357 Rep nr 1173/3 Kol datë 06.11.2018) | 208,659,212 |
| Ndërtim, operim, transferim i Hidrocentraleve Lumzi | 1,725,593,333 |
| Ndërtim, operim, transferim i Hidrocentraleve mbi lumin Gostimë, Egnatia Shushicë | 7,806,058,026 |
| Ndërtim, operim, transferim i Hidrocentraleve mbi Lumin Gjader | 1,592,690,975 |
| Ndërtim, operim, transferim i Hidrocentraleve mbi lumin Shushicë | 2,433,789,054 |
| Ndërtim, operim, transferim i Hidrocentraleve mbi lumin Valbonë rrethi Tropojë. | 7,331,612,960 |
| Ndërtim, operim, transferim i Hidrocentraleve mbi përroin Zalli i Lunikut Librazhd | 1,702,149,000 |
| Ndërtim, operim, transferim i Hidrocentraleve Meshanik dhe Guvë | 216,152,500 |
| Ndërtim, operim, transferim i Hidrocentraleve Myhejani 1, Myhejani 2, Myhejani 3 | 577,625,340 |
| Ndërtim, operim, transferim i Hidrocentraleve në lumin e Shalës | 19,811,063,785 |
| Ndërtim, operim, transferim i Hidrocentraleve në Pellgun Ujëmbledhës të Zallit të Bulqizes/Vajkal-Rrethi Bulqizë | 587,563,575 |
| Ndërtim, operim, transferim i Hidrocentraleve në Rrjedhën e lumit Shkumbin, Qukës | 6,249,092,892 |
| Ndërtim, operim, transferim i Hidrocentraleve Përroin Sheja e Librazhdit | 492,775,800 |
| Ndërtim, operim, transferim i Hidrocentraleve Potam | 291,900,000 |
| Ndërtim, operim, transferim i Hidrocentraleve Quku 1 dhe Quku 2 | 150,894,676 |
| Ndërtim, operim, transferim i Hidrocentraleve Rapun 1, Rapun 2 | 749,080,000 |
| Ndërtim, operim, transferim i Hidrocentraleve Steblevë | 159,680,320 |
| Ndërtim, operim, transferim i Hidrocentraleve Suha 2 | 360,000,000 |
| Ndërtim, operim, transferim i Hidrocentraleve Shkopet 2 dhe Shkopet 3 | 2,273,383,994 |
| Ndërtim, operim, transferim i Hidrocentraleve Shpella Poshtë II dhe Shpella Poshtë III | 144,560,000 |
| Ndërtim, operim, transferim i Hidrocentraleve Shutri | 139,666,667 |
| Ndërtim, operim, transferim i Hidrocentraleve Shutri 1, Shutri 2 | 136,783,700 |
| Ndërtim, operim, transferim i Hidrocentraleve të Lusës | 621,368,362 |
| Ndërtim, operim, transferim i Hidrocentraleve Vendresh, në Pellgun ujëmbledhës Përroi Vendreshes, Komuna Vendresh, Rrethi Skrapar | 37,250,000 |
| Ndërtim, operim, transferim i Hidrocentraleve Vernik 1, Vernik 2, Vernik 3 dhe Vernik 4 | 971,365,040 |
| Ndërtim, operim, transferim i Hidrocentraleve Vokopola 1, Vokopola 2 dhe Vokopola 3 | 497,257,690 |
| Ndërtim, operim, transferim i Hidrocentraleve Zall Xhuxhe 1, Zhall Xhuxhe 2 | 85,780,000 |
| Ndërtim, operim, transferim i Hidrocentraleve Zalli i Qarishtes | 5,273,943,244 |
| Ndërtim, operim, transferim i Hidrocentralit Blaç | 44,000,032 |
| Ndërtim, operim, transferim i Hidrocentralit Bushtrica 1 | 506,147,190 |
| Ndërtim, operim, transferim i Hidrocentralit Denas | 936,000,000 |
| Ndërtim, operim, transferim i Hidrocentralit Dobrenje-Tomorrice, në Përroin e Hijes, Skrapar | 106,780,000 |
| Ndërtim, operim, transferim i Hidrocentralit Grabovë 2 | 1,486,571,351 |
| Ndërtim, operim, transferim i Hidrocentralit Kaçinar | 315,219,168 |
| Ndërtim, operim, transferim i Hidrocentralit Lunik | 786,900,000 |
| Ndërtim, operim, transferim i Hidrocentralit Malind | 294,085,200 |
| Ndërtim, operim, transferim i Hidrocentralit Malla | 176,321,017 |
| Ndërtim, operim, transferim i Hidrocentralit Nishan | 212,520,000 |
| Ndërtim, operim, transferim i Hidrocentralit Plepi, në Përroin e Plepit, Komuna Okshutun, Rrethi Diber | 86,818,382 |
| Ndërtim, operim, transferim i Hidrocentralit Sekë | 1,177,887,502 |
| Ndërtim, operim, transferim i Hidrocentralit Selca 2, Mesmal | 269,981,177 |
| Ndërtim, operim, transferim i Hidrocentralit Skatinë | 129,541,704 |
| Ndërtim, operim, transferim i Hidrocentralit Stavec | 870,315,194 |
| Ndërtim, operim, transferim i Hidrocentralit Shengjon, Komuna Fan, Rrethi Mirditë | 101,242,260 |
| Ndërtim, operim, transferim i Hidrocentralit Shengjun | 349,864,502 |
| Ndërtim, operim, transferim i Hidrocentralit Topçias | 128,221,000 |
| Ndërtim, operim, transferim i Hidrocentralit Truen | 192,560,000 |
| Ndërtim, operim, transferim i Hidrocentralit Valbona | 274,205,000 |
| Ndërtim, operim, transferim i Hidrocentraleve mbi Lumin Curraj, Rrethi Tropojë | 13,728,387,330 |
| Ndërtim, operim, transferim i hidrocentralit Poçem | 14,134,724,113 |
| Ndërtim, operim, transferim i Hidrocentralit Spathare | 80,070,750 |
| Ndërtim, operim, transferim i Hidrocentralit Suha-1 | 3,181,563,000 |
| Ndërtim, operim, transferim i hidrocentralit Labinot Fushë | 347,706,122 |
| Ndërtim, shfrytëzim dhe transferim i Hidrocentraleve Lura 1, 2 dhe 3 | 1,300,177,500 |
| Ndërtim, operim, transferim i Hidrocentralit Tuçep 2 | 166,000,000 |
| Ndërtim, operim dhe transferim i hidrocentralit Lapaj | 1,453,500,000 |
| Ndërtim, operim dhe mirëmbajtja e hidrocentraleve Orgjost i Ri; Bele 1, 2; Topojan 1,2 | 3,565,744,707 |
| Ndërtim, operim dhe mirëmbajtja e hidrocentraleve Belesova 1 dhe 2 | 46,315,030 |
| Ndërtim, operim dhe mirëmbajtja e hidrocentraleve Bistrica 3 dhe 4 | 756,400,000 |
| Ndërtim, operim dhe mirëmbajtja e hidrocentraleve Bishnica 1 dhe 2 | 250,000,000 |

| | | |
|--|---|----------------|
| | Ndërtim, operim dhe mirëmbajtja e hidrocentraleve Borje, Oreshkë, Cernalevë, Cernalevë 1 | 830,097,322 |
| | Ndërtim, operim dhe mirëmbajtja e hidrocentraleve Çekrezë 1, 2 | 123,858,465 |
| | Ndërtim, operim dhe mirëmbajtja e hidrocentraleve Dobjot i Madh, Arrëz, Miras, Menkulas, Bracen, Kuç | 124,254,000 |
| | Ndërtim, operim dhe mirëmbajtja e hidrocentraleve Gomsiqe 1,2,3,4 (Zgjidhur me marrëveshjen me nr 242 Rep, nr 1186/1 Kol datë 16.11.2018) | 2,149,411,466 |
| | Ndërtim, operim dhe mirëmbajtja e hidrocentraleve Gostivisht, Langarica3, Ura e Dashit | 309,815,533 |
| | Ndërtim, operim dhe mirëmbajtja e hidrocentraleve Hurdhasi 1, 2, 3 | 200,000,000 |
| | Ndërtim, operim dhe mirëmbajtja e hidrocentraleve Kozel, Helmes 1 dhe Helmes 2 | 108,000,000 |
| | Ndërtim, operim dhe mirëmbajtja e hidrocentraleve Lengarica 1 dhe 2 | 1,980,904,000 |
| | Ndërtim, operim dhe mirëmbajtja e hidrocentraleve Nishova 1, 2 | 89,684,218 |
| | Ndërtim, operim dhe mirëmbajtja e hidrocentraleve Progonat, Lekdush - Bënçë e Sipërme (Zgjidhur më 02.03.2018). | 929,146,830 |
| | Ndërtim, operim dhe mirëmbajtja e hidrocentraleve Strelca 1, Strelca 2, Strelca 3 | 1,084,000,000 |
| | Ndërtim, operim dhe mirëmbajtja e hidrocentraleve Shemri dhe Mguille | 69,026,908 |
| | Ndërtim, operim dhe mirëmbajtja e hidrocentraleve Shtika 1,2,3,4 | 87,570,000 |
| | Ndërtim, operim dhe mirëmbajtja e hidrocentraleve Zerec 1,2 | 199,921,096 |
| | Ndërtim, operim dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Liqenet, Maja e Madhe, Zanore, Dragostunjë, Frari, Hotolisht, Ura | 424,080,723 |
| | Ndërtim, operim dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Bisak | 50,617,908 |
| | Ndërtim, operim dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Driza | 151,000,000 |
| | Ndërtim, operim dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Kabash 1 dhe 2 | 671,000,000 |
| | Ndërtim, operim dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Kacni | 133,121,000 |
| | Ndërtim, operim dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Klos | 96,422,100 |
| | Ndërtim, operim dhe mirëmbajtja e hidrocentralit koka 1 | 392,862,289 |
| | Ndërtim, operim dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Koxheraj | 102,963,375 |
| | Ndërtim, operim dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Kryezi dhe Kryezi i Epërm | 50,419,481 |
| | Ndërtim, operim dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Lumi Treskës | 656,545,309 |
| | Ndërtim, operim dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Lumi Zalli i Okshtunit | 4,443,351,400 |
| | Ndërtim, operim dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Martanesh | 857,861,985 |
| | Ndërtim, operim dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Nicë | 49,800,000 |
| | Ndërtim, operim dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Ostren i Vogël | 46,870,792 |
| | Ndërtim, operim dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Peqin | 521,573,382 |
| | Ndërtim, operim dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Perrollaj | 51,434,808 |
| | Ndërtim, operim dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Përroi i Trebishit, Bulqizë | 209,336,441 |
| | Ndërtim, operim dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Pobreg | 995,034,550 |
| | Ndërtim, operim dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Qarr Kaltanj | 273,892,660 |
| | Ndërtim, operim dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Radovë | 188,000,000 |
| | Ndërtim, operim dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Selishtë | 120,000,000 |
| | Ndërtim, operim dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Sllabinjë | 1,290,117,487 |
| | Ndërtim, operim dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Stravaj | 503,529,364 |
| | Ndërtim, operim dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Shutinë | 115,000,000 |
| | Ndërtim, operim dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Thanë, Mollas | 1,042,888,000 |
| | Ndërtim, operim dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Ujanik 2 | 134,550,000 |
| | Ndërtim, operim dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Vërtop | 283,950,430 |
| | Ndërtim, operim dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Vlushë | 1,898,100,000 |
| | Ndërtim, operim dhe transferimi i hidrocentraleve Gur Shpat1, Gur Shpat 2 | 176,738,773 |
| | Ndërtim, operim dhe transferimi i hidrocentraleve Sotirë, Sotirë 2 | 144,554,509 |
| | Ndërtim, operim dhe transferimi i hidrocentralit Mollaj | 79,700,000 |
| | Ndërtim, operim, mirëmbajtja dhe transferimi i hidrocentraleve Lenie, Shalës, Strelcë | 354,282,240 |
| | Ndërtim, operim, mirëmbajtja dhe transferimi i hidrocentraleve të kaskadës së lumit Dardhë | 907,956,000 |
| | Ndërtim, operim, mirëmbajtja dhe transferimi i hidrocentralit Lena 1, Lena 2, Lena 2-A | 311,332,059 |
| | Ndërtim, operim, mirëmbajtja dhe transferimi i hidrocentralit Picar 1 | 35,455,750 |
| | Ndërtim, operim, mirëmbajtja dhe transferimi i hidrocentralit Qafëzezë | 51,955,070 |
| | Ndërtim, operim, mirëmbajtja dhe transferimi i hidrocentralit Verbë - Selcë. | 317,925,000 |
| | Ndërtim, operim, mirëmbajtja dhe transferim të hidrocentraleve Murdhar 1 dhe Murdhar 2 | 501,411,750 |
| | Ndërtim, operim dhe transferim i hidrocentralit Fterre dhe Fterre 1. | 650,565,750 |
| | Ndërtim, operim dhe transferim i hidrocentralit Çarshovë | 83,500,000 |
| | Ndërtim, operim dhe transferim i hidrocentralit Dishnicë | 15,300,000 |
| | Ndërtim, operim dhe transferim i hidrocentralit Faqekuq 1 dhe 2 | 587,975,273 |
| | Ndërtim, operim dhe transferim i hidrocentralit Lubonjë | 39,000,000 |
| | Ndërtim, operim dhe transferim i hidrocentralit Tervol | 325,800,167 |
| | Ndërtim, operim dhe transferim i Hidrocentraleve Kaskada e Luses | 743,776,400 |
| | Ndërtim, operim dhe transferim i hidrocentraleve VRANISHT, STROPAN, GRAPSH-ZICISHT dhe HOCISHT | 92,548,781 |
| | Ndërtim, operim dhe transferim i Hidrocentralit Guri i Bardhë | 800,908,292 |
| | Ndërtimi, pronësi, shfrytëzim, mirëmbajtje dhe transferim i Hidrocentralit të ri në Ashta | 19,520,000,000 |
| | Për ndërtimin e Hidrocentralit Veleshicë | 927,928,003 |
| | Për ndërtimin, operimin dhe transferimin e Hidrocentraleve Veleshica 1, 2, 3, 4, 5, 6 Sillove dhe Bjeshke | 3,254,323,134 |
| | Për ndërtimin, operimin dhe transferimin e Hec Kukur | 304,603,895 |
| | Për ndërtimin, operimin dhe transferimin e Hidrocentralit Bushtrica 3 | 559,309,182 |
| | Për ndërtimin e Hidrocentraleve mbi Lumin Shalë | 11,239,204,263 |
| | Për ndërtimin e Hidrocentralit Kalivaç | 16,913,853,000 |

| | | |
|-------------------------------|--|------------------------|
| | Për ndërtimin, operimin dhe transferimin e Hidrocentralit Peshku | 188,055,946 |
| | Projektimi, financimi ndërtimi, operimi, mirëmbajtja dhe transferimi i Hidrocentralit në Lumin Devoll | 130,000,000,000 |
| | Rehabilitimi, operimi dhe transferimi i Hidrocentralit "Labinot-Mal" | 12,500,000 |
| | Rehabilitimi, operimi dhe transferimi i hidrocentralit DOMAJ, Has | 12,369,610 |
| Sektori i Mjedisit | | 26,860,316,407 |
| | Kontratë Shërbimesh | 49,660,000 |
| | Menaxhimi dhe zhvillimi teknologjik i prodhimit të fidanëve pyjor/arror në Fidanishten Shtetërore të Cërrikut, Elbasan | 49,660,000 |
| | Ndërtim, Operim, Transferim | 26,306,943,761 |
| | Ndërtimi dhe administrimi i impiantit të përpunimit të mbetjeve urbane të qarkut Elbasan | 2,916,000,000 |
| | Për ndërtimin e landfillit inceneratorit dhe rehabilitimin e venddepozimeve ekzistuese Tiranë dhe prodhimin e energjisë elektrike | 18,374,766,200 |
| | Për dhënie me koncesion të shërbimit të pastrimit, grumbullimit, transportit dhe seleksionimit të mbetjeve të Bashkisë Kamëz | 1,350,000,000 |
| | Për ndërtimin dhe administrimin e Impjantit të trajtimit të mbetjeve urbane të Qarkut Fier dhe prodhimin e energjisë | 3,666,177,561 |
| | Shfrytëzim | 503,712,646 |
| | Shfrytëzimi i Burimit ujor "Sasaj, Bunec", Sarandë | 503,712,646 |
| Sektori i Shëndetësisë | | 41,950,526,478 |
| | Kontrate Shërbimesh | 41,950,526,478 |
| | Ofrimi i setit të personalizuar të instrumenteve kirurgjikale, material mjekësor steril njëpërdorimësh në sallat kirurgjikale, trajtimi i mbetjeve biologjike dhe dezinfektimi i sallave kirurgjikale. | 12,300,000,000 |
| | Për ofrimin e shërbimit laboratorik të spitaleve universitare, rajonale dhe atyre bashkiake të Sarandës dhe Lushnjës | 13,005,966,000 |
| | Për paketën e shërbimeve të kontrollit mjekësor bazë për grupmoshat 40-65 vjeç | 8,760,900,000 |
| | Shërbimi i Hemodializës | 7,883,660,478 |
| Sektori i Transportit | | 153,882,179,763 |
| | Kontratë Shërbimesh | 1,358,682,000 |
| | Menaxhimi, Operimi, Mirembajtja, Përmirësimi teknik dhe Adaptimi i terminalit të trageteve dhe krocerave Durrës | 559,305,000 |
| | Për dhënie me koncesion të disa shërbimeve detare | 238,374,000 |
| | Projektim, financim, rehabilitim, testim, shfrytëzim dhe mirëmbajtje të Qendrave të Kontrollit Teknik të mjeteve | 561,003,000 |
| | Ndërtim, Operim, Mirëmbajtje | 999,924,125 |
| | Për rehabilitimin, operimin dhe transferimin e Aeroportit të Kukësit | 999,924,125 |
| | Ndërtim, Operim, Transferim | 131,602,233,913 |
| | Infrastruktura Hekurudhore Fier-Ballsh, Fier-Vlorë | 2,431,918,164 |
| | Menaxhimi, operimi, mirëmbajtja dhe përmirësimi teknik i terminalit të konteinerave në portin e Durrësit | 3,705,000,000 |
| | Ndërtim dhe Operim i Rrugës Milot - Balldren | 17,737,025,000 |
| | Ndërtim, shfrytëzim dhe transferim në pronësi të shtetit, të Portit të Jahteve Shëngjin | 730,338,000 |
| | Ndërtim i portit të jahteve në Kalanë e Turrës, Komuna Synej, Kavajë | 4,450,000,000 |
| | Ndërtim, operim dhe transferim i Hidrocentraleve mbi Lumin Devoll, Infrastruktura zëvendësuese | 7,000,000,000 |
| | Ndërtim, operim dhe transferim i Aeroportit "Nënë Tereza" | 9,310,000,000 |
| | Ndërtim, operim, dhe transferim i parkimit nëntokësor në parkun "Rinia", Tiranë | 1,937,932,800 |
| | Ndërtim, përmirësim, shfrytëzim dhe mirëmbajtja e Autostradës Milot-Morinë | 5,311,940,715 |
| | Ndërtim, shfrytëzim i portit të jahteve në qytetin e Durrësit (BOT) | 1,356,144,750 |
| | Ndërtim, shfrytëzim dhe transferim i portit të tipit MBM, Porto Romano, Durrës | 1,224,000,000 |
| | Operim, ndërtim, mirëmbajtje, përmirësim teknik dhe adaptimi i Terminalit Lindor Durrës | 2,069,371,737 |
| | Për projektimin, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e rrugës Porti i Jahteve-Bypass Oriku-Dukat (Ura e Shën Lizës) | 5,817,298,747 |
| | Për përmirësimin, ndërtimin, operimin dhe mirëmbajtjen e Rrugës së Arbrit | 40,320,000,000 |
| | Per dhënie me koncesion/PPP te portit turistik dhe te shërbimeve Marina Limion | 1,374,984,000 |
| | Per projektimin, ndërtimin, operimin, dhe mirembajtjen e segmentit rrugor Thumane-F.Kruje-Vore-Kashar (pa T.V.SH.) | 26,826,280,000 |
| | Projektim, Ndërtim, Operim, Mirëmbajtje dhe Transferim | 19,921,339,725 |
| | Për projektimin, ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e Aeroportit Ndërkombetar të Vlorës | 12,830,191,500 |
| | Ndërtim dhe mirëmbajtje | |
| | Për dhënie me koncesion/PPP të projektit për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e "Portit të Integruar" në Triport Vlorë (pa T.V.SH.) | 7,091,148,225 |

| | | | |
|---|--------------------------|---|--------------------------|
| Sektori Tatimor dhe Doganor | | | 28,163,764,824 |
| Kontrate Sherbimesh | | | 28,163,764,824 |
| | | Financimi, ngritja dhe operimi i shërbimit të skanimit të konteinerve e automjeteve të tjera në Republikën e Shqipërisë | 27,663,364,824 |
| | | Shërbimi i markimit dhe monitorimit të karburanteve | 500,400,000 |
| Zhvillim Ekonomik | | | 1,435,691,880 |
| Kontrate Sherbimesh | | | 1,435,691,880 |
| | | Për dhënien me koncesion të prodhimit të kripës Nartë, Vlorë | 1,400,000,000 |
| | | Për Dhënien me Koncesion të Rregjistrimit të Barreve Siguruese | 35,691,880 |
| Nen-Totali 1 | | | 671,258,845,991 |
| Kontrata Koncesione/PPP të planifikuara për 2022 | | | |
| Kategoria | Lloji | Objekti i Kontratës | Vlera e kontratës |
| Sektori | | | |
| | Lloji i Kontrates | | |
| | | Për ofrimin e shërbimeve të infrastrukturës së çelësave publik (PKI) ” | 208,800,000 |
| | | ”Për Përmirësimin e Infrastrukturës Arsimore në Bashkinë e Tiranës për katër objekte arsimore në Zonën Tirana 2” | 2,586,105,930 |
| | | ”Për Përmirësimin e Infrastrukturës Arsimore në Bashkinë e Tiranës për katër objekte arsimore në Zonën Tirana 3” | 2,594,469,240 |
| | | ”Për projektimin, ndërtimin, operimin dhe mirëmbajtjen e segmentit rrugor Milot – Thumanë” (pa T.V.SH.) | 5,336,574,604 |
| | | ”Për projektimin, ndërtimin, operimin dhe mirëmbajtjen e segmentit rrugor Kashar – Lekaj” (Pa T.V.SH.) | 56,794,447,814 |
| | | ”Për projektimin, ndërtimin, operimin dhe mirëmbajtjen e segmentit rrugor Lekaj – Fier” (Pa T.V.SH.) | 37,984,426,464 |
| | | Projektim, ndërtim, operim, mirëmbajtje dhe transferim i Aeroportit të Sarandës | 4,221,360,000 |
| Nen-Totali 2 | | | 109,726,184,053 |
| Totali (Nen-Total 1+ Nen-Total 2) | | | 780,985,030,044 |
| PBB Nominale Viti 2023 | | | 2,176,100,438,997 |
| Vlera totale e Kontratave Koncesionare/PPP në përqindje ndaj PBB | | | 35.9% |

MINISTËR

Delina IBRAHIMAJ